

Prof. dr. Mark MARKU
Prof. dr. Artan FUGA
(Anëtar i Akademisë së Shkencave)

**Cyberbullizimi, shkaqe, pasoja dhe rrugë për përballimin
e tij**

Raport shkencor i analizës së të dhënave sasiore të anketimit

Departamenti i Gazetarisë Komunikimit

Fakulteti Histori – Filologji

Universiteti i Tiranës

Tabela e lëndës

Tabela e lëndës

Parathënie : Ndikimi i përkufizimit të cyberbullizimit mbi kërkimet shkencore

Rëndësia studimit: Prania e dukurive cyberbullizuese në shoqëri

Disa përkujdesje metodologjike: Përparësitë e metodës së kampionimit me *cluster*-a

A është teknologjia shkak për dukuritë cyberbullizuese?

**Ndikimi i marrëdhënieve shoqërore në përballjen e individit me praktikën
cyberbullizuese?**

Ndikimet e cyberbullizimit mbi psikologjinë individuale dhe anasjelltas

Rrugë për ta zbehur dhe evituar cyberbullizimin

Disa nga gjetjet kryesore

Literaturë

Prof. dr. Mark MARKU

Prof. dr. Artan FUGA (Anëtar i Akademisë së Shkencave)

Ndërgjegjja kolektive luhetet mes dy vlerash:

1. “Gjuha kocka s’ka, por kocka thyhen!”
2. “Qentë le të lehin, karvani ecën para!”

Cyberbullizimi, shkaqe, pasoja dhe rrugë për përballimin e tij

Raport shkencor i analizës së të dhënave sasiore të anketimit

Prof. dr. Mark MARKU

Prof. dr. Artan FUGA (Anëtar i Akademisë së Shkencave)

Ndërgjegjja kolektive luhetet mes dy vlerash:

1. “Gjuha kocka s’ka, por kocka thyhen!”
2. “Qentë le të lehin, karvani ecën para!”

Cyberbullizimi, shkaqe, pasoja dhe rrugë për përballimin e tij

Raport shkencor i analizës së të dhënave sasiore të anketimit

1. Parathënie : Ndikimi i përkufizimit të cyberbullizimit mbi kërkimet shkencore

Në këtë raport bëhet një paraqitje e prirjeve dhe e gjetjeve kryesore që dalin nga analiza e bazës së të dhënave të përfuara nga anketimi mbi cyberbullizimin, shkaqet, pasoja dhe rrugët e përballimit të tij në shoqërinë e sotme shqiptare.

Klasifikimi në dy pjesë, pra në “gjetje dhe prirje kryesore” dhe në “të dhëna tërësore” bëhet i domosdoshëm sepse këto të fundit, si rezultat i anketimit, janë me mijëra dhe shprehin nuanca pothuajse të pafundme. Ato mund të përdoren vetëm gradualisht dhe në vazhdimësi.

Sqarojmë qysh në fillim se në planin teorik është punuar duke marrë për bazë konceptin e pranuar nga literatura e sotme shkencore ndërkombëtare mbi cyberbullizimin. Në të vërtetë, nga një analizë e kujdesshme, konstatohet se koncepti i cyberbullizimit, sado me përmbajtje përgjithësisht të mirë-pranuar nga i gjithë komuniteti shkencor, te përkufizime të ndryshme të tij paraqet edhe nuanca të veçanta, të cilat nuk janë të parëndësishme.

Ka vend të flitet për një koncept më të ngushtë dhe një koncept më të gjerë të cyberbullizimit. Nga ana tjetër, ka raste që në të përfshihen të gjitha ngacmimet që iu bëhen përdoruesve të teknologjive dixhitale të komunikimit, por autorë të ndryshëm dallojnë cyberbullizimin nga praktika të tjera sikurse janë *cyberstalking*, *Internet troll*, *cyber-harassment*, etj. Këto të fundit, sado ngjashmëri të kenë me të, përsëri paraqesin nuanca dhe dallime që duhen mbajtur parasysh për të mos shkaktuar pështjellime metodologjike.

Përkufizimi bazë i mbajtur parasysh në këtë studim është si më poshtë:

Cyberbullying (ngacmimi dixhital) përbën: “Një akt agresiv, të qëllimshëm që kryhet nga një grup ose një individ, duke përdorur forma elektronike kontakti, shpesh herë dhe për një periudhë të gjatë, kundër një viktime që nuk mund të mbrohet lehtësisht” (Moreno 2014).^{1,2} Përkufizimi në fjalë përmban disa elemente kuptimore të rëndësishme sikurse janë:

- a. “Akte të qëllimshme”,
- b. “Të ndërmarra për një kohë relativisht të gjatë”,
- c. “Nga një person ose një grup personash”,
- d. “Duke përdorur përmbajtje agresive dhe viktimizuar personin kundër të cilit drejtohen dhe duke i shkaktuar dëme atij”,
- e. “Personi i shënjestruar nuk i zotëron mundësitë dhe aftësitë për t’u mbrojtur, pra ekziston një asimetri midis cyberbullizuesit dhe të ciberbullizuarit.” Asimetria në kuptim përbën një kusht parësor për të arritur në përfundimin që dikush cyberbullizon një tjetër.

Në një kuptim më të gjerë, koncepti i cyberbullizimit paraqitet edhe si më poshtë:

“Kjo (veprimtari – cyberbullizuese. Shën. i autorëve të raportit.) zakonisht përfshin dërgimin e email-eve, mesazheve tekst dhe imazheve të qarta seksuale (ndonjëherë në mënyrë anonime) me qëllim krijimin e frikës, dëmit, ose turpërimit të viktimës. Një përkufizim tjetër i njohur, edhe më specifik i ngacmimit dixhital, i propozuar nga Këshilli Kombëtar për Parandalimin e Krimeve, e paraqet atë në thelb si “Proces i përdorimit të Internetit, telefonave celularë ose pajisjeve të tjera për të dërguar ose postuar tekste ose imazhe me qëllim të dëmtimit ose turpërimit të një personi tjetër” (Chapin 2016).”³

Në këtë përkufizim të dytë përcaktohen në mënyrë më analitike edhe pasojat që vijnë nga cyberbullizimi. Pra, shënohen si të tilla, shkaktimi i frikës, i turpërimit përpara të tjerëve, si edhe shkaktimi i dëmeve të të gjitha llojeve. Nga ana tjetër, në këtë përkufizim, tregohen edhe instrumentet e realizimit të praktikave cyberbullizuese duke përfshirë veç të tjerash jo vetëm tekste, por edhe imazhe, jo vetëm sms, por edhe emaile. Ndërkohë edhe dërgimi i imazheve me

¹ Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka Onuchowska : *Cyberbullying: A Review of the Literature*, SSRN Electronic Journal, January 2021

DOI: 10.2139/ssrn.3799920

² Ky artikull ka për bashkë-autorë tre universitarë amerikanë. Ai përmban dy boshte kryesore. I pari ka të bëjë me një rishikim, vlerësim dhe klasifikim të literaturës shkencore të realizuar deri në atë kohë lidhur me cyberbullizimin. Nga kjo pikëpamje, ai orienton në universin e koncepteve, metodave të studimit dhe të gjetjeve eksperimentale, teorike dhe statistikore lidhur me të. Nga ana tjetër, si një bosht i dytë, autorët përpunojnë një sërë konsideratash të tyre lidhur me dukurinë në fjalë. Nga kjo pikëpamje, gjykuam që në morinë e pafundme të artikujve shkencorë dhe studimeve perëndimore mbi cyberbullizimin ta kemi si pike referimi të përkohshme. Në përpunime të mëtejshme të çështjes sigurisht ka vend për të bërë një pasqyrim më të gjerë të përvojës shkencore lidhur me këtë problem.

³ Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka Onuchowska, Po aty.

përmbajtje qartazi seksuale, pa pëlqimin e atyre të cilëve u dërgohen konsiderohet si cyberbullizim. Po kështu, ky i fundit nuk kufizohet vetëm në raste kur drejtohet qëllimshëm kundër një ose disa personave konkretë, por edhe kur këto përmbajtje të dëmshme kryhen në formë fushate duke prekur në mënyrë të tërthortë cilindo që bie në kontakt me to. Ky element i fundit e zgjeron me të drejtë konceptin e cyberbullizimit duke e vendosur atë në vendin e duhur. Në këtë mënyrë, koncepti i gjerë i cyberbullizimit përfshin të gjitha format e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ushtrimit të tij. Gjithsesi në këtë kuptim të gjerë, ai del përtej kufijve të një veprimtarie të qëllimshme, në formë fushate, drejtuar kundër një njeriu ose disa personave konkretë.

Ky raport, sikurse u theksua më lart, përmban kryesisht një përjasje kuptimore të të dhënave sasiore dhe të gjetjeve kryesore të realizuara. Anketimi në fjalë është realizuar përgjatë muajit maj 2025.

Të dhënat dhe gjetjet janë bazuar te përgjigjet që janë dhënë ndaj një pyetësoi të hollësishëm prej 41 pyetjesh dhe disa dhjetëra mundësive përgjigjesh, sipas përzgjedhjes së tyre të lirë dhe të vullnetshme nga ana e përgjigje-dhënësve. Anketimi në terren u realizua duke respektuar me kujdes parimet etike dhe metodologjike kryesore sikurse janë: respekti ndaj të anketuarit, shpjegimi për secilin të anketuar të qëllimeve studimit, sigurimi i anonimitetit të të anketuarve, mos-paragjykimi i asnjërës prej përgjigjeve të dhëna, liria e plotë për t'u shprehur sipas opinioneve personale të gjithkujt, trajtimi i bazës së të dhënave në përputhje me etikën shkencore dhe qytetare, etj.

Përpunimi i pyetjeve dhe i alternativave që janë përmbajtur në pyetësoin e anketës është mbështetur në përvojën e deritanishme të Departamentit të Gazetarisë dhe të Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Studimi mban parasysht të dhëna, gjetje, rezultate kërkimore dhe shkencore të arritura në vite nga pedagogët e këtij departamenti, të cilat përbëjnë një kuadër teorik paraprak të vlefshëm edhe për këtë studim. Nga ana tjetër, janë vlerësuar edhe një sërë studimesh për të njëjtën temë dhe mbajtur parasysht koncepte dhe metoda kërkimore e shkencore të studiuesve të huaj në këtë fushë.

Aktualisht në botë ka studime të llojeve të ndryshme mbi cyberbullizimin. Veçojmë studime të karakterit eksperimental, monografik, të mbështetura në kritere cilësore, analizë biografish personale viktimash të tij, përjasje teorike të nivelit makro-social, si edhe të bazuara në anketime.

Në këtë anketim kontribuan pedagogë të Departamentit të Gazetarisë dhe të Komunikimit, studentë që kryejnë studimet në të, të mobilizuar si anketues në terren ose si hedhës të të dhënave të anketës në platformën informatike të përpunimit të tyre. Por, vlerësohen për ndihmesën e dhënë në këtë kuadër edhe dhjetëra mësues shkollash të mesme, pedagogë universitetesh që lehtësuan punën e anketimit, si edhe drejtori shkollash, drejtori të arsimit të mesëm në qarqet ku u krye anketimi, të cilat bënë të mundur realizimin e tij në terren.

Një falënderim i thellë dhe i sinqertë i u drejtohet të gjithë atyre, së bashku me mirënjohjen e ekipit realizues të studimit.

Anëtarët e ekipit studimor kanë qenë:

Nr	Anëtar	
1	Mark Marku	Drejtues i projektit, co-përpunues i platformës teorike
2	Artan Fuga	Bashkë drejtues shkencor i projektit, co përpunues i platformës teorike
3	Elvin Luku	Pedagog drejtues, koordinues dhe monitorues terreni
4	Holta Shupo	Pedagog drejtues, koordinues dhe monitorues terreni
5	Laureta Zela	Pedagog drejtues, koordinues dhe monitorues terreni
6	Zylyftar Bregu	Pedagog drejtues, koordinues dhe monitorues terreni
7	Adelajda Pinjolli	Studente Anketuese terreni (Viti III Bachelor)
8	Esmeralda Doçi	Studente Anketuese terreni (Viti III Bachelor)
9	Iliada Mata	Studente Anketuese terreni (Viti III Bachelor)
10	Laurinda Sulo	Studente Anketuese terreni (Viti III Bachelor)
11	Sabina Nika	Studente Anketuese terreni (Viti III Bachelor)

Tabela 1

Të dhënat sasiore të përftuara prej këtij anketimi u hodhën në platformën e përpunimit të tyre informatik, u përpunuan dhe u vizualizuan nga grupi i mëposhtëm:

Nr.	Emri mbiemri	Statusi në projekt
1	Rrapo Zguri	Pedagog, përpunues të dhënash
2	Rexhina Papa	Studente, hedhëse të dhënash
3	Albaina Otobashi	Studente, hedhëse të dhënash

Tabela 2

Anketimi u krye në shkolla të mesme, universitete dhe në hapësira publike në dhjetë qendra urbane të vendit. Janë shpërndarë 869 pyetësorë ankete. Përgjithësisht mund të thuhet se janë mbledhur të gjithë pyetësorët e shpërndarë. Kjo falë edhe punës së kujdesshme të anketuesve në terren. Gjithsesi vëmë në dukje se ka raste të veçuara, pothuajse të pandjeshme, kur të anketuar të ndryshëm, një pakicë gjithsesi, kanë lënë pa përgjigje pyetje të veçanta pyetësorit. Ky shpjegim bëhet për të kuptuar se përse numri i përgjigje-dhënësve për pyetje të ndryshme qëllon që edhe ndryshon nga njëra pyetje te tjetra, ndonëse shumë pak dhe pa asnjë ndikim për t'u marrë parasysh në përfundimet e nxjerra.

Terrenet e anketimit dhe shpërndarja e pyetësorëve të anketës në to kanë qenë si më poshtë:

Rrethi	Qyteti / Qendra semiurbane	Nr. Anketash
Tiranë	Tiranë	232
	Kamëz	59
	Laparakë	41
Elbasan	Elbasan	100
	Peqin	42
Vlorë	Vlorë	95
	Orikum	40
Korçë	Korçë	107
Shkodër	Shkodër	100
	Koplik	53

Tabela 3

Shkollat e mesme që u përzgjedhën për t'u kryer anketimi kanë qenë:

Rrethi	Qyteti /Qendra semiurbane	Gjimnazi
Tiranë	Tiranë	Qemal Stafa
		Petro Nini Luarasi
	Laparakë	Aleks Buda
	Kamëz	Ibrahim Rugova
Elbasan	Elbasan	Kostandin Kristoforidhi
	Peqin	Zihni Magani
Vlorë	Vlorë	Ali Demi
	Orikum	Hasan Pulo
Korçë	Korçë	Themistokli Gërmenji
Shkodër	Shkodër	Jordan Misja
	Koplik	Sherif Hoxha

Tabela 4

Ndërsa anketimi i studentëve u realizua në Institucionet e Arsimit të Lartë dhe në njësitë bazë të tyre sikurse paraqitet më poshtë:

Rrethi	Universiteti	Fakulteti
Tiranë	UT	Historisë dhe Filologjisë
		Shkenca Shoqërore
		Shkenca Natyrore
Elbasan	Aleksandër Xhuvani	Shkenca Humane
		Shkenca Natyrore
		Shkenca Edukimi
Vlorë	Ismail Qemali	Shkenca Humane
		Ekonomi
		Shkenca Teknike dhe Natyrore
Korçë	Fan S. Noli	Edukim dhe Filologji
		Shkenca Natyrore dhe Humane
		Ekonomi
Shkodër	Luigj Gurakuqi	Shkenca Shoqërore
		Shkenca Natyrore
		Edukimi

Tabela 5

Anketimi i kryer nuk do të kishte qenë i mundur për t'u realizuar pa mbështetjen e drejtorisë së arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Kjo drejtori, me mirëkuptim dhe dashamirësi të plotë, lehtësoi punën për anketimin e nxënësve pa shkaktuar asnjë shqetësim për procesin mësimor në shkollat përkatëse. Të njëjtën ndihmesë dhanë Rektoratet e IAL ku u zhvillua anketimi i studentëve. Për sa më sipër iu drejtojmë edhe atyre gjithashtu falënderime të sinqerta.

Rezervojmë falënderimet më të veçanta për kompaninë e telekomunikacioneve ONE jo vetëm për mbështetjen financiare të dhënë për këtë projekt studimor, por edhe për bashkëpunimin për orientimin e tij, si edhe për mirëkuptimin e vështirësive përgjatë realizimit të tij.

2. Rëndësia studimit: Prania e dukurive cyberbullizuese në shoqëri

Studimi i ndërmarrë, i kryer mbi bazën e anketimit, besojmë se trajton një çështje të rëndësishme të shoqërisë së sotme.

Cyberbullizimi ka tërhequr vëmendjen e studiuesve, të opinionit publik, të ligj-vënësve, të kompanive të telekomunikacionit dhe të aktorëve të tjerë socialë sepse ai, sikurse është vënë në dukje, përbën një problem shqetësues, me pasoja negative, sidomos për popullsinë me moshë të re, por jo vetëm. Ai, siç vetëkuptohet, ka prekur me përparësi shoqëritë e sotme më të zhvilluara, të cilat zotërojnë nivelin më të lartë të teknologjive më të përparuara të telekomunikacionit. Lidhur me këtë dukuri, e cila përbën një sjellje deviante me karakter masiv në përdorimin e teknologjive të reja të komunikimit, kryhen sot studime që përbëjnë një fushë dhe tematikë të re në shkencat sociale. Këndvështrimet shkencore që trajtojnë këtë temë shpesh janë ndërdisiplinore. Ato ndërthurin prurje nga psikologjia, kriminologjia, etika, nga teknologjia e infrastrukturave të komunikimit dixhital, nga sociologjia, etj.

Sikurse u theksua më lart, si rezultat i zhvillimit të mjeteve të reja të komunikimit, dukuria e cyberbullizimit është e pranishme edhe në shoqërinë shqiptare. Ajo prek në forma të ndryshme shtresa të gjera të popullsisë, duke qenë më problematike për shëndetin mendor dhe fizik sidomos të brezave të rinj. Nuk kanë munguar raste që forma shumë të ashpra të cyberbullizimit të kenë çuar edhe në humbje jete. Viktimat nuk kanë përballuar dot pasojat e cyberbullizimit duke e përjetuar atë me shqetësime të rënda psikologjike, humbje të besimit në vetvete, izolim nga shoqëria, pesimizëm, shkatërrim të personalitetit, etj. Përtej rasteve me fund tragjik, pasojat e cyberbullizimit shfaqen në masë të gjerë te grupe të caktuara njerëzish duke krijuar shqetësime serioze për ta. Ai nuk mungon të sjellë frikë, turp, poshtërim, mërzi, humbje të besimit te vetvetja, si edhe dëmtime në shëndetin fizik; duke u shoqëruar me dhimbje koke, pagjumësi, dhimbje trupi, për të mos harruar edhe një shtysë të fortë që viktimat mund të ndiejmë për t'u dhënë e u bërë të varur pas pirjes së duhanit, konsumimit të drogave, apo pas alkoolit.

Njohja e faktorëve kyç që e shkaktojnë cyberbullizimin ka rëndësi të veçantë për të marrë masa për të përballuar pasojat e tij dhe për të ulur ndjeshëm praninë e tyre në shoqëri. Nga kjo pikëpamje, studimet në këtë fushë marrin një rëndësi dhe vlerë të veçantë sidomos për prindërit dhe familjet, për shkollën dhe edukatorët, si edhe për ligjvënësit, ruajtësit e rendit publik, etj.

Nga anketimi i kryer rezultoi se ishin 17,9% e të gjithë përgjigje-dhënësve që pohuan t'u ketë ndodhur të kenë qenë nën presionin e cyberbullizimit. (Shih diagramën 1)

Pavarësisht se duket si një dukuri që prek segmente të veçanta të popullsisë, e dhëna sasiore e mësipërme dëshmon megjithatë se mund të supozohet që një ndër pesë qytetarë të ketë qenë nën presionin e fyerjeve, ngacmimeve të llojeve të ndryshme, shpifjeve, epiteteve denigruese, thashethemeve që dëmtojnë personalitetin dhe reputacionin e tyre në publik, apo ka parë të dhëna nga jeta e tij intime, apo private, jashtë dëshirës dhe vullnetit të tij, të dalin në publik, etj.

P30. Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit?

	Nr.	%
Po	155	17.9%
Jo	711	82.1%
Total	866	100.0%




Diagrama 1

E vërteta është se studime të këtij lloji të kryera në vende perëndimore kanë dëshmuar për një përqindje më të madhe personash që të anketuar të kenë pohuar se kanë ndjerë pasojat e cyberbullizimit. Në një artikull shkencor ku analizohet literatura studimore e viteve të fundit lidhur me cyberbullizimin, pohohet se:

”Sipas një studimi të kohëve të fundit me 743 adoleshentë dhe 1,058 prindër në Shtetet e Bashkuara, 59% e të rinjve raportuan se ishin viktimë të bullizmit online, përfshirë veprime si thirrje ofenduese me etiketa të papërshtatshme, shpërndarje të thashethemeve të rreme, marrje imazhesh të qarta që nuk i kishin kërkuar, pyetje të vazhdueshme se ku ndodheshin, me kë ishin dhe çfarë po bënin nga dikush tjetër përveç prindërve të tyre, kërcënime fizike, dhe shpërndarje e imazheve të drejtpërdrejta të tyre pa marrë pëlqimin e tyre (Anderson 2018).⁴

Pra, rezulton se anketimi i mësipërm ka veçuar rreth tre herë më shumë persona që janë shprehur se kanë qenë viktimë të cyberbullizimit se sa anketimi i kryer nga ana e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës.

Sikurse do ta shohim edhe në vazhdim, ka arsye të mjaftueshme për të menduar se kjo e dhënë që dëshmon për një përqindje më të madhe të viktimave të cyberbullizimit në ShBA sesa rezulton në kontekstin shqiptar të konsiderohet e mirëqenë. Nuk duhet harruar se gjithçka varet nga kuptimi që i jepet konceptit të cyberbullizimit. Nëse ai kuptohet në mënyrë shumë të gjerë, duke përfshirë jo vetëm ngacmimet e drejtuara qëllimshëm të një personi i caktuar, por edhe një klimë të përgjithshme gjuhe urrejtje në rrjetet sociale, apo edhe ekspozimin e pavullnetshëm të publikut ndaj imazheve ngacmuese jo-etike, atëherë vetë realiteti cyberbullizues merr përmasa më të mëdha.

Në anketimin e kryer nga DGK duhet thënë që cyberbullizimi si koncept u përdor në kuptimin më të drejtpërdrejtë dhe të fokusuar të tij.

Nga ana tjetër, sikurse ndodh edhe për matjen e dukurive të tjera që rëndojnë mbi personalitetin dhe dinjitetin e qytetarëve, duhet mbajtur parasysh se opinionin publik perëndimor është më i

⁴ Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka Onuchowska, Po aty

ndjeshëm se ai i vendeve të tjera. Kështu ndodh ta zëmë edhe për dukuri të tilla si dhuna në familje, prekja e lirive individuale, mos-respektimi i të drejtave në punë. Sa më i ndjeshëm të jetë opinionit publik i një vendi, aq më shumë ai priret të pohojë se ka ndjerë më gjerësisht se në kontekste shoqërisht të tjera pasoja të këtyre dukurive negative. Mirëpo, tjetër është ndjeshmëria e opinionit publik dhe tjetër realiteti faktit, objektiv, përmasa reale e dukurive që denoncohen. Edhe në anketimin e kryer nga DGK shfaqet qartë që ata që kanë ndjeshmëri më të theksuar ndaj dukurive cyberbullizuese kanë pohuar më shumë se të tjerët se kanë qenë viktima të tyre në jetën e përditshme.

Nga ana metodologjike gjejmë rastin të theksojmë se një e dhënë që lidhet me sjelljen dhe perceptimin e opinionit publik nuk mund të barazohet me përmasën objektive, reale, të asaj të dhëne si tërësi faktesh sociale. Vetëkuptohet që midis këtyre dy llojeve të dhënave ka lidhje dhe bashkëveprim. Por, gjithsesi ato nuk janë kurrësi e njëjta gjë. Thënë kjo, sigurisht ka vend për të mos injoruar rëndësinë e anketimeve për të njohur ndikimin real të fakteve shoqërore mbi opinionin publik, konsumatorin, audiencën, përdoruesit e teknologjive të komunikimit, etj.

Nga ana tjetër, e dhëna e nxjerrë nga anketimi i paraqitur më sipër në ShBA, apo edhe nga anketime të tjera të kryera në vende të BE, të cilat flasin për një përqindje më të lartë të anketuarish që kanë pësuar ndikimin negativ të dukurive cyberbullizuese sesa në anketimin e DGK, mund të shpjegohet edhe me dy arsye të tjera:

Sa më i ekspozuar të jetë individi ndaj përmbajtjeve të komunikimit në rrjetet sociale aq më e madhe bëhet mundësia që ai të ndeshi atje me dukurinë e cyberbullizimit.

Nga ana tjetër, sa më e lartë të jetë shkalla e urbanizimit dhe e përqendrimit të popullsisë në zonat urbane, aq më tepër rriten veprimet cyberbullizuese dhe pasojat e tyre.

Këto dy prirje, sikurse do t'i shohim më tutje faktohen edhe nga të dhënat e këtij anketimi.

Kur flitet për ndikimin e praktikave cyberbullizuese dhe të pasojave të tyre mbi përdoruesit e teknologjive dixhitale të komunikimit, ka vend të theksohet se ato janë të pranishme pavarësisht vendbanimit të të anketuarve. Kemi parasysh se komunikimi dixhital, me emaile, në rrjetet sociale, informimi nëpërmjet mediave on line, pjesëmarrja e qytetarëve në komunitete dixhitale, pajisja me aparate telefonike të lidhura në Internet, aksesit në platforma komunikimi si viber, whatsapp, etj., zotërimi i llogarive në platformat sociale, komunikimi me anë të videove, në messenger, etj., janë dukuri globale. Si të tilla ato karakterizohen edhe nga një relativizim i ndikimit të hapësirave gjeografike, i distancave materiale, për rrjedhojë edhe i rolit pozitës gjeografike të vendbanimit në ekspozimin ndaj dukurive deviante të cyberbullizimit.

Të dhënat e anketimit dëshmojnë gjithsesi që përgjigje-dhënësit që jetojnë në Tiranë kanë prirje të jenë më të ekspozuar se të tjerët ndaj pasojave të dëmshme të kësaj dukurie. Në raste të caktuara numri i tyre paraqitet disa herë më i madh se numri i përgjigje-dhënësve që pohojnë se kanë qenë nën presionin e sjelljeve cyberbullizuese të personave të tjerë. Kështu ai paraqitet rreth tre herë më i madh se numri i përgjigje-dhënësve që bëjnë të njëjtin pohim me banim në Laprakë; dy herë më i madh se ata me banim në Kamëz, katër herë më i madh se numri i atyre me vendbanim në Peqin, tre herë më i madh se numri i përgjigje-dhënësve që bëjnë të njëjtin

pohim dhe janë me banim në Vlorë, etj. Qytete si Elbasani, Korça gjithashtu i afrohen nga kjo përmasë të dhënave që janë marrë nga përgjigje-dhënësit me vendbanim në Tiranë.

E njëjta dukuri vihet re edhe kur krahasohen përgjigjet e të anketuarve në Elbasan dhe Korçë me përgjigje-dhënësit me vendbanim në zona urbane më të vogla në periferi të tyre. Kështu për shembull mund të vihet në dukje se nga të anketuarit me vendbanim në Elbasan, janë 25 për qind e tyre që theksojnë se janë ndodhur nën presionin e sjelljes cyberbullizuese. Ata që japin të njëjtën përgjigje, duke qenë me vendbanim në Peqin, zonë urbane në afërsi të Elbasanit, përbëjnë 7,1 përqind të tyre.

Por, megjithatë, nuk mund të thuhet se duke u bazuar në të dhënat e anketimit mund të thuhet se kemi të bëjmë me një prirje që është e njëjtë gjithandej. Me përjashtim të rastit të të anketuarve me banim në qytetin e Tiranës, mund të thuhet se ka raste kur është gjetur që cyberbullizimi të paraqitet më i dukshëm te popullsia me vendbanim në zona urbane të vogla sesa në qendrat urbane të qarqeve ku ato zona bëjnë pjesë. Për shembull rezulton se përgjigje-dhënësit që pohojnë se kanë qenë nën presionin e cyberbullizimit në Koplik janë në masën e 18,9 për qind të tyre, kurse të anketuarit që japin këtë përgjigje, por me banim në qytetin e Shkodrës, janë 6 për qind të tyre.

Me përjashtim të një qendre urbane me karakteristika të veçanta si Tirana, mund të thuhet se për shkak të natyrës globale të cyberbullizimit, si pasojë e karakteristikave të teknologjisë së komunikimit dixhital, dukuritë cyberbullizuese janë të përhapura relativisht me të njëjtat përmasa si në zonat rurale, ashtu edhe ato urbane. Ndarja “qendër e madhe urbane” versus “zonë e vogël urbane, periferike”, nuk duket se ndikon fort në përhapjen e dukurive cyberbullizuese. Më tej do të shohim se ky faktor ndikon më tepër në format e shprehjes së cyberbullizimit.

Të dhëna më të hollësishme rreth kësaj teme gjenden në diagramën 2.

P30. Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas shpërndarjes gjeografike)

	Po në nr.	Jo në nr.	Total	Po në %	Jo në %	Total
1. Tiranë	63	169	232	27.2%	72.8%	100.0%
2. Laprakë	4	37	41	9.8%	90.2%	100.0%
3. Kamëz	8	50	58	13.8%	86.2%	100.0%
4. Elbasan	25	75	100	25.0%	75.0%	100.0%
5. Peqin	3	39	42	7.1%	92.9%	100.0%
6. Shkodër	6	94	100	6.0%	94.0%	100.0%
7. Koplik	10	43	53	18.9%	81.1%	100.0%
8. Vlorë	9	84	93	9.7%	90.3%	100.0%
9. Orkum	7	33	40	17.5%	82.5%	100.0%
10. Korçë	20	87	107	18.7%	81.3%	100.0%




Diagrama 2

Mund të supozohej që për shkak të një opinioni shoqëror të bazuar më shumë në marrëdhënie ndër-individuele si ai që si rregull ekziston në zonat urbane periferike me përmasa të vogla, niveli i dukurive cyberbullizuese në këto hapësira do të ishte më i ulët te të anketuarit në qytete

kryesore të vendit. Në parim ndoshta do të kishte qenë më e lehtë të mendohej në këtë mënyrë. Por, konkretisht në rastin shqiptar ndërfiten faktorë të tjerë që e zbehin disi këtë korrelacion midis shkallës së urbanizimit dhe intensitetit të dukurive cyberbullizuese.

Ndër këta faktorë mund të përmenden dy prej tyre, të cilët veprojnë ndjeshëm dhe kanë një prani të qartë dhe mjaft të shtrirë në hapësirën sociale.

I pari, lidhet me faktin se edhe në zonat urbane periferike popullsia ka pësuar zhvendosje të fuqishme. Një pjesë e popullsisë që kanë jetuar më parë aty janë larguar drejt qendrave të mëdha urbane ose kanë shkuar në emigrim jashtë vendit. Kjo bën që opinioni shoqëror i përbashkët atje të pësojë ndikimin e zbehjes së marrëdhënieve ndër-personale. Pra, nuk ndodhemi në kushtet e mikro-shoqërive të mbyllura, të qëndrueshme prej kohësh, me njohje të ndërsjellë midis njerëzve që bëjnë pjesë në to. Dihet se atje ku njerëzit njihen drejtpërdrejt me njeri-tjetrin cyberbullizimi nuk gjen po atë terren sa edhe në shoqëritë e hapura urbane, demografikisht me përqendrim intensiv popullsisë, dhe që karakterizohen nga një anonimat social e theksuar.

Faktori i dytë ndikues mendojmë se është fakti, sikurse do të paraqitet më tej, se një pjesë e sjelljeve që prodhojnë dukuri cyberbullizuese bëhen nga persona që veprojnë në mënyrë anonime, me maska, me profile fallco, etj. Kjo i bën ata t'i shpëtojnë në një farë mënyre kontrollin social edhe nga opinioni shoqëror i qendrave të vogla urbane.

Mendojmë që teknologjia nëpërmjet së cilës vepron cyberbullizimi ka disa karakteristika të veçanta që e bëjnë ngacmimin e dëmshëm të tjetrit më intensiv sesa ngacmimi tradicional jo në linjë, por që ndodh në hapësirat reale empirike apo sikurse thuhet përgjatë komunikimit ndër-individual sy më sy. Edhe literatura e sotme ndërkombëtare vë në dukje këto karakteristika. Ato dalin në pah nëse i referohemi hollësisht përfundimit të arritur që paraqesim më poshtë:

“Së fundmi, disa kërkime shkencore kanë shqyrtuar faktorët teknologjikë që mund të nxisin ngacmimin në Internet. Dy faktorët më të studiuar të tillë janë **anonimiteti** dhe **disinhibicioni** online. Anonimiteti i referohet mungesës së një identiteti të dukshëm online, ndërsa disinhibicioni online i referohet lehtësimit të kufizimeve sociale dhe pengesave (Barlett et al. 2016; Dutton Tillery et al. 2010; Lowry et al. 2016; Tenenbaum et al. 2011). Anonimiteti që ofron interneti u lejon cyberbullizuesve të fshihen pas një emri ekrani ose një llogarie përdoruesish të rreme apo të angazhohen në akte deviante pa zbuluar identitetet e tyre të vërteta, me besimin se veprimet e tyre nuk mund të gjurmohen (Barlett 2017; Dutton Tillery et al. 2010; Wright 2014). Disa studime të tjera kanë shqyrtuar konceptin e lidhur të disinhibicionit/disociacionit në ndërveprimet online. **Disociacioni** i referohet lehtësimit të kufizimeve sociale dhe pengesave në Internet që janë zakonisht të pranishme në ndërveprimet ballë për ballë, dhe që mund të çojnë në sjellje të padëshirueshme online (Udris 2014). Në veçanti, mungesa e afërsisë fizike në Internet ka tendencën të krijojë një ndjenjë përgjegjësie të shpërndarë, duke nxitur individët të kryejnë akte që ndryshe nuk do t'i konsideronin se mund t'i kryenin personalisht. Për shembull, në një studim cilësor, Tenenbaum et al. (2011) dëshmuar

se një nivel i lartë i disociacionit online nxit ngacmimin në Internet midis nxënësve të shkollave të mesme, përveç anonimitetit.”⁵

Nga konsiderata e mësipërme veçojmë tre koncepte bazë :

- anonimiteti,
- çpengimi nga detyrimet morale,
- shkëputja midis cyberbullizuesit dhe të cyberbullizuarit.

Është e qartë se këta faktorë që mundësohen nga teknologjitë e sotme të komunikimit dhe të informimit jo vetëm e bëjnë më intensiv cyberbullizimit në krahasim me fyerjet, turpërimin e tjetrit, shpifjet e tij, etj., në marrëdhëniet empirike në shoqërinë reale, por edhe ndikojnë që dukuria deviante online të ketë natyrë globale.

Të dhënat e anketimit dëshmojnë se meshkujt po ashtu edhe femrat e anketuara e konsiderojnë veten viktime të veprimeve dhe sjelljeve cyberbullizuese. Mirëpo rezulton se femrat e anketuara pohojnë më tepër se përgjigje-dhënësit meshkujt se kanë qenë viktime të cyberbullizimit. Janë 19,6 e të anketuarave që e bëjnë këtë pohim, ndërsa janë më pak, 15,9 për qind e të anketuarve që përgjigjen po njësoj. Këto të dhëna paraqiten sipas diagramës 3.

Iu ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas gjinisë)




Diagrama 3

E vërteta është se diferenca prej rreth katër për qind midis këtyre dy të dhënave nuk është shumë domethënëse. Megjithatë, edhe kaq sa paraqitet, dëshmon për një farë pabarazie gjinore. Femra ndihet më e kërcënuar se mashkulli edhe në komunikimin dixhital. Kjo na bën ta ripohojmë se femrat, sidomos ato që iu përkasin moshave të adoleshencës, moshës së rinisë, por edhe më të rritura, ngacmohen në rrjet më tepër se djemtë, apo meshkujt në përgjithësi. Është e qartë se këtu luajnë rolin e tyre një sërë faktorësh socialë, të cilët kanë të bëjnë kryesisht me pabarazitë midis gjinive në shoqëri, të cilat janë larg së qeni të tejkaluara në shoqërinë tonë. Na duket e tepërt të ndalemi specifikisht më gjatë në këtë problem shumë të mprehtë social, i cili do të meritonte studime dhe trajtime të hollësishme të veçanta.

⁵ Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka Onuchowska, Po aty.

Fakte të panumërt sociale të raportuara nga shtypi apo të bërë njohura nga informacione që merren gjatë jetës së përditshme tregojnë gjithashtu për një agresivitet social të shprehur më shumë nga meshkujt se nga femrat. Si edhe për një ngacmueshmëri të shprehur më të madhe nga ana e meshkujve mbi femrat sesa nga femrat mbi meshkujt.

Diagrama numër 4 paraqet një sërë të dhënash sipas të cilave intensiteti i presionit të cyberbullizimit shfaqet në formën e një kurbe kur ai shihet në varësi të moshës së të anketuarve. Kjo kurbë nis e ngjitet, arrin një pikë të lartë, dhe pastaj zbritet, por pa shkuar asnjëherë drejt vlerave zero. Kjo kurbë lidhet me një faktor të pavarur sikurse është mosha e të anketuarve. Sipas të dhënave të anketimit, nuk mund të thuhet në mënyrë lineare se dukuritë cyberbullizuese rriten, ose ulen në varësi të ndryshores së pavarur : “moshë”.

Të dhënat dëshmojnë se kur 13 deri 16 vjeçarët arrijnë moshën nga 17 deri 19 vjeç, perceptimi i tyre mbi të qenit të cyberbullizuar ndryshon. Numri i atyre që konsiderohen të cyberbullizuar rritet dy herë. Pra, dukuria zgjerohet në planin e ndjeshmërisë sociale. Me siguri merr edhe pamje të tjera, të cilat meritojnë të shqyrtohen në projekte kërkimore dhe shkencore më vete. Vërejmë se edhe në mjaft studime të huaja, autorët kufizohen të matin intensitetin e dukurive cyberbullizuese, por jo në të njëjtën masë monitorojnë edhe formën që ato marrin në varësi të moshës së viktimave të tij.

Për segmentin e të anketuarve me moshë nga 20 deri në 23 vjeç përmasat sociale të cyberbullizimit duken se mbesin të njëjta si për ato të segmentit moshor të mëparshëm. Por, kur bëhet fjalë për segmentin e moshës nga 24 deri 45 vjeç, baza sociale e atyre që e konsiderojnë veten se kanë pësuar presionin cyberbullizues bëhet rreth katër herë më e shtrirë se ajo e segmentit që i përket moshës nga 13 deri 16 vjeç.

Pastaj me kalimin e moshës kurba njeh lëkundje, ka një prirje zbritëse. Këto të dhëna janë paraqitur në diagramën 4.

Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas grupmoshës)

	Po në nr.	Jo në nr.	Total	Po në %	Jo në %	Total
1. Nga 13 deri 16 vjeç	13	137	150	8.7%	91.3%	100.0%
2. Nga 17 deri 19 vjeç	48	228	276	17.4%	82.6%	100.0%
3. Nga 20 deri 23 vjeç	21	105	126	16.7%	83.3%	100.0%
4. Nga 24 deri 45 vjeç	44	99	143	30.8%	69.2%	100.0%
5. Nga 46 deri 60 vjeç	16	81	97	16.5%	83.5%	100.0%
6. Nga 61 vjeç e lart	13	58	71	18.3%	81.7%	100.0%




Diagrama 4

Ka arsye të mirënjohura që mund të shpjegojnë qartazi se përse ka një lloj gjuhe më agresive midis njeri tjetrit te personat me moshë më të re se ata me moshë të pjekur. Ajo që duam të

theksojmë është se sipas këtij anketimi segmenti moshor i ekspozuar më gjerësisht ndaj dukurive cyberbullizuese është ai nga mosha shtatëmbëdhjet vjeç deri te të dyzetat. Mirëpo, kjo nuk e lehtëson situatën për segmentin moshor adoleshent, pra me moshë nga 13 deri 16 vjeç. Për këtë ka nevojë të tërhiqet vëmendja për një lexim të kujdesshëm të kuptimit të dhënave të paraqitura më lart. Ato të dhëna shënjojnë kryesisht gjerësinë e përhapjes së dukurive të cyberbullizimit, por jo medoemos matin edhe intensitetin e tyre. Nga ana tjetër, segmenti moshor nga 13 vjeç deri 16 vjeç, ka vend të besohet se i përjeton në mënyrë më të hidhur pasojat e cyberbullizimit se individët në moshë më të rritur edhe për shkak të karakteristikave psikologjike të moshës, edhe për shkak një përvoje më të pakët në përballimin e vështirësive të jetës.

Më sipër theksuam se dukuritë e cyberbullizimit nuk janë më shumë të shtrira në qendrat e mëdha urbane sesa në zona me karakteristika më pranë ruralitetit. Këtë e paraqitëm duke i lidhur të dhënat e përfuara nga pohime të anketuarish me banim në qendra urbane kryesore të vendit, me përgjigje të dhëna nga të anketuar me banim në zona të banuara që gjenden në mes të hapësirave rurale si Koplik, Peqin, Kamëz, Orikum, etj.

Por, edhe nëse mbajmë në konsideratë jo vetëm vendbanimin e të anketuarve, por edhe vendlindjen e tyre (çka për një pjesë të konsiderueshme të anketuarish rezultojnë të njëjta), përfundimi mbetet i njëjtë. Nuk rezultojnë dallime thelbësore për sa i përket përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit me vendlindje nga zonat urbane dhe përgjigjeve të dhëna nga të anketuar me vendlindje nga zonat rurale lidhur me konsideratat e tyre për shkallën e ekspozimit ndaj dukurive cyberbullizuese. Për të dyja rastet rezultojnë rreth 17 – 18 për qind e të anketuarve që japin të njëjtin pohim, pra se kanë qenë viktima të cyberbullizimit. Të dhënat e diagramës 5 e paraqesin qartë situatën e përshkruar.

Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas vendlindjes)

	Po	Jo	Total	Po	Jo	Total
	në nr.	në nr.		në %	në %	
1. Qytet qendër qarku	109	506	615	17.7%	82.3%	100.0%
2. Qytet jo qendër qarku	28	122	150	18.7%	81.3%	100.0%
3. Zonë rurale	13	59	72	18.1%	81.9%	100.0%
4. Tjetër	4	15	19	21.1%	78.9%	100.0%




Diagrama 5

Pavarësisht se dukuritë deviante në komunikimin dixhital që përfshihen në termin cyberbullizim kanë një shtrirje të gjerë, jo i gjithë opinionin publik duket se zotëron një kuptim të qartë të termit në fjalë. Kjo shprehet në faktin që nga përgjigje-dhënësit në këtë anketim, 59 për qind e tyre pohojnë se nuk kanë pasur më parë asnjë njohuri për këtë koncept. Janë 20,9 për qind e të anketuarve që përgjigjen se kanë dëgjuar për të, por nuk janë të sigurt se e njohin saktë

përmbajtjen e këtij koncepti. Sikurse ka 20,1 për qind e të anketuarve, të cilët pohojnë se nuk dinin më parë asgjë për konceptin në fjalë. Këto të dhëna janë të paraqitura në diagramën 6.

Lidhur me këto të dhëna mund të bëhen këto komente paraprake.

Fakti që ka një masë të anketuarish që përfaqësojnë afërsisht 60 për qind të tyre, pra thuhet 2 në 3 prej tyre, të cilët pohojnë se e njohin konceptin cyberbullizëm, kjo nuk do të thotë që medoemos ata kanë një kuptim të plotë, të saktë të tij.

Problem mbeten gjithsesi 40 për qind e të anketuarve që nuk dinë asgjë ose dinë, siç shprehen, gjëra të përafërta mbi të. Sigurisht do të ishte interesante që më tej të dihej se cilave shtresa shoqërore dhe profesione u takojnë këta të fundit. Kjo mund të jetë objekt i hulumtimeve të tjera. Por, është e qartë se edhe ata që nuk e njohin konceptin cyberbullizim nuk është se nuk ndjejnë dhe nuk pësojnë ngacmime, ofendime, sharje, kërcënime të kryera nëpërmjet teknologjive dixhitale. Gjithsesi tjetër është ta përjetosh një dukuri sociale dhe tjetër të kesh për të një koncept të qartë. Mund të përfytyrojmë për shembull prindër, kujdestarë të miturish, edukatorë, mësues, etj., të cilët duke mos pasur një përfytyrim të qartë për cyberbullizimin të mos kenë mundësi të njohin apo edhe vetëm të konstatojnë pasojat e dukurive që përfshihen në të te brezi i ri. Këtu nuk është fjala të dish se çfarë është koncepti në fjalë. Por edhe si mund të përballesh me to, si mund të evitohet veprimi i tij, si mund të kurohen traumat që ai mund të shkaktojë.




Diagrama 6

Mbi të gjitha, sikurse e dëshmojnë edhe të dhënat e përftuara nga anketimi, ndërgjegjësimi mbi përmbajtjen e cyberbullizimit, lidhur me rreziqet që paraqet si edhe mbi pasojat që ai lë mbi viktimat e tij, apo edhe mbi rrugët për ta përballuar atë, e bën opinionin publik atë më të ndjeshëm dhe më veprues kundër kësaj dukurie deviante në komunikim.

Pyetja që vjen më pas duket interesante për ta ngritur: Kush është më i ekspozuar ndaj veprimit të dukurive të cyberbyllizimit? Ata që kanë më shumë njohuri për të, apo ata që nuk e dinë fare se çfarë është ai?

Kuptohet se një individ që i njeh mirë pasojat e cyberbullizimit dhe rrugët për ta shmangur atë ka aftësi më të zhvilluara se të tjerët për t'u mbrojtur prej tij. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se në

psikologjinë e tij, ai ndjehet më i sigurtë, më i mbrojtur, më pak i ekspozuar ndaj pasojave negative që cyberbullizimi shkakton. Dikush që e ka të qartë dhe të thelluar njohjen e tij ndaj këtyre dukurive, padyshim arrin ta konstatojë edhe nuancën më të hollë të sjelljeve cyberbullizuese kundër tij ose të përmbajtjeve cyberbullizuese që qarkullojnë në mjedisin shoqëror ku ai jeton. Kështu, subjektivisht ai mund të ketë perceptimin se presioni i këtyre dukurive mbi të, të jetë faktikisht më i madh. Në këtë mënyrë, nuk përjashtohet që ai të pohojë se në shoqëri veprojnë dukuri cyberbullizuese shumë më tepër sesa e ndjen praninë e tyre një individ që për këtë temë nuk ka formimin e duhur, për rrjedhojë shfaq një ndjeshmëri qytetare më të ulët se të parët ndaj kësaj dukurie.

Sikurse e dëshmojnë edhe të dhënat që raportohen nga diagrama 7, midis të anketuarve që kanë pohuar se e dinë mirë se çfarë është cyberbullizimi, janë 56,9 për qind e tyre, të cilët pohojnë se kanë qenë në raste të caktuara nën presionin e dukurive cyberbullizuese. Kurse midis të anketuarve që pohojnë se nuk dinë ndonjë gjë me rëndësi rreth kësaj dukurie, kemi vetëm 17,6 të tyre, të cilët pohojnë se kanë qenë edhe ata në ndikimin e dukurive cyberbullizuese.

Me pak fjalë, sikurse e theksuam edhe më lart, ndërgjegjësimi ndaj dukurive cyberbullizuese rrit perceptimin e shkallës së veprimit të tyre mbi individin, si edhe të intensitetit të veprimit të tij mbi opinionin publik. Duket se në një shoqëri ku qytetarët janë më të ndjeshëm për të reaguar ndaj cyberbullizimit, ky i fundit është më i pranishëm sesa në shoqëritë ku qytetarët nuk kanë të njëjtën shkallë ndërgjegjësimi. Por, ky është një iluzion subjektiv. Rritet shkalla e ndjeshmërisë, por jo faktet reale në shoqëri. Gjithsesi ndërgjegjësimi i opinionit publik mbi format dhe rreziqet e veprimeve cyberbullizuese përbën një nga rrugët kryesore për ta përballuar atë realisht. Një qytetar i ndërgjegjshëm i percepton dhe kundërshton, proteston, vepron kundër nuancave edhe më të holla të sjelljeve cyberbullizuese në komunikimin social.

Gjithsesi në planin metodologjik bëhet kujdes për të evituar ato që quhen “artefakte”, pra fakte të shprehura në të dhëna artificiale. Të tilla “artefakte” do të krijoheshin nëse do të barazohej perceptimi kolektiv i një dukurie me gjendjen reale, faktike të saj në shoqëri. Kur segmente të caktuara të opinionit publik janë më të ndjeshme ndaj një dukurie negative, pra shohin edhe nuancat më të holla të saj, kjo sigurisht shoqërohet me ndjesinë në ndërgjegjen e tyre për një shtrirje më të gjerë të kësaj dukurie në shoqëri. Por, prej kësaj ndjeshmërie më të rritur nuk duhet përfunduar se vetë dukuria reale përhapet më tepër atje ku ajo perceptohet më ndjeshëm. Në këtë rast statistikën matin shkallën e ndjeshmërisë të publikut, por jo përhapjen konkrete të dukurisë në shoqëri.

Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (Përgjigjja e atyre që e njihnin më parë kuptimin e fjalës cyberbullizim?)

	Po	E kam dëgjuar, por nuk jam i sigurt se e di mirë	Jo	Tjetër	Total	Po	E kam dëgjuar, por nuk jam i sigurt se e di mirë	Jo	Tjetër	Total
	në nr.					në %				
Po	87	39	27	0	153	56.9%	25.5%	17.6%	0.0%	100.0%
Jo	414	138	144	4	700	59.1%	19.7%	20.6%	0.6%	100.0%




Diagrama 7

Duhet kuptuar se ndërgjegjësimi i opinionit publik për rrezikshmërinë e pasojave të cyberbullizimit dhe për rrugët e parandalimit të tij nuk ndikon vetëm te ata që e pësojnë atë,. Përkundrazi, ndikon pozitivisht edhe te vetë cyberbullizuesit. Një pjesë e këtyre të fundit shpesh nuk kuptojnë se çfarë ndikimesh të dëmshme te të tjerët mund të jetë sjellja e tyre.

Jo rrallë një i cyberbullizuar kthehet në cyberbullizues.

Në këtë mënyrë studimet mbi cyberbullizimin ka vend të prekin jo vetëm pasojat e tij mbi të cyberbullizuarit, por edhe mbi vetë ata që ushtrojnë atë. Nga ana tjetër ka vend të kuptohet se cyberbullizimi ndikon negativisht jo vetëm te viktimat e tij, por edhe mbi ata që e kryejnë. Këta të fundit përfshihen nga ndjenja agresive, mund të ndodh që ngacmimi i të tjerëve bëhet qëllimi jetës së tyre, humbasin sensin e masës, bëhen asocialë, izoloohen nga shoqëria, jetojnë nën ndikimet torturuese të ndjenjave si inati, hipokrizia, etj.

Sikurse theksohet në literaturën e huaj shkencore: “Me interes është të theksohet se rishikimi nga ana jonë e literaturës tregon gjithashtu se ngacmimi online ka pasoja negative edhe për vetë ngacmuesit. Për shembull, (Hinduja dhe Patchin 2008) theksuan se ngacmimi online ul vetëvlerësimin e kriminelëve, përveç atij të viktimave, dhe i bën ata më asocialë dhe të mbyllur. Sourander et al. (2010) gjetën se ngacmimi online rrit hiperaktivitetin e ngacmuesit, pirjen e duhanit dhe alkoolit, si dhe sjellje të papërshtatshme në jetën e tyre të përditshme. Si përfundim, ngacmimi online ka një ndikim dëmshues si tek viktimat, ashtu edhe tek ngacmuesit.”⁶

Gjithsesi, duke u rikthyer te të dhënat që po paraqiten në këtë raport, theksojmë se përqendrimi mbi pasojat e cyberbullizimit te vetë autorët e tij mbetet një objektiv për hulumtime të mëtejshme.

⁶ Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka Onuchowska, Po aty.

3. Disa përkujdesje metodologjike: Përparësitë e metodës së kampionimit me *cluster*-a

Lidhur me metodologjinë e përpilimit të pyetësorit dhe të kryerjes së anketimit, në qendër të vëmendjes kanë qenë dy çështje kryesore.

E para : cilët do të ishin orientimet kryesore të pyetjeve që do t'u drejtoheshin të anketuarve?

Lidhur me këtë u përcaktuan tri përparësi të lidhura me pyetjet e mëposhtme :

1. Cilat janë shkaqet, rrethanat dhe faktorët që çojnë në praktikën cyberbullizuese?
2. Cilat janë pasojat e dëmshme kryesore të tyre mbi individin apo grupin shoqëror që ato venë në shënjestër?
3. Cilat janë rrugët e mundshme, të cilat mund të bëjnë që cyberbullizimi ta rrudhë veprimin e tij në shoqëri?

Lidhur me më sipër, është vlerësuar si i drejtë qëndrimi i autorëve të huaj të cituar më parë, të cilët në artikullin shkencor të përmendur kanë theksuar se studimi i tyre : “Shqyrton faktorët kryesorë dhe pasojat e ngacmimit kibernetik, së bashku me ndërhyrjet që pritet të ndihmojnë në frenimin e këtij fenomeni. Pyetjet kërkimore që trajton ky punim janë: (1) Cilat janë pasojat e ngacmimit kibernetik?

(2) Cilët janë faktorët kryesorë që nxisin ngacmimin kibernetik?

(3) Cilat mekanizma ndërhyrës mund të ndihmojnë në frenimin e ngacmimit kibernetik?”⁷

Në të vërtetë, tërësia e pyetjeve të pyetësorit të anketës, në rrugë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ka dashur të dije opinionin e të anketuarve rreth këtyre tri çështjeve dhe të marrë prej tyre informacione mbi to.

Një problem i rëndësishëm metodologjik, i dyti, ka qenë ai që ka të bëjë me përpunimin e modelit të kampionit të të anketuarve. Kjo për arsyen sepse dihet që vetëm një kampionim sa më i saktë i tërësisë së të anketuarve do jepte mundësinë për të marrë të dhëna sa më afër realitetit.

Theksojmë se në ndërtimin e kampionimit kemi përdorur metodën e *cluster*-ave.

Pra, nuk është kërkuar drejtpërdrejt të ndërtohet një kampion të anketuarish që të riprodhonte strukturën e individëve që përbëjnë shoqërinë shqiptare. Në vend të kërkohej të diheshin qëndrime të opinionit publik në përgjithësi për temën e marrë në shqyrtim, anketimi më tepër u përqendrua te opinione të marra brenda grupeve shoqërore të caktuara. Nga krahasimi i opinioneve të segmenteve të caktuara të shoqërisë shqiptare me njeri tjetrit, ideja ka qenë që nga njëra anë të studiohen shkaqet që ndikojnë te dukuria e cyberbullizimit dhe nga ana tjetër të ndërtohet një model mbi të gjithë opinionin shoqëror të marrë në konsideratë si një mozaik grupesh, shtresash, segmentesh shoqërore me opinionet dhe qëndrimet e tyre të veçanta.

Metodologjikisht është nisur nga ideja se mund të gjenden arsyet, shkaqet, rrethanat e opinioneve dhe sjelljeve të ndryshme mbi cyberbullizimin duke i vendosur ato në një lidhje shkakësore apo funksionale me ndryshore të pavarura. Nisur nga këtë u synua të vëzhgoheshin se sa të ndryshme ose të pandryshme janë opinionet dhe sjelljet e segmenteve të ndryshme të të anketuarve në varësi të ndryshore të pavarura të marra në konsideratë.

⁷ Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka, Po aty.

Nga ana tjetër, duhet mbajtur parasysh se interesimi shkencor ka qenë kryesisht për të parë ndikimin e cyberbullizimit mbi moshat e reja. Për këtë arsye individët e këtyre moshave kanë përbërë një segment të gjerë të kampionit të të anketuarve.

Në këtë mënyrë, një shpërndarje e përgjithshme e ka segmentuar kampionin e të anketuarve në tre pjesë kryesore:

- Nxënës: 320 të anketuar
- Studentë: 241 të anketuar
- Qytetarë të ndryshëm, me moshë përmbi 24 vjeç : 300 të anketuar.

Theksojmë edhe njëherë se në kuadrin e metodës së përzgjedhur të anketimit nuk ka rëndësi prioritare numri i të anketuarve për çdo kategori statistikore të anketuar. Kështu, numri i studentëve, i nxënësve apo edhe i qytetarëve të anketuar mund të ishte edhe më i madh ose më i vogël. Kjo lidhet edhe me mundësitë që ky anketim ka pasur në rrafshin material apo financiar. Kur flasim për një rëndësi vetëm relative të numrit të individëve të anketuar sipas kategorive të marra në shqyrtim, këtë e bazojmë në një arsye të qartë metodologjike. Sjellja dhe opinionet e të anketuarve janë vënë përgjithësisht në raport dhe në krahasim me ato të individëve të së njëjtës kategori statistike. Në këtë mënyrë, prirjet dhe të dhënat sasiore që karakterizojnë profilin e çdo segmenti të anketuarish janë krahasuar me ato të segmenteve të tjera.

Kur bëhet fjalë për përzgjedhjen e nxënësve të anketuar është përdorur metoda e kuotimit si edhe ajo e përzgjedhjes rastësore të të anketuarve sipas kuotave të përcaktuara që më parë. Sikurse tregon tabela 6, për të bërë të mundur anketimin e nxënësve, janë përzgjedhur 11 shkolla të mesme të vendit që e kryejnë aktivitetin e tyre në Jug, në Shqipërinë e Mesme, Tiranë dhe në Veri. Këto shkolla të mesme, për lehtësi të organizimit të punës, janë përzgjedhur në ato qarqe ku në qendrat urbane të tyre funksionojnë edhe universitete. Sikurse e tregon tabela e përmendur më sipër ideja ka qenë që brenda secilit nga pesë qarqet e përzgjedhur, të anketohen nxënës të dy shkollave të mesme, njëra në qendrën e qarkut (Tiranë, Korçë, Vlorë, Elbasan, Shkodër) dhe tjera në një zonë urbane në periferi të saj, por që gjithsesi përbën një njësi administrative më vete (Kamëz, Laprakë, Peqin, Koplik, Orikum). Këtu bën përjashtim vetëm rasti i Korçës, ku për arsye të paparashikuara nuk u krijua mundësia të anketoheshin nxënës në shkollën e mesme të Maliqit. Për të ruajtur numrin e parashikuar të të anketuarve nxënës, kjo mungesë u plotësua duke kryer një anketim shtesë, i paplanifikuar në fillim, në shkollën e mesme në Laprakë.

Anketimi i nxënësve përgjithësisht u mbështet në këtë ndarje: Në Tiranë u mendua të anketoheshin gjithsej 80 nxënës të shkollave të mesme në dy nga shkollat e mesme të qytetit. Në secilën nga shkollat e mesme të qendrave të qarqeve të anketoheshin rreth 30 nxënës. Kurse në secilën nga shkollat e mesme të zonave të banuara në periferi të tyre të anketoheshin rreth 20 nxënës. Përgjithësisht është punuar që këto raporte të ruhen, pavarësisht ndonjë lëvizjeje të lehtë nga numri i parashikuar për shkaqe vështirësish të ndryshme.

Po kështu u parashikua që të anketuarat vajza dhe të anketuarit djem të ishin të barabartë në numër. Gjysma e të anketuarve të ishin nxënës të viteve të para të shkollave të mesme, kurse gjysma të tjetër të përbëhej nga nxënës maturantë. Me anë të kësaj ndarjeje u kërkuar të kishim një shpërndarje sa më të plotë për të pasur të anketuar për segmentin moshor nga 13 deri në 16

vjeç. Sipas kuotave të përcaktuara sipas kriterëve të mësipërm, të anketuarit u zgjodhën në mënyrë rastësore.

Në tabelën 6 paraqitet gjithashtu edhe shpërndarja e të anketuarve studentë. U përzgjedhën pesë IAL të rëndësishme publike që funksionojnë në po ato qendra qarku sikurse u shpjegua më sipër. Studentët e anketuar u synua të ishin kryesisht të ndarë në numër sa më të barabartë në studentë të viteve të para dhe studentë në nivelin e studimeve master. Në këtë mënyrë të bëhej e mundur të plotësohej me një shtrirje sa më të gjerë me individë të anketuar studentë segmenti moshor nga 17 deri 23 vjeç. Lidhur me shpërndarjen e studentëve të anketuar u mendua që në Tiranë të merreshin në konsideratë 80 studentë, të përzgjedhur rastësisht, kurse për secilin IAL që funksionon në qarqet e tjera, të anketoheshin rreth 40 studentë. Me ndonjë devijim të lehtë për arsye objektive, edhe ky kuotim u respektua. Kurse për sa i përket ndarjes në vajza/djem, kuotat kanë ndjekur kriterin për të anketuar një numër të barabartë individësh nga secila gjini.

Rrethi/Qyteti	Terreni /Institucioni	Viti	Nr. Anketash
Tiranë	Terren		70
	Qemal Stafa	I / III	40
	Petro Nini Luarasi	I / III	40
	UT - FHF	I / III	20
	UT - FSHS	I / III	20
	UT - FSHN	I / III	40
Kamëz	Terren		30
	Ibrahim Rugova	I / III	30
Laparakë	Terren		20
	Aleks Buda	I / III	21
Elbasan	Terren		30
	Kostandin Kristoforidhi	I / III	30
	A.Xhuvani - FSHH	I / III	20
	A.Xhuvani – FSHN	I / III	20
Peqin	Terren		20
	Zihni Magani	I / III	27
Vlorë	Terren	I / III	30
	Ali Demi	I / III	29
	I.Qemali - FSHH	I / III	15
	I.Qemali - FSHTN	I / III	20
Orikum	Terren		20
	Hasan Pulo	I / III	20
Korçë	Terren	I / III	30
	Themistokli Gërmenji	I / III	30
	F.S.Noli - FEF	I / III	25
	F.S.Noli - FSHNH	I / III	21
Shkodër	Terren	I / III	30
	Jordan Misja	I / III	30
	L.Gurakuqi - FSHS	I / III	20
	L.Gurakuqi - FSHN	I / III	20
Koplik	Terren	I / III	20
	Sherif Hoxha	I / III	22
Totali Anketa			869

Tabela 6

Në qendrat e qarqeve dhe në zonat periferike të tyre u anketuan sipas kuotave të përcaktuara edhe qytetarë të ndryshëm. Sipas kuotave, këta të anketuar janë përzgjedhur rastësisht. Është mbajtur parasysh kriteri i respektimit të një numri të barabartë meshkujsh e femrash të anketuar. Këta të anketuar në hapësirat publike të qendrave të qarqeve të përmendura më lart apo të zonave urbane periferike me to janë përzgjedhur mbi moshën 24 vjeç. Kjo për arsye se nën këtë moshë anketimi u krye pranë institucioneve arsimore. Ata u ndanë në tre segmente moshore.

Kriteri i shpërndarjes ka qenë : Në qytetin e Tiranës të anketoheshin 70 qytetarë; në secilën nga pesë qendrat e qarqeve të anketoheshin nga 30 qytetarë; kurse në secilën nga zonat urbane periferike me to të anketoheshin nga 20 qytetarë. Sikurse e dëshmon tabela 7, përgjithësisht, me ndonjë devijim të lehtë për arsye objektive, edhe ky përpjesëtim u respektua.

	TIRANË		Tirane	Kamez
Mosha	TOTALI		Shuma	Shuma
24 –45	48		28	12
46 - 66	48		28	12
Mbi 66	24		14	6
Totali	120		70	30

	ELBASAN		Elbasan	Peqin
Mosha	TOTALI		Shuma	Shuma
24 –45	20		12	8
46 - 66	20		12	8
Mbi 66	10		6	4
Totali	50		30	20

	KORÇË		Korçë	
Mosha	TOTALI		Shuma	
24 –45	12		12	
46 - 66	12		12	
Mbi 66	6		6	
Totali	30		30	

	SHKODËR		Shkoder	Koplik
Mosha	TOTALI		Shuma	Shuma
24 –45	20		12	8
46 - 66	20		12	8
Mbi 66	10		6	4
Totali	50		30	20

	VLORE		Vlore	Orikum
Mosha	TOTALI		Shuma	Shuma
24 –45	20		12	8
46 - 66	18		10	8
Mbi66	10		6	4
Totali	48		28	20

Tabela 7

A përfaqëson numri i të anketuarve në përqindje, përqindjet reale të segmenteve moshore në tërësinë e popullsisë në Shqipëri?

Këtë pyetje që sigurisht do ta kishim në qendër të vëmendjes nëse do të krijonin një kampion që do të riprodhonte në miniaturë raportet moshore të popullsisë në Shqipëri. Ndërsa meqë kemi përdorur metodën e *cluster-ave*, këtë pyetje mund ta tejkalojmë. Edhe njëherë qartësojmë: Në këtë rast na interesojnë raportet numerike brenda çdo *cluster-i* për t'i krahasuar me ato të

cluster-ave të tjerë dhe jo të dhëna numerike të përgjithshme të pa konkretizuara sipas segmenteve sociale të veçantë.

Në këtë mënyrë, baza e të dhënave e krijuara përmban një potencial shumë të mirë për ta ndriçuar dukurinë e cyberbullizimit sipas disa ndryshoreve të pavarura, dhe mbi të gjitha për ta përqendruar me përparësi këndvështrimin tonë analitik te moshat e reja që janë edhe më të prekura prej tij.

Në këtë mënyrë, është bërë e mundur që sipas nevojave të specifikohen opinionet e mbledhura si edhe informacionet e ardhura nga përgjigjet e dhëna ndaj pyetësorit të anketës, sipas ndryshoreve të pavarura si më poshtë:

- Vend ndodhja dhe vendlindja e të anketuarve
 - Mosha
 - Arsimi
 - Statusi socio-profesional
 - Gjinia
 - Të qënurit banor i zonave urbane kryesore apo i zonave urbane periferike të tyre
- Etj.

Si edhe në varësi të të dhënave të tjera si:

- Shkalla e njohurive që i anketuari zotëron për cyberbullizimin
- Lloji i teknologjisë dixhitale që përdor për të komunikuar
- Shkalla e përdorimit të Internetit
- Niveli i aktivitetit të tij në rrjetet sociale
- Profili i tij psikologjik
- Shkalla e socializimit,
- Etj.

Nga pikëpamja gjeografike të anketuarit janë klasifikuar jo vetëm sipas qendrave të banuara, por edhe në shkallë më të gjerë : Veri, Shqipëri e Mesme, Jug. Sikurse e tregon edhe diagrama 8, të anketuarit nga Tirana është përzgjedhur të jenë afërsisht sa dyfishi i atyre me banim në qendrat e tjera urbane. Kjo përzgjedhje është bërë për shkak të diferencave të ndjeshme në popullsi midis Tiranës dhe qyteteve të tjerë të marrë në konsideratë. Me po ato kriterë, të anketuarit e përzgjedhur me vendbanim në qendrat e tjera urbane të karakterizuara si “qendra qarqesh” të jenë afërsisht sa dyfishi i të anketuarve me vendbanim nga zonat urbane periferike.

.. Shpërndarja gjeografike

Zona e monitorimit	Nr.	%
1. Tiranë	232	26.7%
2. Laprakë	41	4.7%
3. Kamëz	59	6.8%
4. Elbasan	100	11.5%
5. Peqin	42	4.8%
6. Shkodër	100	11.5%
7. Koplik	53	6.1%
8. Vlorë	95	10.9%
9. Orikum	40	4.6%
10. Korçë	107	12.3%
Total	869	100.0%




Diagrama 8

Edhe përzgjedhja e të anketuarve sipas moshës së tyre ka mbajtur në konsideratë dy përparësi kryesore.

E para, interesimin e shtuar për të njohur kryesisht pasojat dhe shkaqet e cyberbullizimit të moshat e reja.

E dyta, për të kuptuar evoluimin e ndikimit të dukurive cyberbullizuese mbi mbi ta në varësi të ndryshimit të moshës.

Për këtë arsye sikurse e paraqet diagrama 9, segmentet moshore përfaqësohen në kampionin e anketimit si më poshtë :

Mosha 13 – 16 vjeç që korrespondon me statusin socio-profesional të nxënësit : 17,4 % të të anketuarve.

Mosha 17 – 19 vjeç që korrespondon me statusin socio-profesional e nxënësit, në vite më të larta shkollimi: 32% të të anketuarve.

Mosha 20 – 23 vjeç që korrespondon me statusin socio-profesional të studentit: 14,5 % të të anketuarve.

Mosha 24 – 45 vjeç, e konsideruar një moshë kur individi ka përfunduar studimet dhe ka hyrë gradualisht në segmentin e moshës mesatare: 16,5 % të të anketuarve.

Mosha 46 – 60 vjeç përfaqëson 11,2 % e të anketuarve.

Mosha mbi 60 vjeç përfaqëson 8,3 % e të anketuarve.

. Mosha

Mosha	Nr.	%
1. Nga 13 deri 16 vjeç	151	17.4%
2. Nga 17 deri 19 vjeç	277	32.0%
3. Nga 20 deri 23 vjeç	126	14.5%
4. Nga 24 deri 45 vjeç	143	16.5%
5. Nga 46 deri 60 vjeç	97	11.2%
6. Nga 61 vjeç e lart	72	8.3%
Total	866	100.0%




Diagrama 9

Përzgjedhja e të anketuarve sipas nivelit arsimor, sidomos kur bëhet fjalë për moshat deri në 24 vjeç përcaktohet në një masë të madhe nga metodologjia e përcaktimit të kuotave të të anketuarve sipas grup-moshave. Kurse për moshat mbi 24 vjeç, kjo e dhënë është rastësore. Të dhënat në këtë drejtim i jep diagrama 10.

Arsimi i kryer nëse nuk jeni nxënës ose student. Nëse jeni nxënës ose student tregoni arsimin që ndiqni aktualisht!

Arsimi	Nr.	%
1. 9 – vjeçar	60	7.0%
2. I mesëm	452	52.4%
3. Universitar	348	40.3%
4. Tjetër	3	0.3%
Total	863	100.0%




Diagrama 10

Pa u ndalur veçanërisht të dhënat që kanë të bëjnë me statusin socio-profesional të të anketuarve, sepse ato paraqiten me hollësi të diagrama 11, theksojmë vetëm se sipas kriterëve tashmë të paraqitura, të anketuarit që pohojnë se kanë statusin socio-profesional të nxënësit përbëjnë 52,4 % të të anketuarve, kurse studentët përbëjnë 40,3 % të të anketuarve.

P6. Statusi socio-profesional aktual. Jepni vetëm një përgjigje! (Tregoni vetëm gjendjen socio-profesionale që e konsideroni kryesore)

Statusi socio-profesional aktual	Nr.	%
1. Nxënës	299	34.5%
2. Student	270	31.2%
3. Nëpunës administrativ në institucione publike ose private	57	6.6%
4. Profesion intelektual si artist, mjek, gazetar, avokat, etj.	22	2.5%
5. Punonjës shërbimesh	57	6.6%
6. Punonjës në prodhimin urban, industrial, artizanal	8	0.9%
7. Punonjës në bujqësi dhe blegtori	11	1.3%
8. Pensionist	53	6.1%
9. I papunë që kërkon punë	19	2.2%
10. Shtëpiak, shtëpiake	28	3.2%
11. Kam dy ose më tepër nga këto statuse	10	1.2%
12. Tjetër	32	3.7%
Total	866	100.0%




Diagrama 11

Edhe lidhur me vendlindjen e të anketuarve, të dhënat kanë dalë kryesisht falë rastësisë. Nuk janë përcaktuar strikt sipas kuotave. Por, në një masë të madhe, edhe ato janë ndikuar nga përzgjedhja e vendbanimit të të anketuarit. Por, jo tërësisht. Për dy arsye kryesore. E para, sepse janë anketuar në një masë të madhe studentë, të cilët edhe pse banojnë kryesisht në qytetet ku janë vendosur universitetet ku ata studiojnë, jo medoemos të gjithë kanë lindur atje. Së dyti, nga një arsye tjetër që lidhet me emigrimin e popullsisë nga fshati në qytet.

Gjithsesi, sikurse e paraqet diagrama 12, të anketuarit që kanë lindur në qytete që janë qendra qarqesh përbëjnë 71,8 % të të anketuarve. Ata që kanë lindur në qytete që nuk janë qendra qarqesh përbëjnë 17,6 % e të anketuarve. Të lindurit në zonat rurale përbëjnë 8,3 % të të anketuarve. Nga njëra anë këto përpjesëtime lejojnë ta shohim cyberbullizimin kryesisht si faktor urban, por nga ana tjetër, mundësojnë të shihet edhe se çfarë ndikimi ka vendlindja urbane ose rurale e të anketuarit mbi sjelljet e tij komunikuese si edhe me qëndrimet që ai ka lidhur me cyberbullizimin.

Ku keni lindur

Vendlindja	Nr.	%
1. Qytet qendër qarku	617	71.8%
2. Qytet jo qendër qarku	151	17.6%
3. Zonë rurale	72	8.4%
4. Tjetër	19	2.2%
Total	859	100.0%




Diagrama 12

Lidhur me raportet gjinore, është e vetëkuptueshme që ato janë përcaktuar sipas kuotave. Ka një përfaqësim pothuajse të njëjtë midis të anketuarave femra dhe atyre meshkuj, sikurse e paraqet diagrama 13.

P1.Gjinia

Zona e monitorimit	Nr.	%
1. Femër	446	51.7%
2. Mashkull	417	48.3%
Total	863	100.0%




Diagrama 13

4. A është teknologjia shkak për dukuritë cyberbullizuese?

Nga vetë përkufizimi i saj, dukuria e cyberbullizimit është e lidhur në thelb me komunikimin me mjetet e reja të teknologjisë dixhitale. Kuptohet se këto mjete formojnë një sistem të tërë që është në shfrytëzim nga përdoruesi masiv. Pa dashur t'i specifikojmë në mënyrë analitike, theksojmë vetëm se secila prej tyre përbën një risi në historinë e njerëzimit që ka themeluar komunikimin e personalizuar dhe masiv horizontal numerik.

Ka shumë njerëz sot, të cilët mendojnë se është pikërisht teknologjia dixhitale shkak që kanë bërë të lindin dukuritë që përfshihen në konceptin e cyberbullizimit. Vetiu lind pyetja: Vërtet, a është teknologjia dixhitale shkak i shqetësimeve që pësojnë komunikuesit nga të tjerët përgjatë komunikimeve të përditshme?

Ka autorë të huaj që pasi kanë analizuar hollësisht literaturën shkencore mbi cyberbullizimin, kanë arritur në përfundimin që kjo literaturë ende nuk e ka venë theksin si dhe sa duhet të roli i faktorëve teknologjikë në këtë kontekst. Kur kanë shprehur këtë mendim, ata nuk e lidhin konsideratën e tyre vetëm me kërkimet teorike, por edhe me kërkime shkencore të natyrës eksperimentale:

”Nëse do ta përmbledhnim, do të thoshim se shumica e studimeve mbi shkaqet e ngacmimit kibernetik (cyberbullying) janë përqendruar te faktorët individualë, duke i kushtuar më pak vëmendje faktorëve shoqërorë ose teknologjikë. Meqenëse ngacmimi kibernetik ndodh përmes Internetit (një ndërfaqe teknologjike) dhe rrjeteve sociale online (një hapësirë sociale e ndërmjetësuar nga teknologjia), do të pritej që faktorët shoqërorë dhe teknologjikë të mbisundonin diskutimin mbi ngacmimin kibernetik. Megjithatë, nuk ndodh krejtësisht kështu çka përfaqëson një “mangësi” dhe një mundësi në kërkimet ekzistuese. Duke qenë se faktorët teknologjikë përbëjnë dallimin kryesor që e ndan ngacmimin kibernetik nga ai tradicional (ballë për ballë), ndoshta ata kanë ndikimin më të thellë për ta frenuar këtë sjellje përmes krijimit të ndërfaqeve dhe mjeteve të duhura për zbulim.”⁸

Qëndrimi i autorëve që janë cituar më sipër na duket i drejtë. Ka shumë vend që në analizat që i bëhen cyberbullizimit të mbahet parasysh se dukuritë e tij shfaqen gjatë përdorimit të teknologjive të reja dixhitale. Praktikisht cyberbullizueset përfitojnë duke u lehtësuar nga mundësi teknike të teknologjisë së re. Megjithatë, këta autorë nuk përfundojnë duke thënë se është teknologjia shkak i ngacmimit kibernetik.

Kur i rikthehem pyetjes që formuluam pak më sipër, theksojmë se studimi në formë anketimi që paraqitet këtu ka synuar të japë elemente përgjigjeje për pyetjen e ngritur më sipër. Ajo përbën një pyetje që kërkon përgjigje nga këndvështrime të ndryshme. Një anketim ka mjetet dhe teknikat e veta për ta realizuar një gjë të tillë.

⁸ Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka Onuchowska, Po aty.

Paraprakisht vëmë në dukje se ka njerëz që duket se ngatërrojnë dy çështje të ndryshme. Të lidhura me njëra tjetrën, por gjithsesi të ndryshme. E para është çështja nëse teknologjia krijon mundësi, lehtësira, kushte për sjellje cyberbullizuese? E dyta, është çështja nëse kjo teknologji është shkak për këto sjellje deviante në komunikimin dixhital? Ngatërrimi i këtyre dy pyetjeve me njëra tjetrën, padyshim që sjell edhe ngatërresa në përgjigjet e dhëna.

Në pyetësorin e anketës të këtij studimi përfshihen shumë pyetje që kanë si synim pikërisht të ndriçojnë mesa munden rolin e teknologjive të reja të komunikimit në lindjen dhe ndikimin e praktikave cyberbullizuese mbi individin që komunikon.

Le të shohim se çfarë tregojnë të dhënat sasiore!

Kur të anketuarit janë pyetur se cili është mjeti kryesor i komunikimit dixhital që ata vetë përdorin?, përgjigjet e tyre kanë qenë të ndryshme. Diagrama 14 na paraqet të dhëna se sa janë ndjerë të cyberbullizuar ata që përdorin me prioritet një ose një tjetër mjet komunikimi. Nga të dhënat del se ata që kanë pohuar se përdorin laptopin si mjet kryesor komunikimi, shprehen në masën 21,1 % të tyre se kanë pësuar presionin e praktikave cyberbullizuese. Kurse ata që thonë se si mjet kryesor komunikimi kanë telefonin celular, pohojnë në masën 18,9 për qind të tyre se janë ndjerë të cyberbullizuar. Vëmë re se është kurdoherë e njëjta e dhënë numerike që shfaqet përafërsisht. Nga të gjitha këndvështrimet del se afërsisht njëri ndër pesë të anketuar pohon se ka pësuar ndikimet negative të cyberbullizimit.

Në pamje të parë duket se ata që përdorin si mjet kryesor komunikimi laptopin janë ndjerë lehtësisht më të cyberbullizuar se ata që kanë telefonin si mjet kryesor komunikimi. Nëse analiza mbështetet në prirje që shprehen në përqindje, ky pohim është i vërtetë. Por, nëse e shohim nga pikëpamja e numrit real të atyre që shprehen se janë ndjerë të cyberbullizuar, situata paraqitet ndryshe. Përse e theksojmë këtë? Arsyeja është se ata që pohojnë se kanë laptopin si mjet kryesor komunikimi dhe janë ndjerë të cyberbullizuar përbëjnë gjithsej 48 të anketuar ndër 213 prej të anketuarve që përgjigjen se mjeti i tyre kryesor i komunikimit është laptopi. Ndërsa ata që pohojnë se janë ndjerë të cyberbullizuar midis atyre që shprehen se si mjet kryesor komunikimi kanë telefonin celular janë 88 ndër 378. Situata është pra krejt tjetër. Numri i të anketuarve që janë ndjerë të cyberbullizuar ndërkohë që kanë telefonin celular si mjet kryesor komunikimi është pothuajse dy herë më i lartë se numri i atyre që janë ndjerë të cyberbullizuar dhe thonë se kanë laptopin si mjet kryesor komunikimi. Raporti në numra të plotë realë është 48 mbi 88 të anketuar. Nëse do të donim që nga këtej të krijonim përfytyrimin e prirjeve që shfaqen në shoqërinë e gjerë reale do të thoshim se të cyberbullizuarit më të shumtë janë ata që përdorin teknologjinë e komunikimit nëpërmjet telefonisë celulare.

Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas mjetit kryesor të komunikimit)

	Po	Jo	Total	Po	Jo	Total
	në nr.			në %		
1. Kompjuter i tavolinës	11	117	128	8.6%	91.4%	100.0%
2. Kompjuter laptop	45	168	213	21.1%	78.9%	100.0%
3. Telefoni celular	88	378	466	18.9%	81.1%	100.0%
4. Tableta	1	12	13	7.7%	92.3%	100.0%
5. Nuk mund ta dalloj sepse përdor njësoj më shumë se një nga këto teknologji	1	9	10	10.0%	90.0%	100.0%
6. Tjetër	3	9	12	25.0%	75.0%	100.0%




Diagrama 14

Përmasat reale të dukurisë mund të imagjinojnë më qartë nëse shihen të dhënat lidhur me atë se sa telefoni celular konsiderohet nga të anketuarit si mjeti kryesor i komunikimit. Nga të dhënat e diagramës 15 del se të anketuarit që pohojnë se kanë telefonin celular si mjet kryesor komunikimi përbëjnë 94,7 % të numrit të përgjithshëm të të anketuarve.

Cili është mjeti kryesor me të cilin ju vetë komunikoni më shpesh personalisht ?

	Nr.	%
1. Kompjuter i tavolinës	6	0.7%
2. Kompjuter laptop	13	1.5%
3. Telefoni celular	823	94.7%
4. Tableta	5	0.6%
5. Nuk mund ta dalloj sepse përdor njësoj më shumë se një nga këto teknologji	20	2.3%
6. Tjetër	2	0.2%
Total	869	100.0%



Diagrama 15

Komunikimi me anë të telefonisë celulare përbën mjetin kryesor të komunikimit për të anketuarit pavarësisht vendbanimit të tyre. Këtë na e paraqesin edhe të dhënat e diagramës 16. Nëpërmjet tyre dallohen dy karakteristika kryesore.

Së pari, përdorimi i telefonisë celulare si mjet kryesor komunikimi e kalon ndjeshëm përdorimin e të gjitha teknologjive të reja për të komunikuar.

Së dyti, kjo prirje vihet re gjithandej duke e homogjenizuar sipas këtij kriteri pothuajse të gjithë hapësirën publike të komunikimit.

Kjo do të thotë se është e njëjta gjendje që paraqitet si në kryeqytet, si në qytetet kryesore që janë qendra qarqesh, ashtu edhe në zonat urbane periferike të tyre pranë ose në hapësirat rurale të vendit, pothuajse njësoj si në Jug, si në Veri, ashtu edhe në Shqipërinë e Mesme.




Diagrama 16

Kur flitet për përdorimin prioritar të telefonisë celulare, me këtë nuk nënkuptohet thjesht dhe vetëm komunikimi me anë të thirrjeve telefonike.

Bisedat telefonike midis dy personave individualë, të njohur me njëri tjetrin, nuk janë rastet kur shfaqen si rregull sjelljet cyberbullizuese. Ndonëse nuk përjashtohet krejtësisht prej andej. Ka telefonata, kryesisht nga të panjohur, të cilat edhe ato mund të përbëjnë ngacmime kibernetike, fyerje, kërcënime, etj. Por rastet e sjelljeve cyberbullizuese në këtë kanal komunikimi janë të rralla sepse zakonisht thirrjet telefonike bëhen mes njerëzve të njohur midis tyre dhe që si rregull që mbajnë midis tyre marrëdhënie etike normale. Telefoni celular përbën një teknologji që e lehtëson cyberbullizimin kur ai lidhet në mënyra të ndryshme me sinjalin e Internetit. Ekranin e vogël të telefonit në këtë rast në këtë rast bëhet një “portë” ku rrezikojnë të “hyjnë” përmbajtje cyberbullizuese nga komunikime me anë të emaileve, platformave të mesazheve të një-çastshëm “*instant messages*” : sms, texto në viber, whatsapp, video, nga konsultimi i rrjeteve sociale, etj.

Anketimi tregon se përgjigje-dhënësit pohojnë se në një pjesë të konsiderueshme të tyre, në një rrugë ose në një tjetër, e kanë të lidhur telefonin celular në Internet.

Sipas të dhënave të diagramës 17, janë 41% e të anketuarve që pohojnë se telefoni i tyre është i lidhur me Internetin në mënyrë të pakufizuar në kohë dhe në debit; 38,7 % e të anketuarve kanë pohuar se telefoni që zotërojnë është i lidhur me Internetin sipas kontratave me kohë dhe debit të kufizuar; ndërsa 16,2% e të anketuarve kanë pohuar se kanë mundësi të lidhen me Internetin ose nëpërmjet teknologjisë wifi në familje apo edhe në hapësira të tjera publike.

Gjithsesi, ata që kanë pohuar se lidhen në Internet vetëm nëpërmjet teknologjisë wifi në hapësira publike, si lokale, hapësira tregtare, shkolla, etj., së bashku me ata që kanë pohuar se nuk e kanë mundësinë të lidhen në Internet, përbëjnë vetëm 6 për qind e të anketuarve.

Çfarë lloji telefoni përdorni personalisht?

	Nr.	%
1. Smartphone me lidhje të pakufizuar në Internet	353	41.0%
2. Telefon i thjeshtë që nuk lidhet dot në Internet	18	2.1%
3. Smartphone me lidhje Interneti me kontratë me afatë të kufizuara kohore	147	17.1%
4. Smartphone me lidhje Interneti sipas ofertave javore, dyjavore, mujore	186	21.6%
5. Nuk përdor fare telefon aktualisht	6	0.7%
6. Smartphone me të cilin lidhem vetëm me Wi-Fi në banesë	106	12.3%
7. Smartphone me të cilin lidhem vetëm herë pas here me Wi-Fi jashtë banesë, në kafene, etj.	34	3.9%
8. Tjetër	12	1.4%
Total	862	100.0%




Diagrama 17

Kuptohet vetiu që përgjigje-dhënësit që pohojnë se kanë mundësi lidhjeje të telefonit celular me Internetin janë më të ekspozuar se ata që zotërojnë vetëm një telefon të thjeshtë me të cilin nuk e kanë mundësinë e për ta realizuar këtë lidhje.

Por, sikurse e bëjnë të qartë të dhënat e diagramës 18, nuk mund të thuhet se sa më shumë që një komunikues, me anë të telefonit celular, ka mundësi të shfrytëzojë lidhjen në Internet, aq më shumë ekspozohet ndaj sjelljeve cyberbullizuese të të tjerëve.

Aksesi më intensiv, më i gjerë, më i zgjatur në kohë në teknologjitë e komunikimit me lidhje në Internet, përdorimi i telefonisë celulare të lidhur me sinjal Interneti në mënyrë më të bollshme, me debit më të lartë përmbajtjesh hyrëse ose dalëse, jo medoemos e bën më të ekspozuar konsumatorin ndaj cyberbullizimit. Kjo do të thotë se një abonent mund të ketë lidhje pa kufizim të Internetit në celularin e tij, por ky fakt nuk do të thotë se ai prej këndeje do të pësojë medoemos më tepër ndikime cyberbullizuese sesa dikush tjetër që ta zëmë ka lidhje Interneti në telefonin e tij vetëm sipas afateve kohore të kufizuara. Ndikimi i cyberbullizimit duket se varet më tepër nga fakti sesi përdoret telefoni celular, dhe jo nëse aksesit në teknologji është me intensitet më të lartë ose më të ulët.

Në këtë kuptim nuk duket se është niveli i përdorimit të teknologjisë dixhitale që përcakton shkallën e ekspozimit ndaj dukurive cyberbullizuese.

Të dhënat e diagramës 18 flasin qartë për sa më sipër. Të anketuarit që kanë pohuar se kanë lidhje të pakufizuar Interneti në celularin e tyre, thonë në masën 17 për qind të tyre se kanë qenë nën presionin e sjelljeve cyberbullizuese. Kurse ata që kanë pohuar se kanë lidhje Interneti në telefonin e tyre celular sipas afateve kohore të kufizuara dhe kanë dhënë të njëjtën përgjigje si të parët, përbëjnë 25 për qind e tyre. Këtë lloj përgjigjeje midis atyre që pohojnë se lidhen në Internet me telefonin e tyre celular vetëm në hapësira publike ku funksionojnë sisteme wifi, e kanë dhënë 21,2 për qind e tyre.

Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas llojit të telefonit)

	Po	Jo	Total	Po	Jo	Total
	në nr.	në nr.		në %	në %	
1. Smartphone me lidhje të pakufizuar në Internet	60	292	352	17.0%	83.0%	100.0%
2. Telefon i thjeshtë që nuk lidhet dot në Internet	2	16	18	11.1%	88.9%	100.0%
3. Smartphone me lidhje Interneti me kontratë me afatë të kufizuara kohore	19	127	146	13.0%	87.0%	100.0%
4. Smartphone me lidhje Interneti sipas ofertave javore, dyjavore, mujore	47	139	186	25.3%	74.7%	100.0%
5. Nuk përdor fare telefon aktualisht	0	6	6	0.0%	100.0%	100.0%
6. Smartphone me të cilin lidhem vetëm me Wi-Fi në banesë	18	88	106	17.0%	83.0%	100.0%
7. Smartphone me të cilin lidhem vetëm herë pas here me Wi-Fi jashtë banese, në kafene, etj.	7	26	33	21.2%	78.8%	100.0%
8. Tjetër	2	10	12	16.7%	83.3%	100.0%




Diagrama 18

Ndërkaq, sikurse e tregojnë të dhënat e diagramës 19, kur flitet për të anketuarit që kanë pohuar se kanë lidhje të pakufizuar në Internet me anë të telefonit të tyre celular, vihet re se të anketuarit me vendbanim në Tiranë kanë një peshë më të madhe se të anketuarit në qytete të tjera, qofshin këta qendra qarqesh, apo zona urbane në periferi të tyre.

Përfundimisht këtu bën Korçë. Në Korçë janë 52,3 për qind e të anketuarve që pohojnë se kanë lidhje të pakufizuar Interneti në telefonin e tyre celular. Kjo e dhënë në Tiranë paraqitet më e ulët se në Korçë, por më e lartë se në vendbanimet e tjera: 44,8 për qind.

Ajo që mendojmë se ka vend për t'u theksuar ka të bëjë me faktin se lidhur me këtë tregues, parametrat nuk janë më të larta në Vlorë sesa në Orikum, më të larta në Shkodër sesa në Koplik, më të larta në Elbasan sesa në Peqin. Madje në këto raste ndodh e kundërta. Edhe e dhëna që përfaqëson këtë tregues në Tiranë nuk është dukshëm më e lartë se e njëjta e dhënë kur i referohemi Kamzës.

A do të thotë kjo se popullsitë në zonat urbane më periferike, më afër hapësirave rurale, ose edhe me banim te këto të fundit kanë prirje të kenë lidhje Interneti në telefonat e tyre celularë në të njëjtën shkallë, ose hera – herës edhe në një shkallë më të lartë se popullsitë me banim në qendrat e mëdha urbane?

Nëse do të ishte një përgjigje pohuese, për nga rëndësia e vet, do të kërkonte edhe të dhëna të tjera për t'u verifikuar. Por, nuk është e pamundur të jetë e vërtetë. Këtu mund të mendohet se ndikojnë disa faktorë.

E para, nevoja e popullsive që jetojnë në zona periferike urbane ose më pranë zonave rurale për të komunikuar nëpërmjet celularit të lidhur në Internet është sociologjikisht e njëjtë, në mos më

e madhe sesa nevoja e popullsisë urbane. Mjafton të përmendim nevojën për t'u lidhur në çdo çast, me mesazhe, thirrje telefonike, ose shkëmbyer video me të afërmit dhe familjarët, miqtë e ndodhur në emigrim.

E dyta, sidomos brezat e rinj në këto zona, njësoj si moshatarët e tyre me banim në zonat urbane kanë kënaqësinë dhe interesimin e veçantë për të komunikuar në rrjete sociale apo për të marrë informacione nga hapësirat sociale dixhitale.

E treta, nga pikëpamja financiare që sigurisht ndikon mbi parametrin e marrë në shqyrtim, mund të thuhet se emigrimi brendshëm nga fshati në qytet, nga malësitë drejt qyteteve, nga zonat periferike urbane në ato të qendrave kryesore urbane të vendit, ndoshta ka bërë edhe një zhvendosje të varfërisë nga zonat rurale drejt zonave urbane. Mesatarisht në qendrat e mëdha urbane ka pjesë popullsie që kanë vështirësi më të mëdha financiare se të tilla me banim në zona periferike urbane për të financuar teknologji më intensive komunikimi dhe pasur ato në përdorim.




Diagrama 19

T'i hedhim një sy diagramës 20!

Çfarë lloji telefoni përdorni personalisht? (sipas gjinisë)

	1. Smartphone me lidhje të pakufizuar në Internet	2. Telefon i thjeshtë që nuk lidhet dot në Internet	3. Smartphone me lidhje Interneti me kontratë me afatë të kufizuara kohore	4. Smartphone me lidhje Interneti sipas ofertave javore, dyjavore, mujore	5. Nuk përdor fare telefon aktualisht	6. Smartphone me të cilin lidhem vetëm me Wi-Fi në banesë	7. Smartphone me të lidhem vetëm herë pas here me Wi-Fi jashtë banesë, në kafene, etj.	8. Tjetër	Total
1. Femër	176	6	83	93	1	61	18	5	443
2. Mashkull	172	12	63	93	5	45	16	7	413
	në nr.								
1. Femër	39.7%	1.4%	18.7%	21.0%	0.2%	13.8%	4.1%	1.1%	100.0%
2. Mashkull	41.6%	2.9%	15.3%	22.5%	1.2%	10.9%	3.9%	1.7%	100.0%
	në %								




Diagrama 20

Të dhënat e diagramës 20 ri-dëshmojnë se pak a shumë si të anketuarat femra ashtu edhe të anketuarit meshkuj kanë akses pothuajse të njëjtë te teknologjia e aparatit celular me lidhje Interneti. Megjithatë, të anketuarit meshkuj pohojnë pak në masë më të gjerë se femrat se zotërojnë këtë teknologji në përdorim.

Ky dallim i lehtë paraqitet kështu: Midis të anketuarve meshkuj janë 41,6 për qind e tyre që pohojnë se kanë lidhje të pakufizuar Interneti në telefonin e tyre celular; kurse po këtë përgjigje e japin 39,7 për qind e të anketuarave femra. Këto të fundit kanë një përfaqësim më të madh se meshkujt kur bëhet fjalë për treguesin “lidhje e Internetit në celular sipas afateve kohore të kufizuara.” Midis atë anketuarave gra ky tregues pohohet nga 39,7 për qind e tyre, kurse mes të anketuarve burra është 37,8 për qind.

Të dhënat e anketës tregojnë dy prire, të cilat kur analizohen së bashku të ndihmojnë për të parë më qartë rrezikshmërinë e sjelljeve cyberbullizuese në komunikimin dixhital.

Nga njëra anë, sikurse është e kuptueshme, lidhja e telefonit celular me Internetin, krijon riskun që çdo komunikues të jetë nën presionin e sjelljeve cyberbullizuese, ose edhe të përfshihet vetë në një komunikim të ndërsjellë cyberbullizues. Nga ana tjetër, të dhënat e anketës dëshmojnë se aksesin në teknologjinë më intensive të komunikimit e kanë moshat e reja më tepër sesa segmentet e popullsisë me moshë më të rritura, të pjekura, ose me moshë disi të avancuar. Kjo do të thotë se fëmijët dhe adoleshentët duket se nga pikëpamja teknologjike kanë më tepër akses në kanalet e komunikimit ku qarkullojnë përmbajtje cyberbullizuese se sa të rriturit. Në këtë kuptim mund të thuhet se ka një shpërpjesëtim të mprehtë midis formimit etik dhe pjekurisë qytetare e njerëzore të konsumatorëve më të shpeshtë dhe mundësive teknologjike për t’i bërë ata të ekspozuar ndaj përmbajtjeve cyberbullizuese.

Për sa më sipër “flasim” edhe të dhënat e diagramës 21.

Më të rinjtë në moshë nga të anketuarit, të cilët supozohet se ende nuk e kanë të gjithë pjekurinë dhe përvojën e jetës, janë ata që kanë aksesin më të madh në teknologjinë e komunikimit intensiv që paraqet telefonia e lidhur me sinjalin e Internetit.

Veçanërisht kur bëhet fjalë për segmentin moshor nga 13 deri 16 vjeç shtrohet gjithmonë pyetja: A e ka kjo moshë përgatitjen psikologjike dhe etike për të përballuar një fluks të tillë përmbajtjesh me komunikim të ndërsjellë që mundëson Interneti?

Përtej kësaj pyetjeje që në këtë formë është disi e përgjithshme, nisur nga të dhënat e anketës shtrohet një pyetje edhe më konkrete: A është e mbështetur kjo shtresë e popullsisë sa duhet nga familja dhe shkolla për ta përballuar riskun e cyberbullizimit?

Kjo pyetje e dytë nuk ka të bëjë më aspak me teknologjinë, nuk fajëson teknologjinë, por shtron pikëpyetje lidhur me mënyrën si funksionojnë institucionet shoqërore.

Mbi këtë bazë, të dhënat dëshmojnë atë që theksuam më lart. Midis të anketuarve të moshës nga 13 deri 16 vjeç kemi 42,3 për qind të tyre që pohojnë se kanë lidhje të pakufizuar në kohë dhe debit në telefonin celular që zotërojnë. Kurse kur bëhet fjalë për të anketuarit e moshës nga 25 deri 46 vjeç, janë 25,8 për qind e tyre që japin të njëjtën përgjigje.

Çfarë lloji telefoni përdorni personalisht? (sipas grupmoshës)

	1. Smartphone me lidhje të pakufizuar në Internet	2. Telefon i thjeshtë që nuk lidhet dot në Internet	3. Smartphone me lidhje Interneti me kontratë me afatë të kufizuara kohore	4. Smartphone me lidhje Interneti sipas ofertave javore, dyjavore, mujore	5. Nuk përdor fare telefon aktualisht	6. Smartphone me të cilin lidhem vetëm me Wi-Fi në banesë	7. Smartphone me të lidhem vetëm herë pas here me Wi-Fi jashtë banese, në kafene, etj.	8. Tjetër	Total
	në nr.								
1. Nga 13 deri 16 vjeç	63	2	13	24	5	22	13	7	149
2. Nga 17 deri 19 vjeç	131	3	32	47	1	47	11	1	273
3. Nga 20 deri 23 vjeç	54	1	28	27	0	13	2	1	126
4. Nga 24 deri 45 vjeç	65	0	31	35	0	7	2	2	142
5. Nga 46 deri 60 vjeç	25	5	29	27	0	6	4	1	97
6. Nga 61 vjeç e lart	15	7	14	24	0	10	2	0	72
	në %								
1. Nga 13 deri 16 vjeç	42.3%	1.3%	8.7%	16.1%	3.4%	14.8%	8.7%	4.7%	100.0%
2. Nga 17 deri 19 vjeç	48.0%	1.1%	11.7%	17.2%	0.4%	17.2%	4.0%	0.4%	100.0%
3. Nga 20 deri 23 vjeç	42.9%	0.8%	22.2%	21.4%	0.0%	10.3%	1.6%	0.8%	100.0%
4. Nga 24 deri 45 vjeç	45.8%	0.0%	21.8%	24.6%	0.0%	4.9%	1.4%	1.4%	100.0%
5. Nga 46 deri 60 vjeç	25.8%	5.2%	29.9%	27.8%	0.0%	6.2%	4.1%	1.0%	100.0%
6. Nga 61 vjeç e lart	20.8%	9.7%	19.4%	33.3%	0.0%	13.9%	2.8%	0.0%	100.0%




Diagrama 21

Të dhënat e diagramës së mësipërme verifikohen edhe te tabela 8, e cila tregon se sa akses kanë të anketuarit në teknologjinë e telefonisë celulare sipas statusit socio-profesional të të anketuarit. Të dhënat e detajuara dëshmojnë edhe njëherë se të anketuarit me statusin student dhe nxënës kanë aksesin më të lartë në telefoninë celulare me lidhje Interneti, pas shtresës së të anketuarit që deklarojnë se statusi i tyre socio-profesional është ai i intelektualit që ushtron profesione si mjek, avokat, noter, mësues, gazetar, etj.

Çfarë lloji telefoni përdorni personalisht? (sipas statusit socio-profesional)

	1. Smartpho ne me lidhje të pakufizuar në Internet	2. Telefon i thjeshtë që nuk lidhet dot në Internet	3. Smartpho ne me lidhje Interneti me kontratë me afatë të kufizuara kohore	4. Smartpho ne me lidhje Interneti sipas ofertave javore, muajore	5. Nuk përdor fare telefon aktualisht	6. Smartpho ne me të cilin lidhem vetëm me Wi-Fi në banesë	7. Smartpho ne me të lidhem vetëm herë pas herë me Wi-Fi jashtë banesë, në kafene, etj.	8. Tjetër	Total
	në nr.								
1. Nxënës	141	5	25	43	6	51	16	7	294
2. Student	119	1	51	57	0	32	8	1	269
3. Nëpunës administrate në institucione publike ose private	19	1	17	16	0	3	0	1	57
4. Profesion intelektual si artist, mjek, gazetar, avokat, etj.	12	0	2	4	0	3	1	0	22
5. Punonjës shërbimesh	22	2	10	16	0	3	2	2	57
6. Punonjës në prodhimin urban, industrial, artizanal	3	0	2	3	0	0	0	0	8
7. Punonjës në bujqësi dhe blegtori	1	1	5	1	0	3	0	0	11
8. Pensionist	10	6	10	18	0	7	2	0	53
9. I papunë që kërkon punë	3	2	5	6	0	1	2	0	19
10. Shtëpiak, shtëpiake	7	0	10	9	0	1	0	0	27
11. Kam dy ose më tepër nga këto statuse	5	0	1	2	0	1	1	0	10
12. Tjetër	11	0	8	9	0	1	2	1	32
	në %								
1. Nxënës	48.0%	1.7%	8.5%	14.6%	2.0%	17.3%	5.4%	2.4%	100.0%
2. Student	44.2%	0.4%	19.0%	21.2%	0.0%	11.9%	3.0%	0.4%	100.0%
3. Nëpunës administrate në institucione publike ose private	33.3%	1.8%	29.8%	28.1%	0.0%	5.3%	0.0%	1.8%	100.0%
4. Profesion intelektual si artist, mjek, gazetar, avokat, etj.	54.5%	0.0%	9.1%	18.2%	0.0%	13.6%	4.5%	0.0%	100.0%
5. Punonjës shërbimesh	38.6%	3.5%	17.5%	28.1%	0.0%	5.3%	3.5%	3.5%	100.0%
6. Punonjës në prodhimin urban, industrial, artizanal	37.5%	0.0%	25.0%	37.5%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%
7. Punonjës në bujqësi dhe blegtori	9.1%	9.1%	45.5%	9.1%	0.0%	27.3%	0.0%	0.0%	100.0%
8. Pensionist	18.9%	11.3%	18.9%	34.0%	0.0%	13.2%	3.8%	0.0%	100.0%
9. I papunë që kërkon punë	15.8%	10.5%	26.3%	31.6%	0.0%	5.3%	10.5%	0.0%	100.0%
10. Shtëpiak, shtëpiake	25.9%	0.0%	37.0%	33.3%	0.0%	3.7%	0.0%	0.0%	100.0%
11. Kam dy ose më tepër nga këto statuse	50.0%	0.0%	10.0%	20.0%	0.0%	10.0%	10.0%	0.0%	100.0%
12. Tjetër	34.4%	0.0%	25.0%	28.1%	0.0%	3.1%	6.3%	3.1%	100.0%

Tabela 8

Ndërsa të dhënat e diagramës 22, ri-dëshmojnë se për sa i takon treguesit “akses në teknologji me intensitet të lartë komunikimi kibernetik”, sado me një dallim të lehtë mes zonave urbane dhe atyre rurale, të anketuarit në secilën nga zonat e përmendura kanë pothuajse akses të barabartë. Ky parametër ka të bëjë kryesisht me treguesin: “përdorim të telefonisë celulare me lidhje Interneti”. Nga të anketuarit me vendlindje në qytetet që janë qendra qarqesh, rezulton se 41,5 për qind e tyre pohojnë se kanë akses në teknologjinë celulare me lidhje Interneti të pakufizuar në kohë dhe në debit. Për këtë tregues shprehen njëlloj 39,8 për qind e atyre që deklarojnë se e kanë vendlindjen në qendrat urbane jo qendra qarku, dhe 39,3 për qind e atyre që deklarojnë se e kanë vendlindjen në zonë rurale.

Çfarë lloji telefoni përdorni personalisht? (sipas vendbanimit)

	1. Smartpho ne me lidhje të pakufizuar në Internet	2. Telefon i thjeshtë që nuk lidhet dot në Internet	3. Smartpho ne me lidhje Interneti me kontratë me afatë të kufizuara kohore	4. Smartpho ne me lidhje Interneti sipas ofertave javore, dyjavore, muajore	5. Nuk përdor fare telefon aktualisht	6. Smartpho ne me të cilin lidhem vetëm me Wi-Fi në banesë	7. Smartpho ne me të lidhem vetëm herë pas here me Wi-Fi jashtë banesë, në kafene, etj.	8. Tjetër	Total
	në nr.								
1. Qytet qendër qarku	238	13	104	134	5	55	19	5	573
2. Qytet jo qendër qarku	66	2	25	38	0	22	9	4	166
3. Zonë rurale	42	3	17	11	1	25	5	3	107
4. Tjetër	5	0	1	2	0	1	1	0	10
	në %								
1. Qytet qendër qarku	41.5%	2.3%	18.2%	23.4%	0.9%	9.6%	3.3%	0.9%	100.0%
2. Qytet jo qendër qarku	39.8%	1.2%	15.1%	22.9%	0.0%	13.3%	5.4%	2.4%	100.0%
3. Zonë rurale	39.3%	2.8%	15.9%	10.3%	0.9%	23.4%	4.7%	2.8%	100.0%
4. Tjetër	50.0%	0.0%	10.0%	20.0%	0.0%	10.0%	10.0%	0.0%	100.0%




Diagrama 22

Diagramat e mëposhtme, 23 dhe 24 konfirmojnë edhe njëherë se të anketuarit kanë prirjen ta përdorin teknologjinë celulare me intensitetin më të lartë komunikues të saj. Teknologjia e telefonisë celulare ka transformuar vetë funksionin fillestar të telefonit. Janë më shumë të anketuarit që konsiderojnë se telefonin e tyre celular e përdorin për të komunikuar në whatsapp, viber, messenger, etj., se sa e përdorin për thirrje telefonike duke konsumuar impulse të sinjalit telefonik.

Pyetja që iu drejtua të anketuarve kërkonte që intensitetin e shkallës së përdorimit të një teknologjie ata ta vlerësonin me përgjigje që quhen “të degraduara”, pra që strukturohen brenda një shkalle vlerësimi nga 1 deri në 7, ku 1 është shkalla më e ulët dhe 7 shkalla më e lartë e vlerësimit.

Në diagramën 23, me vlerësimin 6 +7, janë shprehur 46,1 për qind e të anketuarve që theksojnë se më shumë e përdorin aparatit e tyre celular për thirrje telefonike.

Ndërsa diagrama 24 tregon se po me këtë nivel vlerësimi (6+7) kanë 51,6 për qind e të anketuarve që pohojnë se e përdorin telefonit e tyre celular për të pasur akses në platformat e VoIP (*Voice Over Internet Protocol*), pra për të komunikuar jo duke përdorur sinjalin e telefonisë, por atë të Internetit.

P.12 Kur përdorni telefonin vetëm për thirrje telefonike, cilën mënyrë përdorni më shumë? Me 1 shënohet vlera më e ulët e përdorimit dhe me 7 vlera më e lartë.

P12.1 Thirrjet telefonike me celular me sinjalin e telefonit

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	78	9.3%
2	71	8.5%
3	76	9.0%
4	108	12.9%
5	120	14.3%
6	88	10.5%
7	299	35.6%
Total	840	100.0%




Diagrama 23

P12.7 Komunikim me mesazhe në aplikime si whatsapp, viber, etj.

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	118	13.8%
2	53	6.2%
3	60	7.0%
4	83	9.7%
5	99	11.6%
6	95	11.2%
7	344	40.4%
Total	852	100.0%




Diagrama 24

Të dhënat e paraqitura në diagramën 25 dëshmojnë se të anketuarit që e përdorin më tepër telefonin celular për të pasur akses në teknologjitë VoIP kanë një ekspozim relativisht mjaft më të lartë se të tjerët ndaj përmbajtjeve me natyrë cyberbullizuese. Kështu nga të anketuarit që e përdorin në shkallën më të lartë teknologjinë celulare të lidhur në Internet për të pasur akses në platformat VoIP (Shkalla e vlerësimit 6+7) janë 67,4 për qind e tyre që e konsiderojnë veten e tyre të kenë qenë në presionin e sjelljeve dhe praktikave cyberbullizuese.

Shihet qartë se kjo e dhënë është rreth tre herë më e lartë se e dhëna që paraqet nivelin e përgjithshëm të ekspozimit ndaj cyberbullizimit nga tërësia e të anketuarve.

Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas shkallës së bisedave telefonike në whatsapp)

	1	2	3	4	5	6	7	Total	1
Po	5	4	10	15	23	18	79	154	3.2%
Jo	44	31	50	64	106	114	300	709	6.2%




Diagrama 25

Anketimi ka dëshmuar se nuk është në vetvete teknologjia celulare e lidhur me Internetin që krijon riskun e ekspozimit ndaj cyberbullizimit. Këtë risk e krijon mënyra e përdorimit të saj. Në tërësinë e këtyre mënyrave të përdorimit është edhe ajo e vozitjes në rrjetet sociale dhe komunikimit në platformat sociale.

Diagrama 26 paraqet të dhëna që tregojnë se sa më tepër rritet shkalla e vozitjes nëpërmjet telefonisë celulare në rrjetet sociale, aq më tepër janë ata që pohojnë se janë gjendur nën presionin e cyberbullizimit, pra kanë pasur të bëjnë me përmbajtje ofenduese, stigmatizuese, shkeljeje të privatësisë, etj. Nga të anketuarit që vozisin më tepër në rrjetet sociale (shkalla 6+7 e vlerësimit) janë 58,2 për qind e tyre që pohojnë se mbi ta kanë vepruar përmbajtje cyberbullizuese. Ndërkaq ata të anketuar që pohojnë një shkallë të ulët vozitje në rrjetet sociale (shkalla 1+2), janë 14,8 për qind e tyre që japin të njëjtën përgjigje.

Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas shkallës së komunikimit në rrjetet sociale)

	1	2	3	4	5	6	7	Total	1	2	3	4	5	6	7	Total
	në nr.								në %							
Po	15	9	15	14	11	20	69	153	9.8%	5.9%	9.8%	9.2%	7.2%	13.1%	45.1%	100.0%
Jo	115	45	56	69	86	113	218	702	16.4%	6.4%	8.0%	9.8%	12.3%	16.1%	31.1%	100.0%




Diagrama 26

Anketimi dëshmon edhe njëherë që rrjete të ndryshme sociale nuk kanë të njëjtën tërheqje nga përdoruesit e tyre.

Sikurse edhe nga anketime të tjera rezulton se nuk është më Facebook, i cili ngjall më tepër interes për audiencat. Diagramat 27, 28, 29 përmbajnë të dhëna që tregojnë se sa është shkalla e interesimit për t'i përdorur rrjetet sociale nga ana e të anketuarve. Duke marrë në konsideratë kryesisht shkallën më të lartë të interesimit (6+7), del se në vend të parë paraqitet Instagram me 48,2 për qind të të anketuarve; pastaj TikTok me 41,6 për qind të të anketuarve, dhe më pas Facebook, mjaft larg tyre, me vetëm 8,4 për qind e të anketuarve që e vlerësojnë atë me përparësi.

P13. Gjin nga rrjetet sociale përdorni më tepër? Me 1 shënohet vlera më e ulët e përdorimit dhe me 7 vlera më e lartë.

P13.1 TikTok

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	305	35.7%
2	41	4.8%
3	38	4.4%
4	45	5.3%
5	70	8.2%
6	102	11.9%
7	254	29.7%
Total	855	100.0%




Diagrama 27

P13.3 Facebook

1 vlera më e ulët, 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	530	62.1%
2	83	9.7%
3	83	9.7%
4	49	5.7%
5	36	4.2%
6	17	2.0%
7	55	6.4%
Total	853	100.0%



Diagrama 28

Instagram

1 vlera më e ulët, 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	176	20.5%
2	35	4.1%
3	49	5.7%
4	61	7.1%
5	118	13.8%
6	132	15.4%
7	286	33.4%
Total	857	100.0%




Diagrama 29

Shtrohet pyetja:

A përbën risku i ekspozimit përpara cyberbullizimit një arsye që të anketuarit të mos frekuentojnë një rrjet social?

Përgjigja që del nga pohimet e të anketuarve është : Jo!

Diagrama 30 tregon që pavarësisht se TikTok shënjohej nga të anketuarit si një nga rrjetet ku qarkullojnë më tepër se kudo tjetër përmbajtje cyberbullizuese, ai mbetet nga më të parapëlqyerit. Janë 67,5 për qind e të anketuarve që shënjojnë TikTok-un si rrjetin social më cyberbullizues, ndërsa Facebook-un vetëm 1,96 prej tyre e quajnë të tillë.

Sigurisht, nga sa më sipër nuk nxirret dot përfundimi se një rrjet social bëhet aq më tepër tërheqës për t'u përdorur sa më tepër cyberbullizon. Por, duket e sigurt që të pohohet se fakti i përmbajtjeve cyberbullizuese në vetvete nuk përbën një shkak që audiencat, sidomos ato në moshë të re, të largohen nga një platformë e caktuar dixhitale, sidomos kur bëhet fjalë për rrjete sociale.




Diagrama 30

Të anketuarit, sikurse tregojnë të dhënat e diagramës 31, ndihen të lënduar njësoj pavarësisht se në cilën platforme të teknologjisë dixhitale fyen, kërcënohen apo shpifet për ta në masën 43,3 për qind të tyre.

Por, ka midis tyre në numër të konsiderueshëm që pohojnë se lëndohen më tepër në një të njërit ose të tjetrën prej tyre.

30,2 për qind e të anketuarve pohojnë se do të lëndoheshin më tepër nëse do të cyberbullizoheshin nëse kjo do të ndodhte në rrjetet sociale. Shumë më pak prej tyre, 7,3 për qind e të anketuarve, pohojnë se do të lëndoheshin më fort nëse kjo do të ndodhte në forumet e mediave online. 1,5 për qind e të anketuarve pohojnë të njëjtën ndjeshmëri poqë se do t'u ndodhte cyberbullizimi nëpërmjet SMS në telefonin celular. 2,25 për qind e të anketuarve mendojnë njësoj nëse do të ishin të cyberbullizuar në mesazhe të marra sipas teknologjive VoIP.

Prirja është e qartë: Sa më përmasë sociale të ketë platforma teknologjike ku ndodh cyberbullizimi, aq më tepër lëndime sjell ai. Në këtë rast ngacmimi i individit bëhen në sytë e një komuniteti të gjerë dhe rrezikon të përhapet në mënyrë të pakontrolluar gjithandej.




Diagrama 31

Sa më e ulët mosha e të anketuarve aq më e theksuar është prirja për t'u lënduar gjithandej, në të gjitha platformat teknologjike të ndryshme, pa dallim, nga praktikat cyberbullizuese.

Të rinjtë e ndjejnë më tepër cyberbullizimin sesa grup-moshat e tjera të shoqërisë.

Diagrama 32 përmban të dhëna të hollësishme për sa më sipër. Vëmë në dukje vetëm se për të anketuarit e grup-moshës nga 13 deri në 16 vjeç, janë 41,6 për qind e tyre që pohojnë se lëndimet për ta do të ishin njësoj në çdo platforme të teknologjisë së komunikimit. Vjen pastaj një rend zbritës: Të anketuarit e moshës nga 17 deri në 19 vjeç mendojnë kështu në masën 40,0 për qind e tyre; të moshës nga 20 deri 23 vjeç në masën e 31,2 për qind të tyre; të moshës nga 24 deri 45 vjeç në masën 22,4 për qind të tyre; për ata që janë nga 45 – 60 vjeç në masën e 9,1 për qind të tyre.

. Në cilat platforma ciberbullizimi (fyerje, shpifje, kërcënime, etj.) do të sillte më shumë lëndime? (sipas grupmoshës)

	Në rrjetet sociale të hapura për publikun ose për grupe miqsh	Në forume mediash online	Në faqe web të ndryshme psh njësi tregtare online, etj.	Në messenger	Në sms në telefon	Në mesazhe ose imazhe në viber, whatsapp, etj. (VoIP)	Në mesazhe email	Njëlloj gjithandej	Në aplikacione të ndryshme telefonike	Tjetër	Nuk e di	Total
1. Nga 13 deri 16 vjeç	62	12	3	0	0	1	1	41	7	4	18	149
2. Nga 17 deri 19 vjeç	110	11	4	1	3	9	3	103	9	2	20	275
3. Nga 20 deri 23 vjeç	39	10	1	0	0	5	0	48	8	3	11	125
4. Nga 24 deri 45 vjeç	32	21	1	0	3	3	0	73	3	0	7	143
5. Nga 46 deri 60 vjeç	9	6	2	0	6	1	0	62	5	2	4	97
6. Nga 61 vjeç e lart	7	3	0	1	1	0	0	49	4	0	7	72
	në %											
1. Nga 13 deri 16 vjeç	41.6%	8.1%	2.0%	0.0%	0.0%	0.7%	0.7%	27.5%	4.7%	2.7%	12.1%	100.0%
2. Nga 17 deri 19 vjeç	40.0%	4.0%	1.5%	0.4%	1.1%	3.3%	1.1%	37.5%	3.3%	0.7%	7.3%	100.0%
3. Nga 20 deri 23 vjeç	31.2%	8.0%	0.8%	0.0%	0.0%	4.0%	0.0%	38.4%	6.4%	2.4%	8.8%	100.0%
4. Nga 24 deri 45 vjeç	22.4%	14.7%	0.7%	0.0%	2.1%	2.1%	0.0%	51.0%	2.1%	0.0%	4.9%	100.0%
5. Nga 46 deri 60 vjeç	9.3%	6.2%	2.1%	0.0%	6.2%	1.0%	0.0%	63.9%	5.2%	2.1%	4.1%	100.0%
6. Nga 61 vjeç e lart	9.7%	4.2%	0.0%	1.4%	1.4%	0.0%	0.0%	68.1%	5.6%	0.0%	9.7%	100.0%




Diagrama 32

5. Ndikimi i marrëdhënieve shoqërore në përballjen e individit me praktikat cyberbullizuese?

Deri tani pamë nëpërmjet të dhënash sasiore sesi teknologjia dixhitale nëpërmjet karakteristikave të veta krijon mundësi për autorët e sjelljeve cyberbullizuese për të ngacmuar kibernetikisht të tjerët. Veç argumenteve të përmendur mund të shtohet se nëpërmjet kësaj teknologjie është arritur që përmbajtja e komunikimeve të marrë edhe një natyrë horizontale. Sikurse dihet kjo do të thotë se çdo përdorues i këtyre teknologjive mund të shpërndajë për të gjithë popullsinë e planetit që komunikon në web përmbajtje nga më të ndryshme, të shkëmbejë me individë dhe komunitete pa qenë i detyrë që komunikimet e tij të institucionalizohen, pra të autorizohen nga ndonjë institucion. Krahas anëve pozitive, ky demokratizim i komunikimit masiv dhe i individualizuar u ka dhënë njëkohësisht konsumatorëve të ndryshëm hapësira të shprehjen jo rrallë edhe me përmbajtje jo-etike, pra të përdoret ky komunikim për abuzime të ndryshme, si edhe të transmetohen me anë të tij ofendime, kërcënime, stigmatë, apo të kryhen përndjekje online, si edhe shkaktohen ndërhyrje abuzive në të dhënat e jetës private të individit. Nga ana tjetër, si komunikim i kryer shpesh në kohë reale, teknologjia dixhitale krijon mundësi që bashkë me shkëmbimin e përmbajtjeve të informacionit të përcjellë edhe gjendje emocionale të komunikuesve, jo rrallë të ndezura, të ushqyera me pasione inati, egoizmi, smire, hakmarrjeje, etj. Në këtë mënyrë mund të krijohet më lehtë një mjedis për sjellje psikologjikisht negative.

Ndërkohë theksuam që ndonëse teknologjia krijon hapësira që lejojnë sjellje cyberbullizuese, përsëri nuk ka argumente dhe prova të mjaftueshme, sikurse e treguan edhe të dhënat e anketimit të kryer, për të arritur në përfundimin që teknologjia dixhitale përbën shkakun për sjellje cyberbullizuese. Varet nga kush përdoret ajo, si përdoret, dhe çfarë mesazhesh qarkullohen nëpërmjet saj.

Ndërkohë natyrshëm mund të shtrohet një problem tjetër: Sa ndikojnë marrëdhëniet shoqërore mes njerëzve në përdorimin e teknologjisë dixhitale për qëllime cyberbullizuese?

Pyetësi i anketës ka qenë i orientuar për të sjellë informacione dhe opinione të audiencave të marra në konsideratë edhe për sa më sipër. Këto të dhëna japin rezultate interesante, një pjesë e të cilave, ato më thelbësoret, po i paraqesim më poshtë.

Të dhënat e anketës tregojnë se cyberbullizohen më pak ata që pohojnë se kanë status social relativisht të sigurt, apo që janë të rrethuar me miq e shokë, me farefis e kolegë, që i bëjnë të ndihen të fortë dhe të fuqishëm në shoqëri.

Sikurse dëshmojnë të dhënat e diagramës 33, nga 608 të anketuar që i janë përgjigjur pyetjes nëse ndihen ose jo të fuqishëm dhe të sigurt në shoqëri me pohimin se “ndihen të mbështetur dhe të fuqishëm”, janë 94 prej tyre, pra 84,6 për qind e tyre, që kanë pohuar se nuk janë ndjerë nën presionin e cyberbullizimit?

Kjo e dhënë tregon se ky segment të anketuarish është rreth 5 për qind më i vogël se mesatarja e përgjithshme në përqindje e të gjithë të anketuarve që pohojnë se janë ndjerë nën presionin e

cyberbullizimit. Nëse kjo diferencë nuk duket edhe aq tepër domethënëse, atëherë ka vend për të supozuar se të ndjerët i fortë, i mbështetur dhe i fuqishëm në shoqëri nuk e bën individin të evitojë ekspozimin ndaj cyberbullizimit. Në ndonjë drejtim madje e rrit presionin cyberbullizues. Më e rëndësishme në këtë rast do të ishte të dihej se si e përjetojnë ata që kanë ndjesinë e të qenit të mbështetur në shoqëri sjelljet cyberbullizuese ndaj tyre. Kjo mund të ishte një tematikë për t'u shqyrtuar më nga afër në të ardhmen.




Diagrama 33

Sikurse do të ishte e pritshme në një anketim që i referohet shoqërisë shqiptare, të anketuarit kanë shfaqur gjerësisht dëshirën për të pasur marrëdhënie shoqërore të forta dhe të zhvilluara në një masë të konsiderueshme me të tjerët. Të anketuarit në një masë të madhe janë shfaqur me karakteristikat e një tipi social që kërkon të integrohet mirë në shoqëri. Diagrama 34 dëshmon disa të dhëna të qarta sa më sipër. Për pohimin “Nuk më pëlqen të kem shumë marrëdhënie shoqërore”, ata që e vlerësojnë pak atë (shkalla 1+2 e vlerësimit) përbëjnë 64,5 për qind të të anketuarve, kurse ata që janë krejtësisht dhe fort në një mendje me të (shkalla 6 + 7 e vlerësimit) përbëjnë vetëm 8,4 për qind të të anketuarve.

14.7 Nuk më pëlqen të kem shumë marrëdhënie shoqërore

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	432	51.8%
2	106	12.7%
3	94	11.3%
4	89	10.7%
5	43	5.2%
6	29	3.5%
7	41	4.9%
Total	834	100.0%




Diagrama 34

Mirëpo individët që janë disi të izoluar në vetvete, që nuk marrin ndonjë shije të veçantë nga marrëdhëniet e zgjeruara shoqërore, duket se në lidhje me tematikën që shqyrtojmë kanë edhe ndonjë privilegj. Duket se janë më të mbrojtur nga sjelljet cyberbullizuese. Këtë e dëshmojnë të dhënat e diagramës 35. Ata që e pëlqejnë pak shprehjen “Nuk më pëlqen të kem shumë marrëdhënie shoqërore”, pra që priren të komunikojnë me të tjerët (shkalla 6+7 e vlerësimit) paraqiten më të ekspozuar ndaj cyberbullizimit se ata që e pëlqejnë shumë këtë shprehje, pra që komunikojnë më pak me të tjerët (shkalla 6 + 7 e vlerësimit). Të parët përbëjnë 66,4 për qind e

të gjithë përgjigje-dhënësve që kanë vlerësuar në një mënyrë ose një tjetër shprehjen “Nuk më pëlqen të kem marrëdhënie shoqërore. Kurse të dytët për bëjnë 7,7 për qind të tyre.

Nëse do të nxirrnim një përfundim paraprak nga të dhënat e anketës do të thoshim në mënyrë të përmbledhur se mbështetja në marrëdhënie shoqërore të zgjeruara, të ndjerët i integruar mirë në shoqëri, thënë ndryshe komunikimi në mënyrë të gjerë dhe intensive, jo medoemos të mbron nga cyberbullizimi. Kurse të qenit më i mbyllur në vetvete, pasja e një komunikim më të kufizuar, është e sigurt që përbën një mburojë ndaj sjelljeve cyberbullizuese, duke i evituar jo pak ato. Flegmatikët cyberbullizohen më pak se të tjerët.

P30. Ju ka ndodhur të keni qenë ju vetë nën presionin e cyberbullizimit? (sipas shkalles së mospëlqimit të të pasurit shumë marrëdhënie shoqërore)

	1	2	3	4	5	6	7	Total	1	2	3	4	5	6	7	Total
	në nr.								në %							
Po	77	20	13	17	8	8	3	146	52.7%	13.7%	8.9%	11.6%	5.5%	5.5%	2.1%	100.0%
Jo	354	86	81	72	35	21	36	685	51.7%	12.6%	11.8%	10.5%	5.1%	3.1%	5.3%	100.0%




Diagrama 35

Ky përfundim duhet kuptuar si duhet sepse mund të prodhojë keqkuptime. Mos do të thotë ai se për rrjedhojë sjellja e duhur e individit për t'u mbrojtur nga cyberbullizimi është vetë-izolimi, moskomunikimi, shkëputja nga platformat sociale të komunikimit dixhital?

Të dhënat e anketës ndër të tjera konfirmojmë në rrugë të shumta se të moshuarit, të cilët komunikojnë më pak, natyrshëm cyberbullizohen më rrallë se të tjerët. Por, evitimi i komunikimit ka nga ana tjetër pasoja të tjera negative. Mbi të gjitha njeriu i izoluar që nuk komunikon merr më pak informacion. Njeh më pak njerëz. Është më pak i përditësuar me të rejat e shoqërisë që i interesojnë. Është më pak i njohur nga të tjerët. Një sërë privimesh që ata që komunikojnë në mënyrë intensive nuk i pësojnë. Për këtë arsye e quajmë cyberbullizimin një e keqe disi të pranueshme përpara mundësive të pashtershme që jep komunikimi. Nga kjo pikëpamje është e qartë që model sjelljeje racionale për individin nuk do të ishte izolimi në vetvete sepse kjo do të sillte shumë pasoja negative të padëshirueshme. Por, komunikimi i shëndetshëm duke u përgatitur për ta përballuar cyberbullizimin si duhet. Pra, në thelb, problemi nuk është në vetvete evitimi i cyberbullizimit, qoftë edhe me çmimin e moskomunikimit, për këtë duhet bërë kujdes, natyrisht, por përballimi i tij me teknika dhe strategji të sakta dhe dobiprurëse.

Diagrama 36 paraqet të dhëna, të cilat tentojnë t'i japin përgjigje një pyetjeje të rëndësishme:

Për çfarë qëllimi të anketuarit gjykojnë se janë cyberbullizuar nga të tjerët?

Thënë ndryshe, me anë të kësaj pyetjeje është dashur të dihet se çfarë motivesh kryesore i shtyjnë autorët të adresojnë ose të qarkullojnë përmbajtje cyberbullizuese.

Është cyberbullizimi një “armë” për kauza të ndryshme shoqërore, publike? Se nga një pikëpamje mund të konsiderohet se ngacmimi kibernetik ka edhe potencialin e një teknike marrëdhëniesh publike agresive që sulmon një kundërshtar!!!

Anketimi jep këto të dhëna kryesore:

Të anketuar kanë pohuar se cyberbullizohen për çështje bindjesh apo kauzash politike në masën 14,2 për qind të tyre. Kjo e dhënë del si rezultat i mbledhjes së përgjigjeve “po” dhe “disi”. Nga kjo pikëpamje mund të thuhet se janë pakicë ata të anketuar që mendojnë se cyberbullizimit i tjetrit vjen si pasojë debatesh për ide, për kauza, për bindje politike. Në një farë mënyre kjo gjë ka disa anë të mira. Në radhë të parë dëshmon se komunikimi masiv nuk është bërë arenë e ndarjeve të mëdha social-politike. Gjithsesi, e dhëna e paraqitur më lart, nuk është fare e parëndësishme edhe në një kuptim tjetër. Afërsisht një ndër shtatë të anketuar pohon se ka pësuar cyberbullizim për shkaqe politike. Duket se është një e dhënë e besueshme edhe nëse shohin vetëm gjuhën e urrejtjes që shfryn sidomos në forumet e mediave online, në llogari të ndryshme në rrjetet sociale që kanë orientim ideologjik ose politik, etj.

Në një shkallë të konsiderueshme, duket se cyberbullizimi është më tepër produkt i motiveve personale. Të anketuarit që janë përgjigjur pyetjes : “Mos bëhet për rivalitet, smire, qëllimesh karrieriste, etj?”, në masën 43 për qind të tyre i kanë thënë “Po!” asaj.

Kurse 22 për qind e atyre që i kanë dhënë përgjigje pyetjes : “Mos bëhet për hakmarrje personale?”, janë shprehur pozitivisht për të. Edhe kjo e dhënë është interesante për t’u analizuar në vazhdimësi. Një ndër pesë të anketuar veçon motivin “hakmarrje personale”. Kjo lloj përgjigjeje përbën një sinjal se cyberbullizimi është shpesh një mënyrë komunikimi me dy drejtime, përbën në raste të caktuara një komunikim të ndërsjellë, ku të cyberbullizuarit ka mundësi të kenë qenë më parë cyberbullizues. Ka konsumatorë që bashkë-cyberbullizohen ose bullizohen reciprokisht në jetën reale. Ndodh që cyberbullizimi shoqërohet me bullizim në komunikimin sy më sy, ose bullizimi në forma tradicionale shndërrohet më pas ose bashkëshoqërohet me forma cyberbullizimi.

Ndër të anketuarit që i janë përgjigjur pyetjes :” Mos ju kanë cyberbullizuar thjesht për qejf?” janë 38,3 për qind e tyre që e pohojnë këtë. Të cyberbullizosh të tjerët për të marrë kënaqësi, për të kaluar kohën e lirë, për t’i ngacmuar pa ndonjë arsye të qartë!!!Ndodh pse jo, si formë zbavitjeje! Dihet se një lloj sadizmi kibernetik mund të prodhojë kënaqësi te njerëz të ndryshëm sikurse shkakton sadizmi në përgjithësi!

P38. Kur ju ka ndodhur të bullizoheni, sipas jush arsyeja e vërtetë ka qenë?

	Po	Disi	Jo	Total	Po	Disi	Jo	Total
	(në nr.)				(në %)			
38.1 Për çështje ose bindje politike	57	63	724	844	6.8%	7.5%	85.8%	100.0%
38.2 Për hakmarrje	126	60	658	844	14.9%	7.1%	78.0%	100.0%
38.3 Për smirë, xheloz, rivalitet, konkurrencë	292	76	489	857	34.1%	8.9%	57.1%	100.0%
38.4 Për të më dëmtuar në sytë e opinionit	266	67	520	853	31.2%	7.9%	61.0%	100.0%
38.5 Për të më dobësuar psikologjikisht dhe nga ana shoqërore	233	74	542	849	27.4%	8.7%	63.8%	100.0%
38.6 Për qejf, dhe zbavitje nga një ose disa persona	251	74	522	847	29.6%	8.7%	61.6%	100.0%
38.7 Për të gjitha arsyet e mësipërme	73	102	650	825	8.8%	12.4%	78.8%	100.0%
38.8 Nuk e di	57	81	628	766	7.4%	10.6%	82.0%	100.0%




Diagrama 36

Ka vend të mendohet që në shoqërinë shqiptare, për shkak të faktit që përgjithësisht individët janë të përfshirë në mënyrë të ndjeshme në marrëdhënie shoqërore përgjatë jetës së tyre të përditshme, cyberbullizimi të shfaqë forma dhe mënyra specifike artikulimi.

Diagrama 37 dhe diagrama 38 japin të dhëna rreth faktit se me cilët grupe shoqërore parapëlqejnë të kenë shoqëri të anketuarit. Pa hyrë në hollësitë e të dhënave të anketimit, mund të thuhet, sikurse pritej, se të anketuarit privilegjojnë marrëdhëniet familjare përpara çdo marrëdhënieje tjetër që ata mund të krijojnë apo të ruajnë me rrethe të tjerë shoqërore ku bëjnë pjesë apo me të cilët kanë kontakte.

Parapëlqimi i marrëdhënieve me familjarë dhe fafëfis shprehet nga 87,1 për qind e të anketuarve; me miqtë e shokët e vegjëlisë : nga 54,9 për qind e të anketuarve; me kolegë pune a shokë shkolle : nga 45,6 për qind e të anketuarve, etj. Këto të dhëna janë nxjerrë duke mbledhur përgjigjet e dy shkallëve sipërore të vlerësimit (6+7) për pohimin “Parapëlqej lidhjet shoqërore me...”.

P.14. Cilat janë marrëdhëniet më të rëndësishme për ju? Me 1 shënohet vlera më e ulët e përdorimit dhe me 7 vlera më e lartë.

14.1 Me miqtë e dikurshëm të vegjël, shkollës, rinisë, etj.

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	48	5.6%
2	61	7.1%
3	74	8.6%
4	101	11.7%
5	105	12.2%
6	135	15.6%
7	339	39.3%
Total	863	100.0%



14.2 Me kolegët e punës, ose shokë e shoqe të klasës

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	80	9.4%
2	44	5.2%
3	72	8.5%
4	122	14.4%
5	144	17.0%
6	142	16.7%
7	245	28.9%
Total	849	100.0%




Diagrama 37

Me familjarët e afërt, prindër, bashkëshort, vëllezër, motra, por edhe me fare e fis më të largët

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	12	1.4%
2	10	1.2%
3	20	2.3%
4	30	3.5%
5	39	4.5%
6	72	8.4%
7	676	78.7%
Total	859	100.0%




Diagrama 38

Mund të mendohet me të drejtë që në një shoqëri ku individi shpreh përmasa të ndjeshme socializimi, kur marrëdhëniet shoqërore mes individëve në jetën reale realizohen si rregull në hapësira relativisht jo shumë të gjëra, si në fshatra, qytete të vegjël, apo lagje në zona urbane, ku individi është i ndërthurur në radhë të parë në struktura marrëdhëniesh mes njerëzish me lidhje gjaku me të, etj., si vështirë që cyberbullizuesi të shfaqet hapur apo të kryhet nga njerëz të panjohur.

Në përgjithësi, sikurse është përmendur më parë, anonimiteti i cyberbullizuesit përbën një faktor që e lehtëson sjelljen deviante të tij. Diagrama 39 me të dhënat që paraqet, e vërteton këtë konsideratë.

Të anketuarit shprehin opinionin se janë cyberbullizuar më tepër nga profile anonimë, profile fallco, të panjohur sesa nga njerëz të njohur.

24,9 për qind e të anketuarve shprehën se cyberbullizuesi i tyre ka qenë kryesisht anonim.

25,8 për qind shprehën se ai ka qenë profil fallco.

20,4 për qind janë shprehur se ai ka qenë dikush i panjohur për ta.

Kuptohet vetiu se përse persona të njohur të cyberbullizojnë më pak ata që njohin.

11,9 për qind pohojnë se ka qenë një mik i vjetër.

10,45 për qind pohojnë se ka qenë një koleg që i ka cyberbullizuar.

3,4 për qind – një komshi.

Në këtë mënyrë mund të thuhet se shkalla e cyberbullizimit të një personi duket se është aq më e ulët sa më e lartë është shkalla e marrëdhënieve të tij shoqërore të personalizuara në jetën e përditshme. Mirëpo ky pohim ka vend të merret me shumë rezerva meqë edhe cyberbullizuesit anonimë, ose ata me profile fallco, mund të jenë nga rrethi i të njohurve i një individi të cyberbullizuar. Për të mos dalë hapur, ai ka parapëlqyer të fshihet pas ndonjë profili fallco ose të paraqitet si anonim. Gjithsesi, nisur nga këto të dhëna konfirmohet që cyberbullizimi në një masë të konsiderueshme përbën një praktikë të mbështetur në hipokrizi dhe në parimin makiavelist: Hidh gurin dhe fshih dorën!




Diagrama 39

Është me interes të vëmë në dukje edhe të dhëna që dëshmon se përgjigje-dhënësit më shumë u ndruhen ngacmimeve në jetën e tyre reale sesa cyberbullizimit. Kjo ndoshta përbën një karakteristikë të kontekstit të shoqërisë shqiptare. Në literaturën e huaj shkencore ka raste kur është argumentuar me të drejtë se cyberbullizimi është si rregull me pasoja më të dëmshme dhe të dhimbshme se bullizimi tradicional. Për shembull në artikullin e sipërcituar shkruhet:

”Për më tepër, ngacmimi kibernetik mund të ketë pasoja më të gjera dhe më afatgjata për viktimën sesa ngacmimi tradicional, për shkak se përmbajtja e përdorur për ta ngacmuar viktimën mund të kapë një audiencë shumë më të gjerë përmes internetit dhe shpesh mbetet e aksesueshme në internet ose në rrjetet sociale shumë kohë pas incidentit fillestar (Li 2007;

Pettalia et al. 2013). Si rezultat, është thënë që viktimat e ngacmimit kibernetik kanë më shumë se dy herë më shumë gjasa të vuajnë nga çrregullime mendore krahasuar me viktimat e ngacmimit tradicional.”⁹

Mirëpo të dhënat e anketimit që po paraqiten këtë paraqesin një pamje disi më ndryshe.

Cilat mund të jenë arsyet që bëjnë që një i anketuar në Shqipëri të ketë më tepër ndrojtje dhe t’i ruhet më tepër bullizimit tradicional sesa cyberbullizimit?

Jemi gjithmonë në kuadrin e hamendjeve, të cilat kërkojnë studim të mëtejshëm. Ndoshta sepse ka forma cyberbullizimi që vijnë si kërcënime. Një kërcënim i bërë ballë për ballë paraqet rrezikshmëri më të lartë sesa kur është virtual. Mund të mendohet gjithashtu se nga ngacmimet verbale në komunikimin real jashtë linje mund të kalohet më shpejt dhe menjëherë ndoshta në dhunë fizike. Prandaj bullizimi tradicional bëhet më kërcënues. Ka vend të bëhet hamendja se bullizimi ballë për ballë vjen zakonisht nga një i njohur. Pra, është tregues se intensiteti i konfliktit ka vajtur në një pikë vluese. Por, mund të rreshtohen edhe arsye të tjera.

Gjithsesi diagrama 40 është e qartë. Pyetjes se : “Cili është forma e cyberbullizimit që i ndruheni më tepër?” ka marrë këtë përgjigje:

43,9 për qind e të cyberbullizuarve nuk dallojnë si më të rrezikshëm dhe të dëmshëm për ta nëse është cyberbullizimi apo bullizimi tradicional.

29,0 për qind e të anketuarve konsiderojnë të tillë bullizimin tradicional

14,1 për qind, pra dy herë më pak se pararendësit janë të anketuarit që konsiderojnë më të dëmshëm për ta cyberbullizimin sesa bullizimin ballë për ballë.




Diagrama 40

Parë në optikën e hamendjeve që u paraqitën më lart, vetëkuptohet që do të duhej që të anketuarit me vendbanim në zonat urbane periferike të qyteteve të mëdhenj, apo më afër zonave rurale, t’i ndruheshin më fort cyberbullizimit sesa të tjerë që banojnë në zona të rëndësishme urbane. Këtë pritshmëri e vërtetojnë të dhënat e anketës. Sa më tepër që i anketuari ndodhet i përfshirë në marrëdhënie shoqërore në brendësi të një zone të ngushtë urbane, sa më tepër është

⁹ Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka Onuchowska, Po aty.

përfshirë brenda një komuniteti shoqëror më të ngushtë, aq më tepër ai i ndruhet cyberbullizimit sesa bullizimit tradicional. Në komunikimin ballë për ballë, në këtë rast ai ka shumë mundësi të ndodhet përpara të njohurve dhe të afërmeve të vet, me më pak rrezik se mund të ngacmohet realisht, të ofendohet, ose të kërcënohet.

Diagrama 41 konfirmon se :

Janë 12,1 për qind e të anketuarve me banim në Tiranë që i ndruhen më tepër cyberbullizimit sesa bullizimit tradicional.

Kurse në Kamëz të anketuarit që jetojnë atje dhe kanë të njëjtën përgjigje janë 26,8 për qind e tyre.

Janë të tillë 9 për qind në Vlorë.

Por, janë 20 për qind në Orikum.

Janë 10 për qind në Elbasan.

Por, janë 16 për qind në Peqin, etj.

. Juve personalisht do t'ju lëndonte më tepër një formë bullizimi jashtë platformave online apo kur ato bëhen në platforma dixhitale online (web, rrjete sociale, sms etj.)? (sipas gjinisë)

	1. Offline	2. Online	3. Njësoj	4. Nuk e di	Total	1. Offline	2. Online	3. Njësoj	4. Nuk e di	Total
	në nr.					në %				
Femër	30	10	48	12	100	30.0%	10.0%	48.0%	12.0%	100.0%
Mashkull	47	23	50	9	129	36.4%	17.8%	38.8%	7.0%	100.0%




Diagrama 41

Të anketuarit e grup-moshave nga 13 deri 16 vjeç, dhe nga 17 – 19 vjeç i ndruhen më tepër se ata me moshë më të rritur bullizimit tradicional në krahasim me cyberbullizimin. Kurse studentët i ndruhen më tepër se nxënësit e shkollave të mesme cyberbullizimit se sa bullizimit. Në një farë kuptimi, sa më i ri në moshë aq më tepër e ndjen peshën e opinionit përreth që shprehet drejtpërdrejt, në kushte reale, sesa kur bashkë me moshën, rritet edhe nevoja për t'u kujdesur për një reputacion më të gjerë virtual.

Gjithsesi bie në sy në diagramën 42 fakti që të gjitha segmentet moshore konsiderojnë me luhatjet përkatëse që bullizimi për ta është njësoj i dëmshëm si online ashtu edhe offline.

.Juve personalisht do t'ju lëndonte më tepër një formë bullizimi jashtë platformave online apo kur ato bëhen në platforma dixhitale online (web, rrjete sociale, sms në telefon, etj.)? (sipas grupmoshës)

	1. Offline në nr.	2. Online në nr.	3. Njësoj në nr.	4. Nuk e di në nr.	Total në nr.	1. Offline në %	2. Online në %	3. Njësoj në %	4. Nuk e di në %	Total në %
1. Nga 13 deri 16 vjeç	40	24	58	28	150	26.7%	16.0%	38.7%	18.7%	100.0%
2. Nga 17 deri 19 vjeç	92	28	110	47	277	33.2%	10.1%	39.7%	17.0%	100.0%
3. Nga 20 deri 23 vjeç	23	18	61	24	126	18.3%	14.3%	48.4%	19.0%	100.0%
4. Nga 24 deri 45 vjeç	46	27	65	5	143	32.2%	18.9%	45.5%	3.5%	100.0%
5. Nga 46 deri 60 vjeç	27	17	47	6	97	27.8%	17.5%	48.5%	6.2%	100.0%
6. Nga 61 vjeç e lart	22	8	39	3	72	30.6%	11.1%	54.2%	4.2%	100.0%




Diagrama 42

Kur flitet për marrëdhëniet shoqërore një peshë të veçantë zënë në to marrëdhëniet brenda familjes, veçanërisht marrëdhëniet midis fëmijëve të cyberbullizuar dhe prindërve, apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së tyre si vëllezër, motra, etj.

Marrëdhëniet familjare kanë rëndësi të veçantë kur është fjala për të mbështetur një të ri ose të re, apo çdo pjesëtar tjetër të familjes në rastin kur ai ka pësuar cyberbullizim. Kuptohet që kur ky i fundit ka mbështetjen e rrethit të tij familjar, të prindërve, kur ai rrethohet nga mbështetja e miqve dhe e shokëve, kur ka mundësi që shqetësimin e tij ta ndajë me mësuesit, apo edhe të këshillohet me psikologë ose specialistë të komunikimit, përballimi i fyerjeve, denigrimeve, prekjës së jetës së tij private, i nënvleftësimit apo poshtërimit që i është bërë, etj., shfaqet më pak i dhimbshëm, shoqërohet me më pak pasoja.

A i ndajnë me të tjerët shqetësimet që u vijnë nga sjellje cyberbullizuese të rinjtë e anketuar?

Një hipotezë do të ishte që ata i ndajnë meqë modeli i sjelljes së shqiptarit mendohet u jep rëndësi marrëdhënieve shoqërore. Lidhjet shoqërore, sidomos ato familjare janë përgjithësisht të forta.

Mirëpo anketa na tregon se i cyberbullizuari më tepër parapëlqen që hallin e tij ta mbyllë brenda vetmisë së tij, ta kalojë vetëm, të vuajë në një gjendje izolimi psikologjik dhe social. Është kjo vetmi që i bën pasojat e cyberbullizimit edhe më të rënda në psikikën dhe mbi gjendjen e shëndetit fizik të të cyberbullizuarit. E bën atë më mosbesues ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes së tij. Veçanërisht diagramat 43, 44, 45 paraqesin të dhëna që e ilustrojnë plotësisht këtë konsideratë.

Shqetësuese është fakti që dëshmon diagrama 48:

Të anketuarit (sidomos ata në moshë të re) shprehen se shqetësimet e tyre në rast cyberbullizimi i ndajnë shumë pak në mënyrë të konsiderueshme me prindërit (shkalla 6+7 e vlerësimit). Konkretisht : mesatarisht vetëm 15,8 për qind e të gjithë të anketuarve. Kurse ata që shprehen se i ndajnë rrallë ose aspak shqetësimet e tyre në rast cyberbullizimi përbëjnë 72,1 për qind e të anketuarve.

Pak a shumë kjo do të thotë se afërsisht tre në katër të anketuar nuk parapëlqen të flasë me prindërit për sa më sipër. Le të imagjinojmë tani një vajzë ose një djalë, adoleshentë që kanë shqetësime psikologjike nga cyberbullizimi. Dikush i poshtëron, i ngacmon seksualisht, i fyen, u dërgon video me përmbajtje pornografike në telefonin celular që mbajnë gjithë ditën nëpër duar, dhe nuk guxojnë, kanë turp, ndiejnë frikë ta ndajnë gjendjen e tyre të shqetësuar me prindërit. Imagjinohet lehtë se çfarë vuajtjes krijon kjo situatë, çfarë drame për atë vajzë ose djalë, çfarë pasojash mund të prodhojë ky mos—komunikim!

Situata është paksa paradoksale, por e kuptueshme dhe aspak e përshtatshme. Ndodh që sa më tepër të anketuarit në mosha të reja shtojnë komunikimin e tyre virtual nëpërmjet teknologjisë dixhitale me botën jashtë familjes, aq më shumë e zbehin komunikimin e tyre real me pjesëtarët e familjes, sidomos me prindërit.

Ka vend të thellohet studimi se përse ndodh kështu.

Por, ajo që dihet me siguri është se sado individ ndjen se me anëtarët e familjes së tij ka marrëdhëniet shoqërore më intensive në krahasim me çdo grup tjetër shoqëror, për shqetësime delikate të kësaj natyre komunikimi ndër-familjar, ai midis prindërve dhe fëmijëve është përgjithësisht i zbehtë. Përse ndodh kështu? Frikë nga autoriteti prindëror? Fëmijët ndihen të fajësuar nga ajo që ata po pësojnë si ngacmim kibernetik? Ndruhen se prindërit mund t'i pengojnë ata të komunikojnë duke ua hequr krejtësisht telefonin nga përdorimi? Turp për t'u shprehur? Të gjitha mund të jenë nga pak, por ajo që dihet me siguri është se për shkak një farë autoritarizmi prindëror komunikimi midis prindërve dhe fëmijëve për të tilla çështje delikate është i zbehtë. Mund të ndodhë edhe të jetë krijuar një ndarje mes brezave, kur brezi i prindërve të ketë pak aftësi dhe mundësi për ta kuptuar mënyrën e jetesës të brezit të fëmijëve të tyre.

Në rast pasojash të rënda psikike dhe sociale mbi të rinjtë në rast cyberbullizimi të tyre, përgjegjësinë në këtë rrafsh duket se nuk e ka teknologjia në vetvete, por mangësi të ndryshme në shoqërimin nga familja të procesit të formimit të të rinjve për një komunikim shëndetshëm si me botën jashtë familjes ashtu edhe me atë brenda-familjare.




Diagrama 43

Do të kuptohet disi familja. Por, mbetet shumë shqetësues fakti që edhe komunikimi me mësuesit i të rinjve në rast cyberbullizimi paraqitet i zbehtë.

Diagrama 49 e tregon më se qartë sa më sipër. Janë vetëm 7,7 për qind e të anketuarve që shprehen se në raste të tilla do të konsultoheshin dhe do të kërkonin ndihmesën e mësuesve (shkalla 1+2 e vlerësimit). Kurse 89,1 për qind e të anketuarve shprehen se nuk do ta bënin ose do ta bënin me shumë vështirësi këtë gjë (shkalla 6+7 e vlerësimit).

Me mësuesit

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	716	84.3%
2	41	4.8%
3	25	2.9%
4	17	2.0%
5	17	2.0%
6	16	1.9%
7	17	2.0%
Total	849	100.0%




Diagrama 44


Mirë prindërit, po shkolla, po mësuesit? Janë të pa interesuar për t'u marrë me këto probleme sepse i quajnë pjesë e jetës jashtëshkollore të nxënësve? Nuk duan të përzihen me to? Apo mendojnë se detyra për të cilën paguhen është vetëm dhënia e njohurive për nxënësit dhe jo edhe edukimi etik i tyre? Nuk i kuptojnë këto probleme për shkak të mangësive që vetë mësuesit kanë në formimin e tyre në fushën e komunikimit, psikologjisë, pedagogjisë?

Në po këto nivele shprehet edhe prirja për t'u konsultuar me psikologë dhe këshillues të tjerë në shkollë dhe jashtë saj. Por, komunikimi për këto probleme delikate është i zbehtë dhe me shokë e shoqe në shkollë, me kolegë në punë. Këtë e dëshmojnë të dhënat e diagramës 50

Vetëm 9,6 për qind e të anketuarit do t'i kishin ndarë shqetësimet e tyre në rast cyberbullizimi me shokë e shoqe pune a shkolle (shkalla 1+2 e vlerësimit), kurse 82,6 për qind e tyre thonë se nuk do ta kishin bërë ose do ta kishin bërë me shumë vështirësi këtë gjë. (shkalla 6 + 7 e vlerësimit)

37.4 Shokët e shoqet në shkollë a në punë

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	599	70.9%
2	42	5.0%
3	40	4.7%
4	46	5.4%
5	40	4.7%
6	30	3.6%
7	48	5.7%
Total	845	100.0%



37.5 Me psikologë, këshillues, etj.

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	662	78.2%
2	37	4.4%
3	28	3.3%
4	21	2.5%
5	25	3.0%
6	30	3.5%
7	44	5.2%
Total	847	100.0%




Diagrama 45

Një përfundim del vetiu:

Shqetësimet në raste delikate cyberbullizimi, individit priret t'i përballojë vetëm, mbyllet në vetvete, izolohet, vuan në vetmi. Kjo i bën pasojat e cyberbullizimit edhe më të rënda dhe shqetësuese.

Cyberbullizimi e bën të vuajë një njeri duke e izoluar apo vetë-izoluar atë.

Por, ky vetë-izolim nuk i prek njësoj të gjitha grupet shoqërore që përfaqësojnë të anketuarit. Djemtë e quajnë më të panevojshme sesa vajzat të "hapen" me mësuesit mësueset e tyre për shqetësime lidhur me cyberbullizimin. Janë 87,1 për qind e të anketuarve meshkujt që gjykojnë se të flasësh për këto çështje me mësuesit është pa ndonjë vlerë të veçantë (Shkalla 1+2 e vlerësimit). Kurse vajzat mendojnë po kështu në masën 81,8 për qind të tyre (shkalla 1+2 e vlerësimit).

5 Me mësuesit (sipas gjinisë)

	1	2	3	4	5	6	7	Total
1. Femër	354	24	15	12	12	7	9	433
2. Mashkull	357	16	10	5	5	9	8	410
	në nr.							
1. Femër	81.8%	5.5%	3.5%	2.8%	2.8%	1.6%	2.1%	100.0%
2. Mashkull	87.1%	3.9%	2.4%	1.2%	1.2%	2.2%	2.0%	100.0%
	në %							




Diagrama 46

Edhe me prindërit është po e njëjta marrëdhënie. Djemtë hapen më pak me ta sesa vajzat, pavarësisht se në masë dërmuese mesatarisht si vajzat ashtu edhe djemtë gjykojnë se kjo nuk do të kishte ndonjë vlerë. Të dhëna të hollësishme për këtë na jep diagrama 47. Fakti është se në krahasim me dialogun me mësuesit për këto çështje, me prindërit ka një përpjekje për të folur më shumë. Vajzat që e konsiderojnë si të rëndësishme të flasin me prindërit përfaqësojnë mesatarisht 20,2 për qind e të anketuarve, kurse djemtë më pak se vajzat, 11,4 për qind.

P37. Kur jeni cyberbullizuar, keni ndjerë nevojën ta ndani shqetësimin tuaj më tepër me: Më pak 1, më shumë 7

37.1 Prindërit (sipas gjinisë)

	1	2	3	4	5	6	7	Total
<i>në nr.</i>								
1. Femër	274	19	17	22	15	13	75	435
2. Mashkull	295	21	12	16	21	12	35	412
<i>në %</i>								
1. Femër	63.0%	4.4%	3.9%	5.1%	3.4%	3.0%	17.2%	100.0%
2. Mashkull	71.6%	5.1%	2.9%	3.9%	5.1%	2.9%	8.5%	100.0%




Diagrama 47

Diagrama 48 me të dhënat e saj paraqet prirjen që të rinjtë sipas grup moshave të caktuara sa më tepër rriten aq më pak kanë prirje të ndajnë me prindërit dhe me mësuesit shqetësimet e tyre në rast cyberbullizimi.

Përgjigje-dhënësit nga mosha 13 deri në 16 vjeç mendojnë se është e rëndësishme t'i ndajnë shqetësimet e tyre në rast cyberbullizimi me prindërit në masën e 46 % e tyre.

Përgjigje-dhënësit nga mosha 17 deri 19 vjeç mendojnë të njëjtën gjë masën 17,6 për qind e tyre.

Përgjigje-dhënësit nga mosha 20 deri 23 vjeç mendojnë po kështu në masën 14,4 për qind e tyre.

Përgjigje-dhënësit nga mosha 24 deri 45 vjeç kanë të njëjtin mendim në masën vetëm 6 për qind e tyre.

Prindërit (sipas grupmoshës)

	1	2	3	4	5	6	7	Total
	në nr.							
1. Nga 13 deri 16 vjeç	69	10	9	9	11	8	34	150
2. Nga 17 deri 19 vjeç	154	20	7	17	16	11	48	273
3. Nga 20 deri 23 vjeç	89	3	6	3	2	4	18	125
4. Nga 24 deri 45 vjeç	103	4	5	7	6	2	9	136
5. Nga 46 deri 60 vjeç	89	2	1	1	1	0	1	95
6. Nga 61 vjeç e lart	67	2	1	1	0	0	0	71
	në %							
1. Nga 13 deri 16 vjeç	46.0%	6.7%	6.0%	6.0%	7.3%	5.3%	22.7%	100.0%
2. Nga 17 deri 19 vjeç	56.4%	7.3%	2.6%	6.2%	5.9%	4.0%	17.6%	100.0%
3. Nga 20 deri 23 vjeç	71.2%	2.4%	4.8%	2.4%	1.6%	3.2%	14.4%	100.0%
4. Nga 24 deri 45 vjeç	75.7%	2.9%	3.7%	5.1%	4.4%	1.5%	6.6%	100.0%
5. Nga 46 deri 60 vjeç	93.7%	2.1%	1.1%	1.1%	1.1%	0.0%	1.1%	100.0%
6. Nga 61 vjeç e lart	94.4%	2.8%	1.4%	1.4%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%




Diagrama 48

Interesante është se familja në zonat rurale paraqitet një mjedis shoqëror ku të anketuarit, sidomos ata të moshave të reja, kanë prirje të flasin më shumë me prindërit për problemet delikate si pasojë e të qenit të ciberbullizuar sesa në qytetet kryesore të vendit.

Në të dyja rastet ndajne pak, por në zonat rurale më shumë se në qytete.

Kështu sipas diagramës 49 pohojnë se ndajne me prindërit 17,8 për qind e atyre që banojnë në këto zona, kurse midis atyre që banojnë në qytete kryesore të vendit të tillë janë 12,9 për qind e tyre që pohojnë të njëjetën gjë.

Duket se familja rurale ose e ajo që karakterizon zonat urbane periferike është më pranë anëtarëve të saj, sidomos të rinjve, kur është fjala për të përballuar shqetësime që u sjellin atyre pasojat e cyberbullizimit.

Prindërit (sipas vendbanimit)

	7	6	5	4	3	2	1	Total
	në nr.							
1. Qytet qendër qarku	73	15	27	23	19	24	384	565
2. Qytet jo qendër qarku	15	6	6	10	5	7	114	163
3. Zonë rurale	19	4	3	5	4	8	64	107
4. Tjetër	2	0	0	0	1	1	8	12
	në %							
1. Qytet qendër qarku	12.9%	2.7%	4.8%	4.1%	3.4%	4.2%	68.0%	100.0%
2. Qytet jo qendër qarku	9.2%	3.7%	3.7%	6.1%	3.1%	4.3%	69.9%	100.0%
3. Zonë rurale	17.8%	3.7%	2.8%	4.7%	3.7%	7.5%	59.8%	100.0%
4. Tjetër	16.7%	0.0%	0.0%	0.0%	8.3%	8.3%	66.7%	100.0%




Diagrama 49

6. Ndikimet e cyberbullizimit mbi psikologjinë individuale dhe anasjelltas

Pasojat e cyberbullizimit mbi komunikuesit mund të jenë psikologjike, por edhe trupore; gjithashtu ato mund të shkaktojnë ndryshime në sjellje, në marrëdhëniet me të tjerët, në përqendrimin në punë, etj.

Gjithsesi, në literaturën e sotme shkencore ka një vëmendje të shtuar në ndikimet e veprimeve cyberbullizuese mbi psikikën dhe gjendjen psikologjike të atij apo asaj që i pëson përmbajtjet me orientim ngacmimi kibernetik.

Rezultatet e anketimit që po paraqiten këtu dëshmojnë për një ndërlidhje midis dy faktorëve të mësipërm. Cyberbullizimi godet psikologjinë e viktimave të tij në forma dhe intensitete të ndryshme. Ajo që duam të theksojmë si konsideratë shtesë është se nga ana tjetër edhe gjendja psikologjike e komunikuesit, përgatitja e tij në planin psikik, profili i tij psikologjik, ndikojnë mbi atë sesi i përthith ai përmbajtjet cyberbullizuese, në çfarë shkalle veprojnë ato mbi gjendjen e tij shpirtërore, çfarë dëmsh i shkaktojnë, etj.

Koncepti “tip psikologjik”, ose “profil psikologjik” duket në fakt shumë abstrakt. Njerëzit janë me gjendje shpirtërore dhe psikologjike që ndryshojnë sipas moshës, rrethanave dhe marrëdhënieve ku ata përfshihen. Po ashtu është vështirë që një person ta kualifikosh në këtë apo atë tipologji psikologjike. Si rregull, prirje psikologjike të ndryshme, madje edhe të kundërta, mundet që bashkëjetojnë brenda ndërgjegjes së çdo njeriu.

Megjithatë, në një rrafsh shumë të përgjithshëm, lidhur me disa karakteristika të veçanta që mund të karakterizojnë këtë apo atë natyrë njerëzore, në psikologji flitet edhe për “tipa psikologjikë” sipas këndvështrimeve të ndryshme.

Pa dashur të hyjmë në këtë hulli, theksojmë vetëm se të dhënat e anketës japin mundësi që të shihen disa reagime të përgjithshme psikologjike sipas segmenteve të veçanta të anketuarish apo të gjithë të anketuarve së bashku. Është fjala për tipare të përbashkëta, mesatarisht pak a shumë të njëjta, të cilat japin mundësi të profilizohen tipologji psikologjike të veçanta.

Diagrama 50 paraqet të dhëna sasiore që japin të kuptosh se të anketuarit duken se psikologjikisht preken shpejt nga përmbajtjet cyberbullizuese, ndjejnë turp, mërzi, ofendohen, trishtohen lehtë. Nga ana tjetër, nga përgjigjet që kanë dhënë, pohojnë se janë tipa psikologjikë që revoltohen jo pak ndaj ngacmimeve në komunikim, madje edhe kanë prirjen të kundërveprojnë shpejt dhe fort, me të njëjtin ton, ndaj atyre që janë autorët e këtyre ngacmimeve.

Përgjigjen se “prekem shpejt” : 63 për qind e të anketuarve.

Nga ana tjetër të anketuarit pohojnë në masën e 71,6 për qind të tyre se revoltohen shpejt kundër atyre që i cyberbullizojnë.

Jo vetëm kaq, por edhe reagojnë fuqishëm ndaj tyre. Kështu janë përgjigjur 63,9 për qind e të anketuarve.

Nëse do të flisnim për “tip psikologjik”, ky profil ka natyrën që preket shpejt dhe reagon fort si kundërveprim.

Nuk është tip menefregist, as indiferent, as i squllët ose i mpakur. Duke pasur këtë lloj tipologjie psikologjike që mesatarisht dëshmon të tilla karakteristika, një profil i tillë psikologjik e rrit shkallën e cyberbullizimit të ndërsjellë në shoqëri. Është vështirë të thuash nëse ky është “tipi psikologjik” i shqiptarit të sotëm ose jo. Por, dihet nga ana tjetër që tipa me këto sjellje e këto prirje psikologjike gjen jo pak në shoqëri dhe në komunikimin në rrjetet sociale apo forumet online.




Diagrama 50

Gjendja psikologjike negative që krijon si rregull cyberbullizimi nuk ndikon vetëm mbi individin ndaj të cilit ai vepron, por edhe mbi mënyrat e sjelljes së tij. Është fjala për sjelljen individuale në përgjithësi, por edhe për veprime të veçanta të tij. Kjo e dhënë mund të vlejë edhe për shërbimet e marketingut të kompanive të telekomunikacionit. Ekspozimi i komunikuesve, sidomos i atyre në mosha shumë të reja apo të reja, por jo vetëm, ndaj veprimeve cyberbullizuese përgjatë përdorimit të teknologjive dixhitale të komunikimit, ka prirje t'i frenojë ata për të qenë përdorues edhe më intensivë të tyre. Ose i detyron të heqin dorë fare nga komunikimi dixhital.

Diagrama 51, me pyetjen që përmban : “Mendoni se frika ndaj cyberbullizimit e frenon disi përdorimin e telefonit me lidhje Interneti?” ofron të dhëna interesante në këtë drejtim. Pothuajse 60 për qind e numrit të përgjithshëm të të anketuarve mendojnë se ndrojtja nga cyberbullizimi dhe dëshira për të qenë i mbrojtur prej tij e frenon dëshirën për të qenë konsumator i shërbimit të telefonisë të lidhur në Internet.

P44. Mendoni se frika ndaj cyberbullizimit e frenon disi përdorimin e telefonit me lidhje Interneti?

	Nr.	%
Po	348	40.2%
Jo	517	59.8%
Total	865	100.0%




Diagrama 51

Një bashkësi diagramesh që fillojnë nga diagrama 52, dhe vazhdojnë me diagramat 53, 54, 55, 56, 57 na ofrojnë të dhëna të bollshme dhe të detajuara për atë se nga çfarë konkretisht ndruhen të anketuarit se cyberbullizimi do t'u shkaktonte në planin psikologjik.

Këto të dhëna nga njëra anë tregojnë se nga ndruhen më tepër të anketuarit, por edhe ndërtojnë një lloj hierarkie dëmesh psikologjike që vijnë nga cyberbullizimi. Kuptohet se jo të gjitha dëmet e nivelit psikologjik kanë të njëjtin ndikim mbi të gjithë njerëzit që komunikojnë.

Nëse do të donim ta rindërtonim këtë hierarki sipas të dhënave të përftuara nga anketimi do të ndërtonim një shkallëzim me tri nivele që do të përfaqësonin shkallë të ndryshme ndrojtjeje për dëme të caktuara.

Në krye qëndrojnë ato forma cyberbullizimi që lidhen me përndjekje të jetës individuale, private, intime të çdo njeriu dhe bëjnë publike anë të veçanta që lidhen me të. Të anketuarit që e vlerësojnë këtë dëm në nivelin më të lartë (shkalla 6 + 7 e vlerësimit) përbëjnë 75,2 për qind e të gjithë të anketuarve. Në po këto nivele vijnë edhe ngacmimet me natyrë seksuale, të cilat në të njëjtin nivel rreziku, konsiderohen nga 73,8 për qind e të anketuarve.


Në rang të dytë nga rrezikshmëria e ndjerë dhe nga dëmet e shkaktuara vijnë kërcënimet përgjatë komunikimit dixhital. Të anketuarit që i konsiderojnë kërcënimet si formë cyberbullizimi me nivel të lartë rrezikshmërie dhe dëmi (shkalla 6 + 7 e vlerësimit) përbëjnë 69,4 për qind të gjithë numrit të anketuarve.

Në rang të tretë vijnë ato vepra cyberbullizuese që shkaktojnë turpërim përpara të tjerëve. Kështu përgjigjen (shkalla 6 + 7 e vlerësimit) 63,5 për qind e të anketuarve.

P28. Nga këto që janë shënuar më poshtë, sa do të ishit shqetësuar nëse do t'i kishit pësuar ju personalisht, ose të njohur apo të afërm tuaj ?

28.1 Fyerje të ndryshme

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	67	7.8%
2	33	3.8%
3	64	7.4%
4	101	11.7%
5	130	15.1%
6	100	11.6%
7	368	42.6%
Total	863	100.0%



28.2 Kërcënime

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	97	11.2%
2	22	2.5%
3	34	3.9%
4	50	5.8%
5	61	7.1%
6	88	10.2%
7	511	59.2%
Total	863	100.0%





Diagrama 52

28.3 Turpërim para të tjerëve

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	93	10.8%
2	34	3.9%
3	36	4.2%
4	62	7.2%
5	90	10.4%
6	115	13.3%
7	434	50.2%
Total	864	100.0%



28.4 Ofendime

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	98	11.4%
2	36	4.2%
3	61	7.1%
4	85	9.9%
5	103	12.0%
6	123	14.3%
7	352	41.0%
Total	858	100.0%





Diagrama 53

28.5 Nxjerrje në publik e informacioni intim

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	75	8.8%
2	20	2.3%
3	22	2.6%
4	23	2.7%
5	37	4.3%
6	64	7.5%
7	612	71.7%
<i>Total</i>	<i>853</i>	<i>100.0%</i>



28.6 Nënveftësim për ju, ose injorim

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	168	19.6%
2	73	8.5%
3	88	10.3%
4	88	10.3%
5	86	10.0%
6	96	11.2%
7	257	30.0%
<i>Total</i>	<i>856</i>	<i>100.0%</i>





Diagrama 54

28.7 Shpifje dhe thashetheme pa bazë

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	182	21.2%
2	65	7.6%
3	63	7.3%
4	68	7.9%
5	84	9.8%
6	96	11.2%
7	301	35.0%
<i>Total</i>	<i>859</i>	<i>100.0%</i>



28.8 Epitete fyese për trupin tuaj

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	225	26.3%
2	67	7.8%
3	60	7.0%
4	65	7.6%
5	65	7.6%
6	83	9.7%
7	292	34.1%
<i>Total</i>	<i>857</i>	<i>100.0%</i>





Diagrama 55

28.9 Fyerje për origjinën tuaj sociale ose etnike

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	258	30.0%
2	64	7.4%
3	53	6.2%
4	62	7.2%
5	55	6.4%
6	68	7.9%
7	300	34.9%
Total	860	100.0%



28.10 Përpjekje për ngacmim seksual

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	127	14.8%
2	17	2.0%
3	29	3.4%
4	26	3.0%
5	29	3.4%
6	54	6.3%
7	576	67.1%
Total	858	100.0%




Diagrama 56

28.11 Gjuhë urrejtje për ju

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	197	22.9%
2	47	5.5%
3	51	5.9%
4	66	7.7%
5	86	10.0%
6	91	10.6%
7	323	37.5%
Total	861	100.0%




Diagrama 57

Duhet thënë se pavarësisht çfarë forme që të marrin sjelljet komunikuese që përbëjnë cyberbullizim ato shkaktojnë përgjithësisht ndjenja negative në psikikën e njeriut.

Nga të tilla përjetime janë edhe frika dhe trishtimi.

Diagrama 58 jep të dhëna se çfarë vendi zënë ato ndër të anketuarit. Në një shkallë vlerësimi të përmendur edhe më parë, e cila nis nga 1, vlerësimi më i ulët, deri në 7, vlerësimi më i lartë, të anketuarit janë shprehur se cyberbullizimi u shkakton shumë frikë (niveli 5 + 6 + 7 i vlerësimit) në masën e 10,9 për qind të tyre.

U shkakton trishtim në po të njëjtën masë 14,3 për qind prej tyre.


Më tepër shkakton trishtim, mërzë, bezdi se frikë.

Një ndër dhjetë të anketuar të cyberbullizuar ndjen shumë frikë nga forma të ndryshme ngacmimi kibernetik. Janë forma të reja postmoderne frike. Duket si një numër relativisht i vogël. Por, në fakt nuk janë pak nëse do ta gjykojmë dukurinë në shkallën reale të shoqërisë. Përlllogaritjet më të thjeshta të çojnë në dhjetëra mijëra individë të frikësuar jo pak nga devijimet

e sjelljeve njerëzore përgjatë procesit të komunikimit dixhital. Po aq, si duket edhe më shumë, njerëz të trishtuar.

29.2 Frikë

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	622	73.3%
2	58	6.8%
3	37	4.4%
4	39	4.6%
5	33	3.9%
6	32	3.8%
7	27	3.2%
Total	848	100.0%



29.3 Trishtim

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	560	66.6%
2	37	4.4%
3	60	7.1%
4	55	6.5%
5	40	4.8%
6	39	4.6%
7	50	5.9%
Total	841	100.0%




Diagrama 58

Femrat përjetojnë më tepër frikë sesa meshkujt.

Diagrama 59 na tregon se në nivelin 5 + 6 + 7 të shkallës së vlerësimit femra shumë të frikësuar paraqiten 13,7 për qind e të anketuarave femra, ndërsa meshkujt e frikësuar shumë nga ngacmime kibernetike janë 7,8 për qind et të anketuarve meshkuj.

Frikë kundër cyberbullizuesit (sipas gjinisë)

	1	2	3	4	5	6	7	Total
1. Femër	297	31	20	25	21	20	18	432
2. Meshkull	321	26	17	14	11	12	9	410
	në %							
1. Femër	68.8%	7.2%	4.6%	5.8%	4.9%	4.6%	4.2%	100.0%
2. Meshkull	78.3%	6.3%	4.1%	3.4%	2.7%	2.9%	2.2%	100.0%




Diagrama 59

Cyberbullizimi prodhon urrejtje në gjirin e shoqërisë. Individët e përfshirë në të nisin të prirën për ta urreyer njëri tjetrin. Kjo e bën cyberbullizimin një dukuri interaktive. Problemi është se ka jo pak raste kur cyberbullizimi kthehet në përleshje, sherre, plagosje ose edhe vrasje personash. Konflikti dhe urrejtja dalin nga ekranet dhe mbushin rrugët dhe sheshet publike.

Problemi qendron se shkallën më të lartë të urrejtjes cyberbullizimi e prodhon te moshat më të reja.

I deformon ata urrejtja përpara sesa të formohen plotësisht me vlerat njerëzore.

Prodhojnë tipa asocialë.

Urrejtja hy në shpirta të rinj në moshë kur kanë më pak mundësi ta kontrollojnë atë. Te ata urrejtja psikologjike ka prirje të kthehet më shpejt se në mosha të tjera në veprime praktike agresive.

E ka vështirë të përmbahet.

Diagrama 60 përmban të dhëna që e vërtetojnë përfundimin e nxjerrë. Urrehen më fort të rinjtë me njeri tjetrin sesa ata me moshë më të rritur.

Në një shkallë vlerësimi të lartë (5 + 6 + 7) të anketuarit pohojnë se urrejnë fort në rast se janë të cyberbullizuar sipas të dhënave të mëposhtme:

13 – 16 vjeçarët në masën 30 përqind e tyre.

17 – 19 vjeçarët në masën 30 për qind e tyre.

20 – 23 vjeçarët në masën 22 për qind e tyre.

24 – 45 vjeçarët në masën 17,9 për qind e tyre.

Urrejtje kundër cyberbullizuesit (sipas grupmoshës)

	1	2	3	4	5	6	7	Total
	në nr.							
1. Nga 13 deri 16 vjeç	78	7	7	13	9	8	28	150
2. Nga 17 deri 19 vjeç	149	10	16	14	19	15	47	270
3. Nga 20 deri 23 vjeç	81	3	9	3	2	12	13	123
4. Nga 24 deri 45 vjeç	92	7	7	4	5	6	13	134
5. Nga 46 deri 60 vjeç	77	3	1	2	1	7	4	95
6. Nga 61 vjeç e lart	59	1	2	1	2	1	5	71
	në %							
1. Nga 13 deri 16 vjeç	52.0%	4.7%	4.7%	8.7%	6.0%	5.3%	18.7%	100.0%
2. Nga 17 deri 19 vjeç	55.2%	3.7%	5.9%	5.2%	7.0%	5.6%	17.4%	100.0%
3. Nga 20 deri 23 vjeç	65.9%	2.4%	7.3%	2.4%	1.6%	9.8%	10.6%	100.0%
4. Nga 24 deri 45 vjeç	68.7%	5.2%	5.2%	3.0%	3.7%	4.5%	9.7%	100.0%
5. Nga 46 deri 60 vjeç	81.1%	3.2%	1.1%	2.1%	1.1%	7.4%	4.2%	100.0%
6. Nga 61 vjeç e lart	83.1%	1.4%	2.8%	1.4%	2.8%	1.4%	7.0%	100.0%




Diagrama 60

Moshat e reja urrejnë më fort. Nuk është pak të dish se pothuajse një në tre të rinj e të reja ka ndjerë urrejtje për moshatarë të vet që e kanë ngacmuar. Urrejnë fort, por edhe kanë frikë më tepër se më të rriturit. Është e natyrshme, urrejtja prodhon frikë, frika prodhon urrejtje, jo rrallë.

Diagrama 61 tregon pikërisht se moshat fëmijërore dhe të reja kanë frikë më tepër sesa moshat e reja dhe të mesme.

13 – 16 vjeçarët shprehen se kanë frikë në nivelet 5 + 6 + 7 të shkallës së vlerësimit në masën e 12,8 për qind të tyre.

17 – 19 vjeçarët në masën e 15,4 për qind të tyre.

20 – 23 vjeçarët në masën e 13,6 për qind të tyre.

24 – 45 vjeçarët në masën e e 4,6 për qind të tyre.

46 – 60 vjeçarët në masën e 5,3 për qind të tyre.

Frikë kundër cyberbullizuesit (sipas grupmoshës)

	1	2	3	4	5	6	7	Total
	në nr.							
1. Nga 13 deri 16 vjeç	99	11	8	12	7	4	8	149
2. Nga 17 deri 19 vjeç	177	29	10	14	14	18	10	272
3. Nga 20 deri 23 vjeç	90	5	9	3	6	7	4	124
4. Nga 24 deri 45 vjeç	108	8	5	7	3	2	1	134
5. Nga 46 deri 60 vjeç	84	2	3	1	2	1	2	95
6. Nga 61 vjeç e lart	62	3	1	2	1	0	2	71
	në %							
1. Nga 13 deri 16 vjeç	66.4%	7.4%	5.4%	8.1%	4.7%	2.7%	5.4%	100.0%
2. Nga 17 deri 19 vjeç	65.1%	10.7%	3.7%	5.1%	5.1%	6.6%	3.7%	100.0%
3. Nga 20 deri 23 vjeç	72.6%	4.0%	7.3%	2.4%	4.8%	5.6%	3.2%	100.0%
4. Nga 24 deri 45 vjeç	80.6%	6.0%	3.7%	5.2%	2.2%	1.5%	0.7%	100.0%
5. Nga 46 deri 60 vjeç	88.4%	2.1%	3.2%	1.1%	2.1%	1.1%	2.1%	100.0%
6. Nga 61 vjeç e lart	87.3%	4.2%	1.4%	2.8%	1.4%	0.0%	2.8%	100.0%




Diagrama 61

E kemi theksuar edhe më parë. Kur flitet për pasojat psikologjike të cyberbullizimit nuk ka një matës objektiv, të pavarur nga gjendja psikike e të cyberbullizuarit. Matet vetëm efekti që veprimi konkret objektiv cyberbullizues shkakton në psikikën e të cyberbullizuarit. Kjo do të thotë se të njëjtat akte cyberbullizuese nuk shkaktojnë të njëjtat pasoja te të cyberbullizuarit, nuk kanë të njëjtin intensitet veprimi. Madje në varësi të gjendjes psikike të të cyberbullizuarit mund të ketë akte që nuk vihen re fare se ekzistojnë.

Anketimi e ka vërtetuar këtë situatë.

Tipat që preken lehtë e ndjejnë më të fortë dhe të përhapur dukurinë e cyberbullizimit sesa tipat psikologjikë indiferentë.

Diagrama 62 dëshmon si më poshtë:

Tipat që preken shpejt nga të anketuarit pohojnë në masën 71,9 % të tyre se ndodhen nën presionin e cyberbullizimit.




Diagrama 62

Kurse, në të kundërt, tipat psikologjikë indiferentë pohojnë se kanë qenë nën presionin e cyberbullizimit në masën 26 për qind të tyre. Këtë e tregon diagrama 63:




Diagrama 63

Gjithsesi, të dhënat e anketimit dëshmojnë se pasojat e gjithanshme që cyberbullizimi shkakton mbi viktimat e tij janë të ndjeshme. Diagrama 64 paraqet disa prej tyre.

Është e rëndësishme është theksohet se vetëm një shtatë të anketuar mendon se cyberbullizimi nuk i ka lënë ndonjë pasojë. Kështu shprehen 14, 6 për qind e të anketuarve.

Anketimi tregon se tjetër është cyberbullizimi dhe krejt tjetër kritika konstruktive shoqërore. Përgjithësisht i cyberbullizuari identifikohet shumë pak me imazhin që cyberbulluesi kërkon ta asociojë. Vetëm një në dhjetë të anketuar pohon se pasi është cyberbullizuar ka nisur ta shohë

veten me atë sy që cyberbullizuesi e ka parë. Pra, janë 9,8 për qind e të anketuarve që e pohojnë këtë.

Të hutuar, pa ditur çfarë të bëjnë, pohojnë se kanë qenë 21,6 për qind e të anketuarve.

23,2 për qind e të anketuarve janë shprehur se u ka lindur dëshira për të reaguar me atë ton dhe agresivitet që ka përdorur cyberbullizuesi për t'i ngacmuar.

Kurse 26,5 kanë dashur të kërkojnë shpjegime për sulmin që u është bërë.

P39. Kur ju ka ndodhur të cyberbullizoheni, çfarë reagimi keni pasur?						
	Po	Jo në nr.	Total	Po	Jo në %	Total
P39.1 Ju ka lindur dëshira e përgjigjes së ashpër me të njëjtat tema	198	654	852	23.2%	76.8%	100.0%
P39.2 Keni qenë indiferentë	193	660	853	22.6%	77.4%	100.0%
P39.3 E keni dënuar me veten tuaj por nuk keni reaguar	134	715	849	15.8%	84.2%	100.0%
P39.4 Keni kërkuar shpjegime dhe dhënë sqarime	226	626	852	26.5%	73.5%	100.0%
P39.5 Keni pasur pagjumësi	123	726	849	14.5%	85.5%	100.0%
P39.6 Keni rënë në pesimizëm dhe depresion	78	773	851	9.2%	90.8%	100.0%
P39.7 Jeni detyruar të merrni medikamente qetësuese	51	799	850	6.0%	94.0%	100.0%
P39.8 Keni pasur dhimbje koke dhe trupi	140	710	850	16.5%	83.5%	100.0%
P39.9 Jeni hutuar	183	664	847	21.6%	78.4%	100.0%
P39.10 Keni parë me atë sy veten tuaj	83	766	849	9.8%	90.2%	100.0%
P39.11 Jeni mobilizuar më tepër për të qenë të vendosur në rrugën tuaj	191	656	847	22.6%	77.4%	100.0%
P39.12 Asnjë pasojë	121	710	831	14.6%	85.4%	100.0%
P39.13 Tjetër	62	709	771	8.0%	92.0%	100.0%




Diagrama 64

7. Rrugë për ta zbehur dhe evituar cyberbullizimin

Në artikullin shkencor të cili jemi referuar disa herë në këtë raport gjenden tri ide kryesore lidhur me rrugët për ta evituar, zbehur, cyberbullizimin në shoqëri, apo edhe për të përballuar dhe zbutur pasojat e tij në psikologjinë e atyre që i kanë pësuar.

Ideja e parë është se masa për ta parandaluar cyberbullizimin, apo për të kuruar dhe lehtësuar pasojat e tij në shoqëri ndahen në dy lloje:

- a. Proaktive. Këto masa i japin më tepër rëndësi parandalimit të këtyre sjelljeve deviante në komunikim. Të tilla janë edukimi i të rinjve, por jo vetëm, edhe i grup-moshave të tjera, për një komunikim dixhital që të respektojë norma që e bëjnë atë të shëndetshëm, apo i masave të tjera që e bëjnë komunikimin dixhital të evitojë vizitat në faqe apo website të rrezikshme, etj.

Kjo do të kërkonte që familja, shkolla, institucione të tjera edukuese ta mbanin në qendër të vëmendjes formimin e koncepteve sa më të plota mbi komunikimin dixhital, mbi etikën e komunikimit në rrjetet sociale, mbi rrugën e administrimit të krizave në komunikim, të negocimit, etj. Pra, kërkohet edukimi me parimet dhe nocionet e media literacy.

Anketimi dëshmoi se jo vetëm shkolla, por edhe familja i qëndrojnë larg këtyre problemeve. Niveli i edukimit të individëve të grup-moshave të ndryshme lidhur me këtë fushë është ende larg asaj që kërkohet.

Sikurse tregon diagrama 65, 80,8 përqind e atyre që konsiderohen si prindër apo kujdestarë fëmijësh nuk kanë arritur në asnjë rast të konstatojnë as shenja se fëmijët apo të rinjtë që kanë në ngarkim kanë pasur shqetësime të ardhura nga cyberbullizimi.

63,5 për qind e tyre pohojnë se nuk i kanë konceptet dhe formimin për ta ndërmarrë këtë edukim.

- b. Reaktive, ose vepruese kundër pasojave që shkakton cyberbullizimi, sikurse ta zëmë isomnia, depresioni, migrena, hiper-eksitimi, varësia ndaj duhanit, pijes, apo edhe drogave, ulja e vetëvlerësimit, sjelljet asociale, etj. Por, këto masa kërkojnë që së pari të zhvillohen shërbimet ndaj qytetarëve për t'i ndihmuar ata t'i përballojnë, dhe para së gjithash që këto të njihen si simptoma të problemeve që individi ka me shëndetin e tij fizik dhe mendor.

Nëse jeni prind ose kujdestar fëmijësh të moshave të ndryshme	Po	Jo në nr.	Total	Po në %	Jo në %	Total
P.24.1 Keni vënë re te fëmijët tuaj shqetësime të ardhura nga fakti se ata janë cyberbullizuar?	55	231	286	19.2%	80.8%	100.0%
P.24.2 Mendoni se po të cyberbullizohen, fëmijët tuaj do të flisin hapur me ju dhe do të kërkonin ndihmesën tuaj?	157	122	279	56.3%	43.7%	100.0%
P.24.3 I parapërgatisni fëmijët tuaj që më parë që të përballin me sukses një cyberbullizim të mundshëm?	163	113	276	59.1%	40.9%	100.0%
P.24.4 Keni njohuritë e duhura për të trajtuar dukurinë e cyberbullizimit ndaj të cilit mund të jenë viktimë fëmijët tuaj?	101	176	277	36.5%	63.5%	100.0%




Diagrama 65

Ideja e dytë lidhet me atë që masat mbrojtëse të përpunuara deri tani në kontekste vendesh të ndryshme përfshijnë një gamë të gjerë procedurash, veprimesh, instrumentesh, të cilët sigurisht ndihmojnë, por jo të gjithë kanë efikasitetin e duhur. Autorët theksojnë që në vitet e fundit është ndjerë prirja për të përforcuar legjislacionin kundër shfaqjeve të cyberbullizimit, për të ruajtur privatësinë e jetës individuale, dhe për të ndëshkuar si krime ato që kanë të bëjnë me format e theksuara të ngacmimit kibernetik. Gjithsesi, ka hezitime nëse përforcimi i legjislacionit dhe masat ndëshkimore janë gjithmonë efikase dhe nëse mund të aplikohen në të gjitha rastet e tilla.


Diagrama 66 tregon se edhe për të anketuarit, në kuadrin e studimit që po paraqesim, përgjegjësia për ta mbrojtur qytetarin nga veprimet veprimet cyberbullizuese bie vetëm në mënyrë relative mbi shtetin. Vetëm 19,9 për qind e të anketuarve mendojnë në mënyrë të thekshme (shkalla 6 + 7 e vlerësimit) se është shteti që duhet të marrë masa për të mbrojtur qytetarët.

Madje kur është fjala për të marrë masa normative, të anketuarit ua kërkojnë sigurimin e konsumatorëve nga cyberbullizimi edhe më pak kompanive të telekomunikacionit se shtetit. Janë vetëm 9,6 për qind e të anketuarve që mendojnë thekshëm (shkalla 6 + 7 e vlerësimit) se kjo detyrë u bie kompanive të telekomunikacionit dhe se mund të jetë e efektshme.

P36. Për cyberbullizimin, sa përgjegjësi mbajnë institucionet e mëposhtme:

36.1 Shteti

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	317	36.7%
2	106	12.3%
3	99	11.5%
4	99	11.5%
5	73	8.5%
6	42	4.9%
7	127	14.7%
<i>Total</i>	<i>863</i>	<i>100.0%</i>



36.2 Kompanitë e telekomunikacionit

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	411	47.9%
2	107	12.5%
3	97	11.3%
4	64	7.5%
5	60	7.0%
6	37	4.3%
7	82	9.6%
<i>Total</i>	<i>858</i>	<i>100.0%</i>




Diagrama 66


Më tepër të anketuarit u besojnë masave teknologjike, të cilat mund ta sinjalizojnë në kohë reale cyberbullizimin, apo që mundësojnë evidentimin e autorëve të tij, sikurse edhe bllokojnë përmbajtje cyberbullizuese.

Të anketuarit si konsumatorë, sikurse e dëshmojnë të dhënat e diagramës 67, pohojnë se dinë që janë hedhur në treg të tilla aplikacione vetëm në masën 45,6 për qind të tyre. Ata dëshmojnë si të interesuar në masën 51,3 për qind të tyre për të blerë aplikacione të tipit që sigurojnë kontrollin prindëror në komunikimet telefonike, etj.

P.26 Keni dëgjuar se ndonjë kompani telefonike të ketë hedhur në treg aplikacione që bëjnë të mundur kontrollin prindëror mbi telefonin e fëmijëve?

	Nr.	%
Po	391	45.6%
Jo	467	54.4%
Total	858	100.0%

P.26 Keni dëgjuar se ndonjë kompani telefonike të ketë hedhur në treg aplikacione që bëjnë të mundur kontrollin prindëror mbi telefonin e fëmijëve?



P.27 Do të ishit të interesuar të blinit aplikacione që bëjnë të mundur kontrollin prindëror mbi telefonin e fëmijëve?

	Nr.	%
Po	440	51.3%
Jo	406	47.3%
Total	846	98.6%

P.27 Do të ishit të interesuar të blinit aplikacione që bëjnë të mundur kontrollin prindëror mbi telefonin e fëmijëve?




Diagrama 67


Gjithsesi, edhe në aspektin teknik ka vend të bëhet më tepër që kultura e një komunikimi dixhital të shëndetshëm të shoqërohet me instrumente teknike që ndihmojnë në parandalimin ose bllokimin e veprimeve cyberbullizuese. Po ashtu kërkohet që konsumatorët të ndihmohen në kulturën e tyre teknike si përdorues.

Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat e diagramës 68. Nga të anketuarit, janë 65 për qind e tyre që pohojnë se nuk kanë marrë kurrë ndonjë njohuri teknike nga profesionistë se çfarë duhet të bëjnë nëse ndjejnë se cyberbullizohen në rrjetet sociale ndërkohë që vozisin atje duke përdorur teknologjinë numerike të telefonisë të lidhur me Internet.

Ndërkaq janë 90,1 për qind e të anketuarve që iu besojnë aplikacione që parandalojnë, bllokojnë apo denoncojnë cyberbullizimin. Për këtë instrument sigurie jepet pra edhe besueshmëria më e madhe nga ana e të anketuarve.

P42. Keni marrë njohuri nga profesionistë se çfarë duhet të bëni nëse në rrjetet sociale ju kanë cyberbullizuar?

	Nr.	%
Po	303	35.0%
Jo	562	65.0%
Total	865	100.0%



P43. Mendoni se në rrjetet sociale apo edhe në komunikime telefonike duhet të ketë instrumente parandalimi ose denoncimi ndaj cyberbullizimit?

	Nr.	%
Po	782	90.1%
Jo	86	9.9%
Total	868	100.0%




Diagrama 68


Në artikullin shkencor të cituar më sipër theksohet edhe një ide e tretë, e cila konsideron se masat parandaluese kundër cyberbullizimit, ose ato që lehtësojnë dhe shërojnë pasojat e shkaktuara prej tij, mund të jenë të përmasave të ndryshme. Ato kanë natyrë makrosociale, sikurse disa që u përmendën më sipër, por mund të jenë edhe mikrosociale, pra të venë në qendër kryesisht individin.

Një pjesë e të anketuarve në kuadrin e këtij studimi theksojnë se përgjegjësinë për t'u ruajtur nga veprimet cyberbullizuese e ka vetë individi. 40,8 për qind e të anketuarve e mendojnë thekshëm këtë (shkalla 6 + 7 e vlerësimit). Këtë e tregojnë të dhënat e diagramës 69, të cilat po ashtu dëshmojnë edhe për një hezitim në këtë drejtim. Po te kjo diagrame, dëshmohet se janë 38 për qind e të anketuarve që mendojnë thekshëm (shkalla 6 + 7 e vlerësimit) se njerëzit e sotëm janë bërë të paedukuar. Nënteksti mund të jetë që masat e bazuara te sjellja e njeriut kanë edhe ato efikasitet të kufizuar.

Ndoshta të gjitha së bashku mund të jetë mënyra më e mirë për t'i vënë në jetë.

36.3 Vetë personi që përdor telefonin

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	255	29.8%
2	62	7.3%
3	55	6.4%
4	55	6.4%
5	79	9.2%
6	83	9.7%
7	266	31.1%
Total	855	100.0%



36.4 Shoqëria që është shumë e dhunshme dhe me njerëz të paedukuar

1 vlera më e ulët 7 vlera më e lartë	Nr.	%
1	272	31.8%
2	53	6.2%
3	50	5.8%
4	75	8.8%
5	80	9.4%
6	77	9.0%
7	248	29.0%
Total	855	100.0%




Diagrama 69

Dihet se çështja e kulturës së komunikimit dhe në veçanti e komunikimit dixhital lidhet shumë me vlerat në të cilat besojnë individët e një shoqërie. Ato janë të rrënjësura në kujtesën kolektive në formën e modeleve që ndryshojnë me vështirësi dhe shumë ngadalë.

Cyberbullizimin e ndihmon shumë një kuptim disi i ngushtë dhe i tejskajshëm që del ndonjëherë edhe jashtë kuadrit që vlera përkatëse përfaqëson. Vjen rasti kur ekzagjerohet duke besuar më shumë se duhet se shprehjes : “Gjuha kocka s’ka, por kocka thyhen!” Kjo shprehje ka karakter metaforik. Në të vërtetë, thelbësisht, ajo paraqet edhe një të vërtetë të madhe. Fjala e hidhur, e urrejtjes, shpifja, etj., por edhe fjalë të mençura dhe të vërteta, jo rrallë kanë fuqi vepruese. Sikurse i quan epistemologjia e “*speech acts*” janë “akte të shprehuri”.

Fjala ngacmuese mund të sjellë edhe dëme dhe fizike te individ, apo materiale në kontekstin ku shprehet. Por, fuqia e saj nuk mund të ekzagjerohet. Fundja fjala – fjalë mbetet, një tërësi tingujsh me kuptim. Tjetri më vret me fjalë, nëse unë vritem nga fjala!

Fjala e tjetrit sado e hidhur dhe goditëse të jetë përsëri nuk ka fuqi magjike. Nëse vepron mbi bashkëbiseduesin, kjo varet nga fakti sesa ajo bën efekt në psikikën e tij.

Duhet ditur se ne jetojmë në një qytetërim me plot vlera të mëdha. Edhe kur vlerat e tij i japin një peshë vepruese fjalës në planin material, ato e kanë arsye ta bëjnë këtë. Por, gjithsesi nuk duhet shkuar deri në skajin se fjala e tjetrit vret, ka fuqi të vrasë. Forca e fjalës ka vend të relativizohet, pra edhe e fjalës fyese. Përndryshe, një kulturë e tejskajshme, sado e mençur në thelbin e saj, bëhet mekanizëm që gjeneron pa fund dhunë, sherre, konflikte.

Theksohet kjo sepse në diagramën 70 janë 91,3 për qind e të anketuarve që i besojnë forcës së fjalës për “të thyer kocka”, pra “kockat” e tjetrit.

Fatmirësisht në ndërgjegjen kolektive ka edhe vlera të tjera që e ekuilibrojnë dhe e përmbajnë brenda një kuadri të logjikshëm këtë besim. Në një masë po aq të madhe, e njëjta diagrame tregon se janë 92,2 për qind e të anketuarve që i besojnë shprehjes tjetër të mençur popullore : “Qentë le të lehin, karvani ecën përpara!”

Këtu qendron harmonia e vlerave, te pika e ekuilibrit midis një fjale që “thyen kocka”, dhe një fjale që konsiderohet si “lehje qensh” në errësirë, fshehur pas gardheve të kasolleve ndërsa një karvan triumfator ecën përpara drejt destinacionit që i ka vënë vetes për të arritur!

P.18-22. Si i konsideroni shprehjet e mëposhtme popullore?

Vlerat e skajshme	1 + 2	5+6+7	Totali nr.	1 + 2	5+6+7	Totali %
18. Shprehjen popullore : «Qentë le të lehin, karvani ecën përpara», me sa pikë nga 1 deri në 7 do ta kishit vlerësuar si të saktë?	58	687	745	7.8%	92.2%	100.0%
P19. Shprehjen popullore : «Qeni që leh nuk kafshon», me sa pikë nga 1 deri në 7 do ta kishit vlerësuar si të saktë?	96	592	688	14.0%	86.0%	100.0%
P20. Sa e konsideroni të saktë shprehjen : « Shpif, shpif, se diçka mbetet !»	218	387	605	36.0%	64.0%	100.0%
P21. Sa e konsideroni të saktë shprehjen : «Me gurë goditet pema që ka kokrra!»	93	638	731	12.7%	87.3%	100.0%
P22. Sa e konsideroni të saktë shprehjen se «Fjala, kocka nuk ka, por kocka thyen».	66	695	761	8.7%	91.3%	100.0%




Diagrama 70

8. Disa nga gjetjet kryesore

Disa nga prirjet më të rëndësishme të konstatuara, të cilat janë shprehur edhe në formën e të dhënave sasiore, janë:

- Rezultati i matjes së dukurive cyberbullizuese në realitetin shoqëror varet shumë nga koncepti që përdoret mbi cyberbullizimin. Një koncept i gjerë e zmadhon rezultatin e konstatimeve sasiore të fakteve të vëzhguara, kurse një përkufizim më i ngushtë e zvogëlon atë.
- Perceptimi dhe opinionet e njerëzve mbi shtrirjen, dëmin që bëjnë, rrezikshmërinë që paraqesin sjelljet cyberbullizuese në realitet varen konsiderueshëm nga shkalla e ndërgjegjësimit të tyre, nga shkalla e njohjes që kanë për to, si edhe nga “tipi psikologjik” i individit. Një person që është i ndjeshëm dhe preket shpejt ndjen më tepër presion cyberbullizues në shoqëri, dikush më indiferent ndjen më pak.
- Sa më i fortë të jetë presioni shoqëror ndaj cyberbullizimit dhe sa më i ndjeshëm të jetë ai ndaj shfaqjeve cyberbullizuese, aq më tepër ngushtohet hapësira e pranisë së tij në shoqëri.
- Ka një prirje për t’iu përgjigjur sjelljeve cyberbullizuese me agresivitet dhe me po atë ton. Kjo bën që shkalla e cyberbullizimit në shoqëri të rritet dhe jo të pakësohet. Në këtë mënyrë i cyberbullizuari cyberbullizon!
- Mesatarisht, mes të anketuarve, shkalla e atyre që pohojnë se janë ndodhur nën veprimin e cyberbullizimit është një ndër pesë të anketuar. Kjo mesatare varion pastaj sipas grupeve shoqërore duke arritur në shifra edhe dy ose tre herë më të mëdha. Kjo mesatare është më e ulët sesa kanë treguar studime të këtij lloji të kryera në vende perëndimore për shoqëritë e atjeshme.
- Përqindja mesatare e të anketuarve që janë ndjerë të cyberbullizuar është pak a shumë e njëjtë si në qytete qendra qarqesh, ashtu edhe në zona periferike urbane në lidhje me to. Cyberbullizimi është dukuri me shtrirje globale që shpesh herë i injoron vend-ndodhjet reale të komunikuesve. Kjo përcaktohet nga natyra e teknologjisë dhe e komunikimi dixhital.
- Teknologjia dixhitale e komunikimit masiv apo ndër-individual është më tepër në duart e më të rinjve në moshë. Më të rinjtë kanë në duart një teknologji dixhitale komunikimi më të avancuar se ata me moshë më të rritur. Moshat e reja i kapërcejnë më të rriturit edhe nga koha e përdorimit të teknologjive dixhitale të komunikimit masiv.
- Grup-moshat me pjekuri etike dhe përvojë jete më të ulët kanë më tepër se grup-moshat e pjekura në duart teknologjinë që përcjell cyberbullizim.
- Frika dhe ndrojtja ndaj të qenit i (e) cyberbullizuar ka prirje të frenojë përdorimin e teknologjisë mobile të lidhur në Internet.
- Teknologjia e telefonisë mobile e lidhur në Internet është bërë infrastruktura më përhapur e komunikimit dixhital duke ja kaluar edhe kompjuterit.
- Shkalla e cyberbullizimit në përdorimin e saj nuk rritet nga zotërimi i teknologjisë më të lartë, por nga mënyra e përdorimit të saj.
- Cyberbullizimi i shkallës më të lartë vjen nga komunikimi në rrjetet sociale dhe vozitja në forumet e mediave online.
- Nuk ka rëndësi koha e përdorimit të teknologjisë telefonike dixhitale në rritjen e nivelit të ekspozimit të personit, konsumatorit, ndaj dukurive cyberbullizuese. Prirja është që edhe ata

konsumatorë që lidhen në Internet nëpërmjet sistemi WIFI dëshmojnë se mund të jenë cyberbullizuar njësoj si dhe sa ata që zotërojnë akses pa limit në lidhjen Internet.

- Të anketuarit priren t'i ndruhen më tepër bullizimit offline në krahasim me cyberbullizimin online. Kjo prire rritet te të anketuarit me banim në zona periferike urbane, si edhe te femrat. Të rinjtë i ndruhen më tepër se ata me moshë më të madhe bullizimit tradicional.
- Të anketuarit theksojnë se cyberbullizuesi më tepër ka shanse të jetë një anonim ose njeri i panjohur sesa dikush që njihet. Kjo është prova se cyberbullizimi ka një përmasë hipokrizie të lartë në planin shoqëror.
- Mungon ndjeshëm mbështetja sociale për të cyberbullizuarit nga familja, shkolla dhe rrethi shoqëror. Prirja e të cyberbullizuarit është izolimi, atomizimi sociale, dhe mbyllja në vetvete.
- Pjesa dërmuese e atyre që kanë për detyrë të kujdesen për brezin e ri kanë prirje të jenë “të verbër”, pra të mos i shohin vuajtjet dhe pasojat e më të rinjve si pasojë e cyberbullizimit.
- Të anketuarit kanë prirje të pohojnë se përgjithësisht cyberbullizohen njësoj në platformat online, por ndjekin dhe vozisin ato rrjete sociale ku sikurse shprehen niveli i cyberbullizimit është më i lartë.
- Individët me lidhje të forta shoqërore dhe që pohojnë se ndihen të mbështetur fuqimisht në shoqëri mund të ndihen më shumë të ekspozuar ndaj cyberbullizimit ose edhe më pak se pjesa tjetër e të anketuarve. Por, duket se ata që kanë lidhje shoqërore më të forta i përballojnë më mirë pasojat e këtyre sjelljeve deviante në komunikim.
- Paradoksisht tipat më të vetmuar dhe të mbyllur në vetvete kanë prirje të cyberbullizohen më pak. Duke komunikuar më pak, nga ana tjetër, ata humbasin avantazhet që sjell shkëmbi i informacionit dhe vendosja e lidhjeve shoqërore virtuale me të tjerë.
- Të anketuarit preken më fort kur cyberbullizohen në formën e ngacmimeve seksuale, kur abuzohet me jetën e tyre intime dhe kur keqpërdoren të dhënat e jetës së tyre private.
- “Prototipi psikologjik” mesatar i të anketuarve është “i favorshëm” për ta rritur dhe ushqyer cyberbullizimin në shoqëri. Ai manifeston mesatarisht prirjen për t'u prekur shpejt dhe për të kundërvepruar fort dhe me agresivitet.
- Shumica e të anketuarve i beson më tepër mekanizmave teknologjikë për të ndaluar ose denoncuar cyberbullizimin, sesa mjeteve ligjore apo normative.
- Kultura e të anketuarve sikurse del nga përgjigjet e tyre është relativisht e pamjaftueshme për t'u përgatitur në përballjen me cyberbullizimin.
- Përgjithësisht në modelin vleror të kulturës shqiptare ka modele tradicionale që e rrisin shkallën e cyberbullizimit në shoqëri. Ka edhe vlera që ndikojnë për ta ulur.

9. Literaturë

Saurav Chakraborty, Anol Bhattachar, Agnieszka Onuchowska : *Cyberbullying: A Review of the Literature*, SSRN Electronic Journal, January 2021
DOI: 10.2139/ssrn.3799920